



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

Fusha e kurrikulës
SHKENCAT E NATYRËS

Mars, 2014



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

Fusha e kurrikulës SHKENCAT E NATYRËS

Mars, 2014

Përgatitur nga:

Rexhep Kastrati, koordinator i fushës Shkencat e natyrës, MASHT

Milazim Avdylaj, mësues - bashkëpunëtor për kurrikula

Koordinuar nga:

Selim Mehmeti, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Hajrije Devetaku - Gojani, Instituti Pedagogjik i Kosovës, &

Shqipe Gashi, zyrtare për kurrikula në MASHT

Lektor:

Bekim Morina, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Botimin e mbështeti:

Zyra për trajnime në MASHT

Dizajni dhe faqosja nga:

Blendi, Prishtinë

Prishtinë, mars 2014

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	6
1. HYRJE	7
2. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË.....	11
2.1. Arritshmëria e qëllimeve të arsimit parauniversitar	11
2.2. Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore... 14	
2.3. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit	18
2.3.1. Rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre.....	18
2.3.2. Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore	19
2.3.3. Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore (RNL) brenda shkallës kurrikulare	21
3. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE	27
3.1. Plani mësimor	27
3.2. Plani i shkallës kurrikulare	29
3.3. Plani vjetor	31
3.4. Plani dymujor	38
3.5. Plani javor	44
3.6. Plani i orës mësimore	46
3.7. Çështjet ndërkurrikulare (çështjet ndërlëndore) dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare	50
4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E SAJ	51
4.1. Metodologjia e mësimdhënies në funksion të KKK	51
4.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)	55
4.3. Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit	57
4.4. Bashkëpunimi i mësimdhënësve si domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re	78
Burimet dhe literatura	80
Shtojcat	81
Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit.....	82
Shtojca 2 : Modele të planifikimeve të përgatitura nga mësimdhënësit.....	83
Shtojca3 : Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor	103

SHKURTESAT

KKK	Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës
KB	Kurrikula Bërthamë
FK	Fushë Kurrikulare
SHK	Shkallë Kurrikulare
RNSH	Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – Kompetenca
RNF	Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare
RNL	Rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore
PV	Plan Vjetor
PD	Plan Ditor
OM	Orë Mësimore
POM	Plani i Orës Mësimore
TM	Teknikë Mësimore
KSH	Kalendari Shkollor
KV	Kalendari Vjetor

I. Hyrje

Udhëzuesi për zbatimin e Kurrikulës së re është doracak, i cili mbështet implementimin e filozofisë së Kornizës së Kurrikulës së Kosovës në praktikë. Udhëzuesi është vazhdimësi e dokumenteve kurrikulare, të cilat në mënyrë hierarkike e ndihmojnë dhe e bëjnë të zbatueshëm njëra-tjetrën. MASHT-i, pas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK), ka hartuar Kurrikulat Bërthamë (KB) për të vazhduar më pas me hartimin e Udhëzuesve praktikë për zbatimin e Kurrikulës sipas fushave të kurrikulës, aktivitet të cilin e ka zhvilluar në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Udhëzuesi ofron (i) informata për jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin parimeve të kurrikulës, kuptimin e zërthyeshmërisë të rezultateve të të nxënësve për kompetenca dhe për fusha kurrikulare të shkollës së tretë, katërt, pestë dhe gjashtë kurrikulare në planifikime mësimore; gjithashtu, udhëzuesi ofron (ii) aspekte metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës në fushën Shkencat natyrore; dhe (iii) aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Aspektet metodologjike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës se re dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve mbështeten në praktikat e suksesshme të shkollës, në modelet e punës së dhjetë shkollave prijëse 2013/2014 në pilotimin e Kurrikulës së re.

1.1 Rëndësia e udhëzuesit

Udhëzuesi mbështet zbatimin e KKK-së, respektivisht KB-së për arsimin mesëm të ulët dhe të lartë. Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës me punën mësimore që duhet të zhvillohet në shkollë, në bazë të autonomisë së shkollës të përcaktuar me KKK.

1.2 Qëllimi i udhëzuesit

Meqenëse mësimdhënësit janë agjentët kryesorë të zbatimit të filozofisë së KKK-së, udhëzuesi ka për qëllim ngritjen profesionale të mësimdhënësve për të kuptuar dhe zërthyer KKK-në, respektivisht KB-në për fushën kurrikulare *Shkencat natyrore*, në planifikime mësimore, në strategji e teknika të mësimdhënies, të nxënësve dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në qasjen e bazuar në kompetenca.

1.3 Përdorimi i udhëzuesit

Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i trajnerëve për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësimdhënësve në zbatimin e KKK-së, respektivisht të KB-së, fushës kurrikulare *Shkencat e natyrës*. Kurse në të ardhmen llogaritet që ky udhëzues krahas me udhëzuesit për përmirësimin e praktikave në klasë (MASHT & SWAP, 2012), t'ju shërbej mësimdhënësve gjatë punës së pavarur në realizimin e kurrikulës së re.

1.4 Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit?

Duka pasur parasysh çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, pritët që mësimdhënësit të arrijnë këto rezultate:

- Të identifikojnë qasjet e arritshmërisë së qëllimeve të arsimit;
- Të identifikojnë qasjet e respektimit të parimeve në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;
- Të identifikojnë elementet e domosdoshme të përbërjes së planifikimeve mësimore për zbatimin e KB – **Fushës Shkencat e natyrës**;
- Të prezantojnë modele të planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-së;
- Të prezantojnë modele të strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit duke respektuar parimet e KKK-së, KB-së;
- Të prezantojnë modele të përgatitjes dhe shfrytëzimit të materialeve mësimore, për fushën e **Shkencat e natyrës** dhe lënëve Biologji, Kimi dhe Fizikë;
- Të prezantojnë strategji, teknika dhe instrumente të vlerësimit konform parimeve të kurrikulës;
- Të prezantojnë strategji të bashkëpunimit kolegjial brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.

1.5 Organizimi i udhëzuesit

Udhëzuesi përbëhet prej katër kapitujve dhe shtojcë. Në secilin kapitull elaborohen çështje të cilat i ndihmojnë mësimdhënësit të kuptojnë ecurinë e zbërthimit të KKK-së, respektivisht të KB-së, fusha e kurrikulës Shkencat natyrore. Secili kapitull i udhëzuesit është në funksion të lehtësimit të punës së mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re.

Në kapitullin e parë - Hyrja trajtohen rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit e udhëzuesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit.

Në kapitullin e dytë - Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë – zbatimi në praktikë, trajtohen çështje që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin parimeve të kurrikulës në procesin e arsimit në shkollë, kuptimin e zbërthyeshmërisë së rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe për fushë kurrikulare (*Shkencat e natyrës*) në planifikime mësimore.

Në Kapitullin e tretë - Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re trajtohen çështje të planifikimeve mësimore, duke integruar elemente të domosdoshme të KB-së, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare dhe bashkëpunimi kolegjial në funksion të zbatimit të KB-së.

Në kapitullin e katërt – Metodologjia e mësimdhënies, materialet mësimore dhe instrumentet e saj, trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke përfshirë metoda, teknika të mësimdhënies dhe të të nxënit të suksesshëm, përgatitje dhe shfrytëzim të materialeve mësimore. Trajtohen metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat, rezultatet e të nxënit dhe nivelet e njohjes në funksion të vlerësimit.

Shtojca përmban modele të planifikimit mësimor vlerësimit të përgatitura nga mësimdhënësit.

II. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT – ZBATIMI NË PRAKTIKË

Ky kapitull përqendrohet në:

- Arritshmërinë e qëllimeve të arsimit parauniversitar;
- Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore;
- Kuptimin dhe funksionin e rezultateve të të nxënësve (të shkollëve kurrikulare -RNSH – kompetencave, të fushave kurrikulare-RNF dhe të lëndëve mësimore- RNL).

2.1. Arritshmëria e qëllimeve të arsimit parauniversitar

Qëllimet e arsimit parauniversitar

- *Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;*
- *Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*
- *Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*
- *Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë; dhe*
- *Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.*

Qëllimet e arsimit parauniversitar të paraqitura në KKK janë pjesë përbërëse e dokumenteve të kurrikulave bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. E gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve është në funksion të arritshmërisë së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe rezultatet e të nxënësve për shkollë kurrikulare – kompetenca (RNSH) dhe rezultatet e të nxënësve të fushave kurrikulare (RNF) të secilës shkollë kurrikulare janë në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Edhe e gjithë puna praktike edukativo- arsimore që zhvillohet në shkollë duhet të jetë në funksion të arritshmërisë së këtyre qëllimeve. Qasjet e arritjes së qëllimeve duhet t'u përshtaten moshës dhe mundësive të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Në secilën Kurrikulë Bërthamë janë dhënë disa përshkrime që lidhen me veçoritë e arsimit në nivelin përkatës, të cilat i orientojnë mësimdhënësit që punojnë në nivele të ndryshme të arsimit që të marrin për bazë mundësitë dhe nevojat e nxënësve gjatë planifikimit dhe aktiviteteve të tjera me nxënës në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit. Për të thelluar informacionet lidhur me **veçoritë e arsimit në nivele**, secili mësimdhënës duhet të konsultojë Kurrikulën Bërthamë (KB) të nivelit të arsimit në të cilin punon.

Si arrihen qëllimet e arsimit parauniversitar?

Sipas KB-së, secili nivel i arsimit parauniversitar të nxënësve duhet të zhvillojë dijet, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike dhe

nëpërmjet tyre në arritjen e qëllimeve të arsimit. Për arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar kontribuojnë të gjitha fushat e kurrikulës. Qëllimet e arsimit bëhen pjesë e **planifikimeve** mësimore për secilën fushë të kurrikulës, përkatësisht bëhen pjesë e planifikimit të secilës klasë, si të planifikimeve vjetore, mujore, javore, ditore dhe pjesë e procesit mësimor që zhvillohet në klasë dhe jashtë saj. Kjo do të thotë se në funksion të arritshmërisë së qëllimeve duhet të zhvillohen aktivitete të shumta, të udhëhequra nga mësimdhënësi, si:

- Përzgjedhja e rezultateve të të nxënit për shkallë - kompetencë (RNSH) që synohen të arrihet gjatë periudhave të caktuara përmes përmbajtjeve (temave dhe njësive mësimore) dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;
- Përzgjedhja apo adaptimi i rezultateve të fushës apo lëndës të secilës klasë nga planet dhe programet ekzistuese që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare;
- Përzgjedhja e përmbajtjes mësimore (temave apo njësive mësimore);
- Përzgjedhja e metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënit, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit;
- Përzgjedhja e materialeve dhe burimeve mësimore;
- Puna me projekte në fushën e shkencave të natyrës;
- Përzgjedhja e formave të komunikimit;
- Krijimi i klimës në klasë dhe shkollë në favor arritjes së qëllimeve, etj.

Reflekto: Qëllimet nuk mund të kuptohen si fiksime të veçanta që arrihen secila ndaras nga njëra-tjetra, ato në shumicën e rasteve funksionojnë si tërësi.

Arritshmëria e qëllimeve nuk mund të kuptohen si fiksime të veçanta që arrihen secila ndaras nga njëra-tjetra, ato në shumicën e rasteve funksionojnë si tërësi.

Shembull i kontributit në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar

Shkalla III Kompetencat I,6,II,4, III,7 IV,4, V,7, VI,1

Shkalla III, fusha kurrikulare Shkencat natyrore, rezultati 2.1

Rezultati i fushës kurrikulare - lëndës mësimore: - Shkencat natyrore, klasa:6-të p.sh rezultati, nr 1,2,3,4?

Përmbajtja mësimore (Temë mësimore): Hulumtimi në shkencat natyrore

Përmbajtja mësimore(Njësi mësimore): Vrojtimi si metodë hulumtuese në shkencat natyrore

Qëllimet e synuara mund të jenë:

- *Kultivimi i identitetit personal, por nëse nxënësit angazhohen në hulumtim shkencor në mënyrë grupore;*
- *Promovohet bashkëpunimi si vlerë e përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *Rritet përgjegjësia ndaj vetes dhe të tjerëve,*
- *Rritet angazhimi dhe iniciativa si pjesë të ndërmarrësisë;*
- *Krijohet mundësia për punë të pavarur*

Në këtë rast vijnë në shprehje metodologjia e punës, materialet dhe burimet e informacionit, klima pozitive.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për arritshmërinë e qëllimeve të arsimit parauniversitar, diskutoni me kolegë:

1. Si mund të integrohen dhe respektohet qëllimet e arsimit parauniversitar konkretisht në kuadër të lëndëve të fushës Shkencat e natyrës;
2. Merrni shembuj në lëndën tuaj dhe në nivele të ndryshme të planifikimit **dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies.**

Fusha e kurrikulës/Lënda: _____

Klasa: _____

Tema: _____ Njësia mësimore _____

Rezultatet mësimore:

Qëllimet e arsimit që synohen të arrihen dhe përshkrimi i anës praktike për arritjen e qëllimeve gjatë punës me nxënës:

2.2. Parimet e arsimit parauniversitar, referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore

<i>Parimet</i>
<ul style="list-style-type: none">• <i>Gjithëpërfshirja</i>• <i>Zhvillimi i kompetencave</i>• <i>Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar dhe koherent</i>• <i>Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle</i>• <i>Përgjegjësia dhe llogaridhënia</i>

Parimet janë pikënisje, pikë referimi, janë një lloj i rregullave, të cilat e mbështesin punën edukativo-arsimore në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar dhe në arritjen e kompetencave kryesore të kurrikulës. Ato mbështesin punën edukativo-arsimore të mësimdhënësve të të gjitha fushave të kurrikulës, pra edhe të mësimdhënësve të fushës Shkencave natyrore. Ato janë udhërrëfyes të punës së suksesshme të mësimdhënësve që reflektohen në përgatitjen e nxënësve në secilin nivel të arsimit për sfidat e tanishme në të nxënë, në zgjidhje të problemeve në raport me potencialet e tyre dhe në përgatitjen për të nxënë të mëtutjeshëm. Mësimdhënësit e fushës kurrikulare *Shkencat e natyrës* punën e tyre edukativo-arsimore duhet ta mbështesin në parimet e përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK), respektivisht në KB – specifikat e fushës Shkencat e natyrës.

Si mund ta dijë një mësimdhënës i fushës Shkencat e natyrës ose një aktiv profesional i një shkolle të caktuar se është duke e mbështetur punën e vet në parimet e KKK?

Përgjigjja në këtë pyetje duhet të jetë pjesë e diskutimeve në mes të mësimdhënësve dhe forumeve të tjera në shkollë gjatë të gjitha aktiviteteve që kanë për qëllim punën në procesin edukativo-arsimor.

Në pjesën në vijim të këtij udhëzuesi ofrohen disa tregues se si një mësimdhënës gjatë punës së tij/saj është në linjë të parimeve të KKK-së.

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të gjithëpërfshirjes** atëherë kur:

- Ka **planifikuar** me qëllim për të diagnostikuar përvojat, dijet, kulturat, stilet e të nxëniet të nxënësit-ses dhe ka realizuar aktivitete për të përmirësuar mësimdhënien;
- Ka planifikuar duke synuar rezultate të caktuara;
- Ka përdorur **llojlojshmëri të metodave, teknikave dhe materiale** të ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxëniet, detyra të diferencuara për realizim të aktivitetit.

Dhe nxënësi-sja

- Ndihet i pranuar në klasë nga nxënësit-set, edhe nga mësimdhënësi-sja njëjtë si të gjithë nxënësit pa dallim, qoftë të potencialit, qoftë gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë sociale, ekonomike, shëndetësore, etnike dhe kulturore;

- Ndihet i-e respektuar sa i përket, dinjitetit, përvojës, dijeve, stileve të të nxënit dhe mënyrës së të shprehurit dhe mendimit.

Sepse kemi krijuar klimë ku secili-la ndihet rehat, i-e çmuar, kontribuues-e dhe i-e suksesshëm-e

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të zhvillimit të kompetencave** atëherë kur:

- Ka **planifikuar** mësimdhënien dhe të nxënit, duke pasur parasysh rezultatet e të nxënit të shkallës – kompetencës (RNSH), rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) të shkallë së parë apo të dytë kurrikulare, dhe rezultatet e fushës apo lëndës për klasë (parafilllore, e parë,... e pestë) të marrë dhe të adaptuar nga planet dhe programet ekzistuese, e nëse e jo i kem hartuara vetë;
- Ka aplikuar **metodologji dhe mjete didaktike**, të cilat kanë nxit dëshirë, kreativitet dhe pavarësi;
- Ka përdorur **teknika dhe instrumente të vlerësimit**, të cilat kanë ndihmuar vetëvlerësimin, identifikimin e saktë të shkallës së arritshmërisë dhe pastaj marrjen e masave për përmirësim.

Dhe nxënësi-sja

- Identifikon, krahason, analizon dhe vlerëson ngjarje, dukuri dhe zgjidh probleme konform rezultateve të të nxënit të fushës apo lëndës për klasën parafilllore, apo klasat e arsimit fillor;
- Demonstron shkathtësi të komunikimit (dëgjon dhe është konstruktiv në dhënien e mendimeve, qoftë verbalisht, me shkrim apo me vizatim), të menaxhimit të detyrës, aktivitet, kohës dhe mjeteve, shfrytëzimit të burimeve ...;
- Demonstron vlera, si tolerancë, mirësjellje, solidaritet-përkrahje, respekt dhe përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit;
- Demonstron qëndrim, për diçka, si për sjellje, ngjarje a dukuri;
- Demonstron iniciativa, pjesëmarrje për ndryshim;
- Menaxhon emocionet e veta, nuk është arrogant-e, konfliktuoz-e, i-e tensionuar...

Dhe, kështu zhvillojmë nxënës-e kompetent-e

Mësimdhënësi është në **linjë të parimit të mësimdhënies së integruar dhe të të nxënit koherent** atëherë kur:

- Ka **planifikuar** lidhje ndërlëndore brenda fushës së njëjtë, përmes përzgjedhje së temave të përbashkëta;
- Ka **planifikuar** lidhje në mes të fushave kurrikulare, ashtu që të ndihmojmë zhvillimin e gjuhës te shkencat, artet, jeta dhe puna, por edhe te matematika; apo ndihmojmë zhvillimin e temave të shkencave, shoqërisë dhe mjedisit përmes matematikës, gjuhës dhe arteve (p.sh vjeshta, temë-njësi mësimore e shkencave ndihmohet të realizohet përmes

esesë të gjuhës, përmes artit e edhe muzikës; p.sh. Foljet, mbiemri, emri - njësi mësimore të gjuhës për përmes teknikës së pesëvargëshit zhvillohen të shkencat natyrore, të shoqëria dhe mjedisi etj.);

- Ka **planifikuar** module dhe projekte, ku gjenden elemente të fushave kurrikulare, p.sh. projekti Mbjellja e luleve në një kënd të oborrit të shkollës - atëherë kanë ardhur në shprehje shkencat natyrore duke e studiuar kohën e përshtatshme për mbjellje... , matematika duke matur thellësinë e gropës të përshtatshme për lulet, shoqëria dhe mjedisi duke ditur rëndësinë ruajtjes dhe krijimit të një mjedisi të këndshëm, shëndeti dhe mirëqenia, artet etj.

Dhe nxënësi-sja

- ✚ analizon një detyrë, situatë, ngjarje a dukuri në kënde të ndryshme (p.sh të një lloji ushqimi, identifikon përbërjen, mënyrën e përdorimit dhe vendin e prodhimit – këtu ka elemente të shkencave të natyrës, jetës dhe punës, por edhe të shoqërisë dhe mjedisit; p.sh. trupat gjeometrik- forma mendojmë në matematikë, shkencat e natyrës, arte etj).
- ✚ identifikon ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e detyrave, ngjarjeve dhe dukurive (p.sh. bimët na ndihmojnë të kemi jetë të shëndoshë, sepse kemi ajër të pastër dhe...dhe ne i ruajmë, kujdesemi dhe i kultivojmë ato).

Dhe, kështu zhvillojmë të nxënë gjithëpërfshirës dhe koherent

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të autonomisë dhe fleksibilitetit** atëherë kur:

- Ka përgatitur **plan mësimor** (shpërndarje të orëve mësimore për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore) dhe **planifikime mësimore** (vjetore, mujore, ditore) konform rezultateve të të nxënës për shkallë-kompetencë (RNSH), rezultateve të të nxënës për fushë kurrikulare (RNF) për shkallë dhe rezultateve të të nxënës për fushë kurrikulare a lëndë mësimore për klasë dhe konform përvojave, ritmeve e stileve të të nxënës të cilët-at i udhëhiqemi;
- Ka hartuar **kurrikulën zgjedhore** konform talentit, afiniteteve dhe interesave të nxënësve.

Dhe, nxënësi-sja

- nxënë në bazë të ritmeve individuale të të nxënës
- nxënë sipas stilit individual
- zhvillon talentin dhe nxënë mbi bazën e afiniteteve dhe interesave

Dhe, kështu zhvillojmë nxënës-e të suksesshëm-me

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënës** atëherë kur:

- është **transparent** për saktësinë dhe nivelin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve për secilën detyrë, aktivitet me secilin nxënë-së dhe kem diskutuar rrugët e arritjes;
- është **transparent** dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindër për të arriturat e rezultateve të të nxënës për shkallë-kompetenca (RNSH) dhe rezultateve të të nxënës të fushës kurrikulare (RNF), lëndës a temës mësimore;
- është **transparent** me Këshillin e klasës, Këshillin e mësimdhënësve të shkollës dhe këshillat e tjerë që funksionojnë në shkollë për nivelin e arritjes së rezultateve të kompetencave, fushave, lëndës apo temës për paralelet të cilat i udhëheqim.

Dhe

- nxënësi-sja është në dijeni për nivelin e arritjes së vetë konform kërkesave të shtruara nga mësimdhënësi;
- prindërit janë në dijeni për nivelin e arritjes së fëmijëve të tyre konform rezultateve të nxënit të shkallës – kompetencës (RNSH), rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) për shkallë, rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) a temës mësimore për klasë;
- Këshilli i klasës, Këshilli i mësimdhënësve të shkollës dhe këshillat e tjerë që funksionojnë në shkollë janë në dijeni për nivelin e arritjes së nxënësve të paraleles.

Dhe, kështu përmirësojmë mësimdhënien dhe rrisim të nxënit e nxënësve

Aktivitet :

Pasi që keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për parimet e arsimit parauniversitar referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore, diskutoni me kolegë: si mund të integrohen dhe respektohet parimet e arsimit parauniversitar konkretisht në kuadër të lëndëve të fushës –Shkencat e natyrës. Merrni shembuj në lëndën tuaj dhe në nivele të ndryshme të planifikimit dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Fusha e kurrikulës/Lënda: _____

Klasa: _____

Tema: _____ **Njësia mësimore** _____

Rezultatet mësimore: _____

Parimet që shërbëjnë si pikënisje dhe përshkrimi i anës praktike për parimet që respektohen gjatë punës me nxënës:

2.3. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit

Rezultatet e të nxënit

- Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre;
- Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore;
- Rezultatet e të nxënit për klasë, në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore, brenda shkallës kurrikulare.

2.3.1. Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre

Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca (RNSH) për nivelin I (shkallët kurrikulare 1 dhe 2) për nivelin II (shkallët kurrikulare3 dhe 4) dhe nivelin III (shkallët kurrikulare 5 dhe 6) janë kërkesa që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në fund të secilës nga këto shkallë. Ato janë njohuri, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina, të cilat duhet zhvilluar te secili nxënës-e përgjatë klasave sa kanë shkallët e kurrikulës në secilin nivel të arsimit. (shih KB, rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - RNSH).

Si zhvillohen (arrihen) kompetencat?

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritshmëria e rezultateve të tyre, bëhet përmes fushave kurrikulare. Të gjitha fushat kurrikulare apo lëndët mësimore që mbahen në klasë të ndryshme të të gjitha niveleve të arsimit duhet të kontribuojnë së bashku në arrijen e rezultateve të kompetencave të shkallës së parë. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me fushën kurrikulare Shkencat e natyrës.

Nuk do të thotë që domosdoshmërisht secila fushë kurrikulare si e vetme të arrijë të gjitha rezultatet e të gjitha kompetencave, por secila fushë kurrikulare duhet të fiksojë rezultatet e të nxëniet për shkallë - kompetencë që do t'i synon t'i arrijë për secilën klasë. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të kompetencave të jenë pika synuese për disa fusha kurrikulare, por mund të ndodhë që disa të përzgjidhen nga një fushë e vetme.

P.sh. rezultati I.2 (shkalla 3, f. 19), nxënësi-sja:

Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve, është rezultat që arrihet përmes të gjitha fushave kurrikulare ose rezultati II.6 (shkalla e tretë, f. 20) nxënësi-sja, „Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skice ose me shkrim”, është rezultat që arrihet përmes fushave Shkencat natyrore dhe Shoqëria dhe mjedisi, por më shumë është specifike e Shkencave natyrore.

Por, KUJDES! Të gjitha rezultatet duhet të arrihen deri në fund të shkallës përkatëse të kurrikulës.

Rezultatet e të nxëniet për shkallë kurrikulare-kompetenca (RNSH) mund të jenë të synuara në çdo klasë sa ka shkalla, por arritshmëria e tyre duhet të bëhet konform moshës dhe mundësive të nxënësve.

P.sh rezultati III.5, Shkalla e tretë, f. 20, nxënësi-sja ”Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashme i ka, duke i paraqitur ato në formë të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.”

Ndoshta nuk mund të arrihen nga të gjithë nxënësit e klasës së gjashtë, por mjafton që ata të jenë në gjendje të ndërlidhin njësinë e re me njohuritë dhe përvojat paraprake. Arritshmëria e plotë e këtij rezultati duhet të arrihet deri në fund të klasës së shtatë.

Në mënyrë që rezultatet e të nxëniet për kompetencë të jenë të arritshme ato duhet të jenë prezente pothuajse në të gjitha planifikimet mësimore të secilës fushë kurrikulare.

2.3.2 Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore

Rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të fushës përkatëse dhe janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore.

Konceptet janë shtylla përmbajtjesore, rreth të cilave organizohet e gjithë përmbajtja mësimore e fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare. Ato janë prezente në klasat e shkallës kurrikulare. Fuqia e prezencës së tyre në periudha të ndryshme kohore brenda një viti shkollor të një klase të caktuar, por edhe të klasave të ndryshme të shkallës së njëjtë mund të jetë e larmishme.

Si e përzgjedhim përmbajtjen mësimore nga RNF?

Me rastin e përzgjedhjes së rezultateve të të nxënit të fushës së caktuar kurrikulare, të cilat synojmë t'i arrijmë me nxënës në klasë të caktuara, së pari duhet identifikuar konceptet e fushës kurrikulare nga të cilat dalin rezultatet e caktuara. Shembull i ndërlidhjes së rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) me konceptet e fushës kurrikulare.

Fusha kurrikulare – Shkenca e natyrës, shkalla e tretë kurrikulare

Koncepti i fushës	Përmbajtjet mësimore	RNF (shkalla 3)
Proceset jetësore	<i>Koncepti proceset jetësore nënkupton zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në mbijetesën e qenieve të gjalla, në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. Koncepti proceset jetësore përfshin gjithashtu edhe sistemin e organeve të njeriut dhe shtazëve, llojlojshmërisë së botës së gjallë, rolin e ADN-së në trashëgimi dhe proceset fiziko-kimike në qelizë, sistemin e qenieve të gjalla në bioteknologji dhe teknikë, si dhe biologjinë e njeriut dhe format bashkëkohore të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.</i>	Dallon dhe përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Ndodh që disa koncepte të fushës kurrikulare të jenë prezente në një rezultat të fushës kurrikulare, por sidoqoftë njëra nga to ndihet më fuqishëm.

Konceptet e fushës kurrikulare së bashku me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare na ndihmojnë në përzgjedhjen e përmbajtjes mësimore (temave mësimore) për fushën kurrikulare për secilën klasë sa ka shkalla

Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore brenda një fushe kurrikulare gjatë periudhave të caktuara kohore të një viti shkollor.

kurrikulare. Shih **shembullin** e fushës kurrikulare Shkencat e natyrës, shkalla e tretë (klasa e gjashtë).

Hapi 1	hapi 2	hapi 3
Konceptet	RNF	Tema mësimore
<i>Proceset jetësore</i>	Dallon dhe përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.	Qeniet e gjalla dhe marrëdhëniet reciproke me ambientin.

Temat mësimore janë të vlefshme për gjitha lëndët mësimore sa ka fusha kurrikulare. Por, mund të ketë raste që nga disa rezultatet të fushës kurrikulare të përcaktojmë përmbajtjen - temën mësimore vetëm për një lëndë mësimore. P.sh. Fusha Shkencat natyrore, shkalla 3, rezultati I.4 “Përshkruan burimet e energjisë, format dhe shndërrimet e saj” është rezultat që anon më shumë ka lënda e Fizikës, sepse nuk mund të jetë i arritshëm përmes lëndës Biologji apo Kimi, ngase nuk përfshihen të gjitha format e energjisë përmes këtyre dy lëndëve, edhe pse p.sh lënda Biologji mund të përdorë këtë rezultat vetëm në rastin e shndërrimit të energjisë së diellit në energji kimike.

Duke pasur parasysh parimin e mësimdhënies së integruar dhe koherente, mësimdhënia përmes temave të përbashkëta për të gjitha lëndët mësimore do të jetë në funksion të respektimit të tij. Kjo do të thotë se secila lëndë mësimore duhet të arrijë rezultatin e fushës përmes temës së përbashkët të fushës, por secila nga këndi i vet, me njësi mësimore të lëndës së vet. Në shkallë të tretë dhe të katërt kjo qasje vlen edhe për fushën Shkencat natyrore, por jo edhe për shkallën 5 dhe 6, pasi aty kemi lëndët Biologji, Kimi, Fizikë.

2.3.3 Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore (RNL) brenda shkallës kurrikulare

Meqenëse rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët dhe KB për arsimin e mesëm të lartë paraqiten për shkallë e jo për klasë mësimore, atëherë konsiderohet si nevojë hartimi i rezultateve të nxënit për klasë, respektivisht për lëndë mësimore, sepse sigurohet kohezioni dhe mosngarkesa e njërës klasë brenda një shkalle kurrikulare.

Si hartohen rezultatet për klasë dhe lëndë mësimore?

Hartimi i rezultateve të të nxënit për klasa mund të bëhet nga vetë mësimdhënësit, por edhe të merren nga planet dhe programet ekzistuese. Nëse shfrytëzohen planet dhe programet ekzistuese, atëherë shkrimi i tyre bëhet duke i krahasuar rezultat e pritshme të lëndëve mësimore të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e të nxënit fushës kurrikulare të Kurrikulës Bërthamë. Në këtë rast bëhet përzgjedhja e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që janë në funksion të arritjes të secilit rezultat të të nxënit të fushës kurrikulare të Kurrikulës Bërthamë. Nëse rezultatet e pritshme të përzgjedhura nga planet dhe programet nuk përmbushin në tërësi rezultatin e caktuar të fushë kurrikulare, atëherë mund të shkruhen edhe

rezultate të reja. Rezultat e fushës kurrikulare apo lëndës mësimore për klasë mësimore, na ndihmojnë në përcaktimin e njësive mësimore, të cilat janë në funksion të temës së përbashkët të fushës kurrikulare. Shih formatin e mundshëm të tabelës të hartimit të rezultateve për fushë apo lëndë mësimore në nivel klase. Ky format duhet të zhvillohet sipas hapave të dhënë në pjesën në vijim:

Së pari duhet të rikujtojmë se çka janë rezultatet e të nxënësve?

Rezultate e të nxënësve janë deklarata, të cilat duhet të hartohen në mënyrë të strukturuar. Struktura e rezultatit të të nxënësve për lëndë përmban katër pjesë kryesore: Veprimi (V), Qëllimi (Q), Kushtet (KU) dhe Kërkesat ose kriteret (Ke).

Shembull jo i drejtë i shkrimit të rezultatit: Nxënësi: - Të dijë (Veprim) të respektojë rregullat e sigurisë (Qëllim) gjatë punës në laborator (kusht).

Shembull i drejtë i shkrimit të rezultatit: Nxënësi: Respekton (veprimi) rregullat e sigurisë (qëllimi) gjatë punës në laborator (kushti) të shkencave të natyrës (kërkesa ose kriteri).

Rekomandohet të mos përdoren foljet: të njohë, të dijë, të kuptojë, të jetë i aftë etj., sepse nuk janë të matshme. Por të përdoren foljet: shpjegon, tregon, përshkruan, ilustron, dallon, demonstroi, formulon, vizaton, llogaritë, respekton, përdor, skicon, identifikon, krahason etj¹.

Për çështje praktike rezultateve të fushës, kurrikulës marrë nga Kurrikula Bërthamë, por edhe rezultateve të planeve dhe programeve është mire që t’u vendosen nga një numër kur vendosen në këtë tabelë, në mënyrë që të dihet saktë se cilat rezultate korrespondojnë me njëra-tjetrën. Nëse njërit rezultat të fushës kurrikulare në nivel shkalle i keni vendosur numrin 1, atëherë rezultateve të planeve dhe programeve që korrespondojnë me këtë rezultat t’u vendosen numrat p.sh 1.1 apo 1.2, kështu me radhë.

Pasi të keni shkruar rezultatet e të nxënësve për lëndë mësimore (RNL), atëherë mund të bëni ndërlidhjen e tyre me rezultatet e të nxënësve për shkallë kurrikulare - kompetenca (RNSH), shih shembullin më poshtë

Shembull i ndërlidhjes se RNSH me RNF dhe RNL në klasën e gjashtë (shkalla e tretë)

Hapi 1	hapi 2	Hapi 3
RNSH (kompetenca)	RNF- Shkencat e natyrës	RNL
<p>II. Kompetenca e të menduarit – mendimtar kreativ</p> <p>2.8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.</p> <p style="text-align: center;">↓</p>	<p>I Dallon dhe përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</p>	<p>1. Përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit.</p> <p>2. Interpretin informatat e mbledhura nga burimet e ndryshme për ndikimin e kushteve të mjedisit në rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla.</p>

¹ Më gjerësisht për listën e foljeve që mund të përdoren në hartimin e rezultateve, shih shtojcën 1.

KUJTO! Rezultati i kompetencës (RNSH) dhe rezultati i fushës Shkencat e natyrës (RNF) janë rezultate të synuara, por jo domosdoshmërisht për t'u arritur në klasën e gjashtë. Këto rezultate janë të shkallës së tretë, që nënkupton se domosdoshmërisht duhet të arrihen në fund të klasës së shtatë.

Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës kurrikulare

p.sh. FUSHËS KURRIKULARE - SHKENCAT E NATYRËS /SHKALLA 5/ Gjimnazi i shkencave natyrore								
Nr.	Rezultatet e të nxënimit të fushës Shkencat e natyrës (RNF) marrë nga KB-ja	Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB	Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore		Rezultatet përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)			
			Klasat		Klasat			
			Lëndët mësimore	10	11	10	11	10
1	P.sh. Dallon dhe përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.	Biologji						
		Fizikë						
		Kimi						
		Astronomi						

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar dhe analizuar informacionet e dhëna për kuptimin dhe funksionin e rezultateve të të nxënimit, udhëzimet se si vijmë deri te rezultatet e të nxënimit për lëndë mësimore, hartoni me kolegë të fushës së kurrikulës rezultatet e të nxënimit për klasë sipas lëndëve mësimore:

1. Vendosni rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB;
2. Vendosni rezultate të pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve të fushës së kurrikulës Shkencat e natyrës;

3. *Vendosni rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) të fushës Shkencat natyrore.*

Aktivitetin mbështeteni edhe në udhëzimet e dhëna në faqen në vijim:

Udhëzime për plotësimin e tabelës: Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së kurrikulës bërthamë (KB)

Për plotësimin e kësaj table duhet të ndiqen disa hapa sipas udhëzimeve në vijim. Të njëjtat sugjerime vlejshme për çdo lëndë dhe për çdo klasë.


Hapi i parë: Në kolonën e parë të tabelës me emërtim - **Rezultatet e të nxënimit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës - nga KB** duhet të vendosen rezultatet origjinale (ashtu siç janë) të të nxënimit të fushës kurrikulare, të cilat mund t'i merrni në dokumentin e Kurrikulës bërthamë për shkallën e caktuar. Këto rezultate janë të vlefshme për të gjitha lëndët të cilat i përkasin fushës së kurrikulës për shkallën dhe klasën e caktuar.

Hapi i dytë: Në kolonën (kolonat) e tabelës ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF**, në secilën klasë duhet të vendosni rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese. Këto rezultate të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve të shkencave natyrore që i vendosni në këto kolona duhet të jenë vetëm ato që korrespondojnë me rezultatet e të nxënimit të fushës Shkencat e natyrës (RNF) dhe duhet të jenë origjinale, ashtu siç janë në plan dhe program.

Hapi i tretë: Në kolonën (kolonat) e tabelës, ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (kujto planifikimet dymujore)**, duhet të vendosni rezultatet e pritshme që ju mendojnë se duhet të shtohen, meqenëse rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese nuk i përmbushin mjaftueshëm rezultatet e të nxënimit të fushës Shkencat e natyrës (RNF).

Hapi i katërt: Në kolonën (kolonat) e tabelës, ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) (kujto planifikimet dymujore)**, puno sipas kësaj ecurie, **merrni rezultatet e hapit të dytë** - rezultatet e planeve dhe programeve ekzistuese të lëndës së caktuar të klasës së caktuar që korrespondojnë me rezultatet e të nxënimit të fushës (RNF) **dhe merrni rezultatet e hapit të tretë** - rezultatet pritshme të shtuara **dhe vendosni në klasën-klasat e caktuara** përmbi të cilave është emërtimi - **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)**. Këto rezultate duhet të jenë versioni final i dy hapave, të hapit të dytë dhe të hapit të tretë. **Rezultatet e këtyre dy hapave** (hapit të parë dhe hapit të dytë) duhet lexuar me kujdes dhe të përpunuara të vendosen në klasën – klasat që kanë emërtimin- **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) (kujto planifikimet dymujore)**. Tabela është e vlefshme për një shkallë, do të thotë për sa klasë që ka shkalla –për një gjeneratë. Procedurë e njëjtë duhet të ndiqet për të gjitha shkallët, si për shkallë 1, si për shkallën 2, si për shkallën 3... apo shkallën 6.

Nga ajo që u përshkrua më lartë lidhur me hierarkinë e ndërlidhjes së RNSH dhe RNF me nivelet tjera të planifikimit që zhvillohen në nivel shkollë, prezantohet figura në vijim, e cila orienton mësimdhënësit dhe akterët tjerë në shkollë se si ti qasen planifikimit mësimor dhe gjithashtu tregon se me arritjen e planifikimit mësimor në nivelin e caktuar si ndikojmë në arritjen e RNSH dhe RNF të vendosura në Kurrikulën Bërthamë.



III. ASPEKTE METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT TË MËSIMOR

Ky kapitull përqendrohet në planifikimet e procesit mësimor, si:

- *Planin mësimor*
- *Planin e shkallës kurrikulare*
- *Planin vjetor*
- *Planin dymujor*
- *Planin javor dhe në*
- *Planin e orës mësimore*
- *Çështjet ndërkurrikulare (çështjet ndërrendore) dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare*

3.1. Plani mësimor

- *Fusha kurrikulare / Lëndë mësimore*
- *Orë mësimore*

Para se të bëhet planifikimi më i detajuar i procesit mësimor (plani për shkallë, plani vjetor, dymujor) për një vit shkollor, së pari duhet përcaktuar saktë planin mësimor për klasën, përkatësisht vitin shkollor (mësimor).

Në kurrikulat bërthamë të të tri niveleve të arsimit parauniversitar ekziston liri, në një masë të caktuar, për organizimin e planit mësimor brenda fushave kurrikulare (shiko KB-në e nivelit II, klasat VI-IX f. 60, 87-89). Shkollat, mësimdhënësit janë të lirë të lëvizin numrin e orëve brenda fushës së njëjtë të shkallës kurrikulare nga klasa në klasë apo nga gjysmëvjetori në gjysmëvjetor dhe të bëjnë ndarjen e orëve mësimore në mes të lëndëve të ndryshme mësimore brenda fushës së njëjtë kurrikulare gjatë një viti shkollor apo për gjitha klasat sa ka shkalla kurrikulare. **Por, kujdes!** Nuk duhet tejkaluar totali i fondit javor që është caktuar me Kurrikulën Bërthamë (të nivelit të caktuar) për secilën fushë, për secilën shkallë dhe secilën klasë.

Për të arritur deri te një marrëveshje se me cilat lëndë do të fillohet dhe si do të bëhet ndarja e orëve, duhet pasur parasysh edhe disa kritere që janë përcaktuar në Kurrikulën Bërthamë të nivelit përkatës të arsimit, si:

- Duhet lexuar me kujdes rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare Shkencat e natyrës, se cilës lëndë po i jepet përparësi më shumë në shkallën përkatëse të kurrikulës;
- Duhet analizuar me kujdes rezultatet e të nxënit për shkallë-kompetenca, sidomos rezultatet e kompetencave që kanë elemente më të theksuara nga fusha kurrikulare Shkencat e natyrës;
- Duhet pasur parasysh ngarkesën e nxënësve;
- Duhet pasur parasysh përgatitjen e kuadrit arsimor.

Një shembull për procesin e diskutimit dhe vendosjes së planit mësimor për fushën Shkencat e natyrës

Në shkallën e tretë klasat 6 -7, sipas planit mësimor, fusha kurrikulare Shkencat e natyrës ka 8 orë për lëndët Fizikë, Kimi, Biologji. Faktikisht janë nga 4 orë për një vit shkollor, përkatësisht 4 orë për të tri lëndët e fushës për klasën e 6-të dhe 4 orë të tjera për klasën e 7-të. Por, shkolla, mësime të kanë liri të plotë që së pari të vendosin vet se këto 8 orë që janë përcaktuar për këtë fushë, për këtë shkallë, ta ndajnë nga 4 orë për vit (klasë) apo të vendosin edhe ndryshe, p.sh. në një vit të kenë p.sh. 3 orë e në vitin tjetër 5 orë. Por, gjithmonë duke u harmonizuar me fushat e tjera mësimore që të mos kalohet total i orëve javore për shkallën përkatëse, që është caktuar nga MASHT-i. Krahas kësaj mundësie, shkollat, mësime të fushës mund të pajtohen që një lëndë të caktuar, p.sh. Biologji, brenda numrit të përgjithshëm të orëve, të fushës, për klasën e caktuar, t'i japin më shumë ose më pak hapësirë. Kjo mund të bëhet me kusht që brenda fushës të ruhet balanca, kështu në klasën tjetër të shkallës, lëndëve tjera të fushës, në këtë rast Kimi dhe Fizikë, u jepet më shumë hapësirë (orë mësimore). Në harmonizimin e planit mësimor gjithashtu duhet pasur parasysh **prioritetin** që u japin rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare lëndëve mësimore, pra nëse në një klasë (vit të caktuar) rezultatet e përzgjedhura nga mësime të i përshtaten më shumë, p.sh. lëndës së Biologjisë, atëherë në atë klasë (vit mësimor) i jepen më shumë orë kësaj lëndë dhe anasjelltas në vitin tjetër p.sh. rezultatet i përshtaten më shumë lëndës së Fizikës, atëherë kësaj lëndë i jepen më shumë orë mësimore.

Shembull i planit mësimor (**kujdes** është vetëm shembull i ndarjes së orëve, shkolla vendos për ndarjen e orëve të mësimin në vite).

Kështu mund të duket një plan mësimor i fushës Shkencat natyrore, i dalë pas procesit të konsultimeve të mësime të fushës, pas analizës së rezultateve dhe segmenteve të tjera të paraqitura në pjesën paraprake.

Shkalla 3	Fusha mësimore	Lënda	Nr. i orëve		Përqindja (%) e orëve
Klasat 6 -7	Shkencat natyrore (8 orë në javë	Fizikë	Kl. 6	1.5	31.25%
			Kl. 7	1	
		Kimi	Kl. 6	0.5	31.25 %
			Kl. 7	2	
		Biologji	Kl. 6	2	37.50%
			Kl. 7	1	

Gjithsesi është e nevojshme që mësime të përcaktojnë së bashku mënyrën e zbatimit të planit mësimor. Këtë ata duhet ta bëjnë në bazë të kriterëve për hartimin e planit mësimor dhe mundësitë e zbatimit të tij sipas udhëzimeve që janë dhënë në KB-të për secilin nivel, p.sh. shiko KB-në e nivelit II (klasat VI-IX f. 90).

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për planin mësimor, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatitni një plan mësimor për të dy shkallët e nivelit të dytë të arsimit, shkallën 3 (klasat 6 dhe 7) dhe shkallën 4 (klasat 8 dhe 9) dhe përgatitni një arsyetim për ndarjen e orëve në vite.

Shkalla 3	Fusha mësimore	Lënda	Nr. i orëve		Përqindja (%) e orëve
Klasat 6 -7	Shkencat natyrore (8 orë në javë)	Fizikë	Kl. 6		
			Kl. 7		
		Kimi	Kl. 6		
			Kl. 7		
		Biologji	Kl. 6		
			Kl. 7		
Shkalla 4	Fusha mësimore	Lënda	Nr. i orëve		Përqindja (%) e orëve
Klasat 8 -9	Shkencat natyrore (10 orë në javë)	Fizikë	Kl. 8		
			Kl. 9		
		Kimi	Kl. 8		
			Kl. 9		
		Biologji	Kl. 8		
			Kl. 9		

3.2. Plani për shkallë kurrikulare

- *Rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetenca (RNSH)*
- *Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF)*
- *Përcaktimi orientues për klasë*

Planifikimi në nivel shkalle kurrikulare ndihmon në përcaktimin orientues të procesit mësimor të secilës klasë sa ka shkalla kurrikulare. Gjithashtu, sigurohet kontinuitet nga klasa në klasë dhe bëhet evitimi i përsëritjeve të paplanifikuara. Planifikimi për shkallë kurrikulare bëhet pasi që është bërë plani mësimor.

Si mund të bëhet planifikimi për shkallë kurrikulare?

Në këtë planifikim bëhet identifikimi i rezultateve të të nxënit për shkallë/kompetenca (RNSH) dhe të fushave kurrikulare (RNF) të shkallës përkatëse, së cilat do të jenë në fokus të arritjes për secilën klasë, me qëllim që mos të bëhet mbingarkimi i njërës nga klasat e shkallës kurrikulare. Gjithashtu, krijohet një pasqyrë e përfshirjes së të gjitha rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe fusha kurrikulare brenda shkallës kurrikulare.

Mësimdhënësit në këtë planifikim nëse e shohin të arsyeshme mund të parashohin edhe elemente të tjera, p.sh. konceptet e fushës, temat mësimore. Mbi bazën koncepteve dhe rezultateve të identifikuar mund të përcaktohen temat mësimore (TM) për secilën klasë. Këto

tema mund të jenë si pika referuese të planifikimit vjetor, por me mundësi ndryshimi gjatë procesit të planifikimit vjetor që bëhen për çdo vit shkollor.

Rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare/kompetencave, konceptet dhe rezultatet e fushës kurrikulare (në rastin tonë fusha Shkencat e natyrës) nëpër klasë, vendosen origjinal si janë në Kurrikulën Bërthamë. Mund të ndodh që këto rezultate të barten nga klasa në klasë, por janë temat mësimore të cilat e bëjnë dallueshmërinë e tyre. Për çështje praktike, sugjerohet që rezultatet të shkruhen me numra dhe të jenë në një rend me temën e përcaktuar që ka dalë nga këto rezultate (shiko shembullin në tabelën në vazhdim). Gjithashtu, në tabelë mund të bëhet planifikimi edhe i të gjitha fushave kurrikulare në mënyrë që të shohim prezencën e rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare/kompetencë në të gjitha klasat, sa ka shkalla përkatëse.

Shembulli i planit për shkallë kurrikulare:

Tab. 2. Niveli II, shkalla e tretë (klasat 6 dhe 7)

Fusha kurrikulare	Konceptet e përgjithshme të fushës	Rezultatet	Klasa e gjashtë	Klasa e shtatë
Shkencat e natyrës	Proceset jetësore	Rezultatet e të nxënit të shkallës/kompetencave p.sh shkalla III	p.sh rezultati I.1, II.5, III.5 (i njëjtë)	psh. II.1, III.4, III.5 (i njëjtë)
	Proceset fizike	Rezultatet e të nxënit të fushës (në rastin tonë të fushës Shkencat e natyrës)	p.sh. rezultatet I.3.1, I.4.1.	p.sh. rezultatet I.3.2, I.4.2.
Gjuhët dhe Komunikimi				
Artet				

Në tabelë rezultatet janë veç shembuj, ndërlidhja nuk është e saktë.

Gjatë këtij planifikimi mund të shohim se cilat rezultate (RNSH) ka nevojë dhe duhet t'i përsërisim nëpër klasa. Në këtë tabelë rezultatet e të nxënit janë vetëm shembuj, ndërlidhja nuk është e saktë. Qëllimi është vetëm të kuptohet ideja se disa rezultate të të nxënit nëse vlerësohet e arsyeshme mund të barten nëpër klasa (p.sh. në klasën e 6-të dhe në klasën e 7-të). Gjithashtu, RNSH-të – rezultatet e kompetencave mund të jenë të njëjta dhe mund të synohen edhe nga fushat e tjera kurrikulare. Rezultatet e kompetencave - RNSH-të, edhe pse barten nga klasa në klasë në kuadër të fushës së njëjtë kurrikulare, mund të ndërlidhen me rezultate të të nxënit të njëjta, apo të ndryshme të asaj fushe kurrikulare, në këtë rast fushës Shkencat e natyrës.

Çfarë lloj planifikimi për shkallë kurrikulare do të bëjnë mësimdhënësit e lëndëve të fushës përkatëse, në rastin tonë mësimdhënësit e lëndëve Biologji, Fizikë dhe Kimi. Por, gjithmonë duke pasur në mendje udhëzimet e dhëna më lart lidhur me përfshirjen e RNSH

(rezultatet e kompetencave) dhe RNF (rezultatet për fushë kurrikulare), edhe funksionin e planifikimit në planifikimet vjetore për klasat e shkallës së caktuar kurrikulare.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për planifikimin e shkallës kurrikulare, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatitni një plan për shkallë kurrikulare – në fushën Shkencat e natyrës.

Niveli II, shkalla e tretë (klasat 6 dhe 7)

Fusha kurrikulare	Konceptet e përgjithshme të fushës	Rezultatet	Klasa e gjashtë	Klasa e shtatë
Shkencat e natyrës		Rezultatet e të nxënit të shkallës/kompetencave p.sh shkalla III		
		Rezultatet e të nxënit të fushës Shkencat e natyrës		

3.3. Plani vjetor

Plani vjetor përmban këto elemente:

- *I referohet fushës kurrikulare - Shkencat e natyrës*
- *Rezultatet e kompetencave (rezultatet e të nxënit për shkallën e caktuar);*
- *Konceptet e fushës kurrikulare, marrë nga KB për shkallën e caktuar;*
- *Rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë, marrë nga KB për shkallën e caktuar;*
- *Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor. Tema shpërndahen (organizohen) në 5 cikle dymujore.*

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrës, është një kategori e gjerë mësimore që grupon lëndët Biologji, Fizikë, Kimi dhe Astronomi², që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për mësimin e njohurive, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve dhe besimeve nga kjo fushë. Bashkimi i këtyre lëndëve në fushën e kurrikulës *Shkencat e natyrës*, shtron kërkesë që mësimdhënësit e kësaj fushe të zhvillojnë së bashku planifikimin mësimor duke u mbështetur në rezultatet e të nxënit për fushë, specifikat e fushës dhe të lëndëve të fushës. Kjo nënkupton se procesi i planifikimit vjetor, pikë referimi ka fushën e kurrikulës.





Plani vjetor orienton zhvillimin e mësimin për një vit shkollor (mësimor) duke i përmbushur kërkesat e shkallës kurrikulare dhe duke i ndarë apo duke i thjeshtuar ato për klasën e caktuar (brenda shkallës). Planifikimi vjetor hartohet për secilën fushë kurrikulare (pra edhe për fushën **Shkencat e natyrës**) dhe ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënit të kompetencave, të cilat synohen të arrihen gjatë një viti shkollor (mësimor), si dhe

² Astronomia mësohet në gjimnazin Shkencat natyrore.

identifikimin e koncepteve dhe rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare nga të cilat do të përcaktohen përmbajtjet mësimore, që do të jenë në shërbim të arritjes së këtyre rezultateve.

Plani vjetor mbështetet në planin mësimor dhe në planin për shkallë kurrikulare të përcaktuar paraprakisht nga mësimdhënësit dhe gjithsesi në KB-në e nivelit përkatës, ku bën pjesë ajo shkallë kurrikulare.

Shembull, hapat që duhet ndjekur për planifikim vjetor, klasa e gjashtë.

Hapi 1 	Hapi 2 	Hapi 3 	Hapi 4 
RNSH –kompetencat	Konceptet	RNF	Tema mësimore
<p>P.sh. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: rez. nr. 4</p> <p>Kompetenca e të menduarit: rez. nr. 7</p>	Proceset jetësore	Dallon dhe përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.	Trashëgimia

Kujdes! Të dhënat e vendosura në tabelë janë vetëm shembuj për të plotësuar tabelën e planifikimit vjetor. Është detyrë e mësimdhënësve që japin mësim në fushën kurrikulare Shkencat e natyrës të vendosin për (i) vendosjen e RNSH-ve (rezultateve të kompetencave) (ii) për vendosjen e konceptit apo koncepteve që do të bëhen pjesë e planit vjetor, (iii) për vendosjen e RNF (rezultatet e të nxënit për fushë) që synohen të mbërrihen përmes temave mësimore, dhe (iv) vendosjen e temave që i përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore që do të mësohen në klasën përkatëse dhe që paraprakisht janë vendosur në planifikimin për shkallë të kurrikulës.

Përmbajtja mësimore duhet të jetë në funksion të mësimdhënies se integruar brenda fushës kurrikulare (**Shkencat e natyrës**), por edhe të fushave të tjera kurrikulare.

Temat mësimore janë tërësi mësimore të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore brenda një fushe kurrikulare. Gjatë identifikimit të rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare **Shkencat e natyrës**, mësimdhënësit mund të hasin në rezultate që anojnë më tepër te një lëndë mësimore dhe në këtë rast ndonjë temë mësimore edhe mund t'i dedikohet vetëm një lëndë mësimore. Megjithatë, qasja e KKK-së është e orientuar drejt mësimdhënies dhe nxënies së integruar, prandaj gjithmonë duhet synuar në përcaktimin e temave mësimore, të cilat janë reprezentative për të gjitha lëndët mësimore të fushës kurrikulare (**Shkencat e natyrës**).

Temat mësimore mund të jenë të pranishme disa muaj gjatë vitit shkollor (mësimor), por mund të ketë raste që të jenë pranishme edhe gjatë tërë vitit shkollor apo madje edhe gjatë disa viteve shkollore, brenda shkallës së njëjtë. Kjo varet nga rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare dhe nevojat e nxënësve. Temat mësimore pas përzgjedhjes shpërndahen në ciklet dymujore të planifikimit vjetor. **Shiko tabelën e më poshtme të planifikimit vjetor të fushës Shkencat natyrore.**


Me rastin e përzgjedhjes të temave mësimore duhet pasur parasysh përvojat, interesat dhe mundësitë e nxënësve.

Ashtu siç u pasqyruan në shembullin paraprak, për secilën temë mësimore duhet caktuar edhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare (kompetencë) të synuara të arrihen nga tema në fjalë dhe rezultatet e të nxënit për fushë të kurrikulës. Rezultatet e të nxënit mund të shënohen me numra, ashtu siç janë në KB - për shkallën përkatëse ose mund të shënohen edhe plota. Për çështje praktike edhe rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare, mund t'u vendoset nga një numër si dhe temës mësimore që korrespondon me të.

Me rastin e planifikim vjetor mund të shfrytëzohen burime të ndryshme që ndihmojnë përshtatjen e temave mësimore të përzgjedhura me moshën e nxënësve dhe aspektet pedagogjike. Duhet të kihet parasysh identifikimi i burimeve bazë për nxënës që janë në funksion arritshmërisë së kompetencave dhe rezultateve të fushës kurrikulare.

Për secilën temë mësimore duhet caktuar edhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare (kompetencë) të synuara të arrihen nga tema në fjalë. Rezultatet e të nxënit mund të shënohen me numra, ashtu siç janë në KB – për shkallën përkatëse. Për çështje praktike edhe rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare mund t'u vendoset nga një numër si dhe temës mësimore që korrespondon me të.

Me rastin e planifikim vjetor mund të shfrytëzohen burime të ndryshme që ndihmojnë përshtatjen e temave mësimore të përzgjedhura me moshën e nxënësve dhe aspektet pedagogjike. Duhet të kihet parasysh identifikimi i burimeve bazë për nxënës që janë në funksion arritshmërisë së kompetencave dhe rezultateve të fushës kurrikulare.



Shembull: Plani vjetor i fushave kurrikulare – shembulli për fushën Shkenca e natyrës, kl. 6-të

Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës kurrikulare (marrë nga KB)	Rezultatet e fushës te kurrikulës bërthamë(KB) marrë nga KB	Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve					Rezultate t ë komp. (RNSH)
				Shtator-Tetor	Nëntor - Dhjetor	Janar-Shkurt	Mars-Prill	Maj - Qershor	
SHKENCAT E NATYRËS	<p>Hulumtimi/kërkimi shkencor</p> <p>Zbatimi i shkencës dhe i teknologjisë</p> <p>Materia, vetitë dhe shndërrimet e saj</p> <p>Proceset fizike Proceset jetësore</p> <p>Toka dhe gjithësia</p>	<p>-Planifikon dhe kryen hulumtime të thjeshta shkencore, individualisht ose në grup, brenda dhe jashtë klasës duke mbledhur, duke analizuar dhe duke interpretuar të dhënat me qëllim të shpjegimit të proceseve dhe dukurive natyrore.</p> <p>-Përdor TIK-un dhe pajisjet e reja të komunikimit, veglat dhe mjetet e ndryshme të prodhuara përmes shkencës për të kuptuar proceset natyrore dhe për të zgjidhur problemet në jetën e përditshme.</p> <p>Dallon dhe klasifikon lëndët sipas përbërjes, strukturës, vetive fizike dhe kimike, shndërtimeve dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme.</p> <p>Përshkruan burimet e energjisë, format dhe shndërrimet e saj. -Demonstron bashkëveprimet mes trupave që takohen dhe që nuk takohen.</p> <p>Dallon dhe përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</p> <p>Shpjegon përbërjen e gjeosferës, hidrosferës, atmosferës, biosferës, proceset në to dhe ndërrimet e thjeshta të pozitës së trupave gjatë kohës.</p>	<p>1. Kërkimi shkencorë përmes vëzhgimit dhe eksperimentit</p> <p>2. Përdorimi i shkencës dhe i teknologjisë në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës.</p> <p>3. Lënda-përbërja, struktura, vetitë dhe shndërrimet e saj</p> <p>4. Energjia dhe bashkëveprimi mes trupave - lëvizjet dhe forca</p> <p>5. Qeniet e gjalla dhe marrëdhëniet reciproke me ambientin</p> <p>6. Mjedisi, hapësira dhe koha</p>	<p>1.1 Vëzhgimi (rëndësia, llojet e procesit)</p> <p>1.2 Eksperimenti (planifikimi dhe kryerja e veprimtarive)</p> <p>2. Roli i shkencës dhe teknologjisë për një jetë më cilësore</p>	<p>Lënda - (përbërja struktura vetitë, shndërrimet,)</p>	<p>Energjia dhe bashkëveprimi mes trupave</p> <p>(format, shndërrimet, mënyrat, lëvizja e trupave dhe forca)</p> <p>Qeniet e gjalla dhe marrëdhëniet reciproke me ambientin</p> <p>(riprodhimi, zhvillimi, ndërtimi, faktorët)</p>	<p>Energjia dhe bashkëveprimi mes trupave</p> <p>(format, shndërrimet, mënyrat, lëvizja e trupave dhe forca)</p> <p>Qeniet e gjalla dhe marrëdhëniet reciproke me ambientin</p> <p>(riprodhimi, zhvillimi, ndërtimi, faktorët)</p>	<p>Mjedisi, hapësira dhe koha (llojet, dukuritë, varshmëritë)</p>	<p>I.4.</p> <p>I.6.</p> <p>I.8.</p> <p>II.3</p> <p>II.4</p> <p>II.5</p> <p>III.2</p> <p>III.8</p> <p>IV.1</p> <p>IV.2</p> <p>V.5.</p> <p>VI.1.</p> <p>VI.2.</p> <p>VI.4</p> <p>VI.5</p> <p>VI.6.</p> <p>VI.7.</p>

Preferohet që në tabelën e planit vjetor të vendosen të gjitha fushat kurrikulare në mënyrë që lidhshmëria ndërmjet tyre dhe rezultatet e kompetencave të mund të kontrollohen dhe të krahasohen më lehtë. Kjo mundëson të ketë një pasqyrë të qarë të realizimit të rezultateve të të nxëniet të shkollëve kurrikulare/kompetencave, por edhe rezultatet e fushave.

Udhëzime për plotësim të tabelës

- Ky format i tabelës së planit vjetor përdoret për të hartuar planin për secilën klasë.
- Plani për të gjitha fushat të jetë i shkurtër dhe i qartë. Kjo formë e planifikimit u mundëson të gjitha fushave të kurrikulës që të kenë qasje te njëra-tjetra.
- Me rastin e hartimit të temave merren për bazë konceptet e fushës kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (RNF), që merren nga Kurrikula Bërthamë për shkallë, pjesë e secilës është klasa për të cilin po planifikohen temat mësimore. Konceptet e fushës kurrikulare Shkencat e natyrës janë të vlefshme për gjitha shkallët, përkatësisht për gjithë arsimin parauniversitar (shih KB - fushat e kurrikulës), por mësimdhënësi mbi bazën e këtyre koncepteve duhet të seleksionojë temat për secilën klasë sa ka shkalla e kurrikulës.
- Në kolonën e emërtuar rezultatet e fushës kurrikulare vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (origjinale të marra nga KB) vetëm ato që reflektohen në temë mësimore, pra vetëm ato nga të cilat dalin temat mësimore.
- Temat mësimore përbëhen prej disa njësive mësimore. Në këtë tabelë shkruhen vetëm temat, e jo njësitë mësimore. Temat mësimore janë të vlefshme për të gjitha lëndët që ka një fushë. Njësitë mësimore janë ato që i bëjnë të dallojnë lëndët brenda fushës. Njësitë mësimore, edhe pse janë të ndryshme nga lënda në lëndë, brenda fushës ato synojnë temën e përbashkët, secila prej këndit të lëndës së vet (p.sh. Biologji, Fizikë, Kimi, në Gjimnazin natyror edhe Astronomi).
- Brenda dy muajsh mund të jenë disa tema mësimore, 1, 2 tema apo me shumë, varësisht sa mësimdhënësi mendojnë se janë të nevojshme të trajtohen brenda muajve (preferohet numri i vogël i temave). Disa tema mund të jenë të pranishme edhe në muajt e tjerë, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të bëhet sipas një rendi logjik.
- Në shtrirjen mujore, temat zbërthen me më pak fjalë se çfarë do të trajtohet brenda tyre (shumë shkurt - ndoshta në formë të nëntemave) p.sh. shih konceptet e fushës kurrikulare Shkencat e natyrës. Temat lidhen me konceptet dhe rezultatet e fushës kurrikulare. Për secilin temë të përcaktuar bëhet një përshkrim i shkurtër për të. P.sh. **tema Energjia dhe bashkëveprimi mes trupave dhe përshkrimi i shkurtër për temën fokusohet për format, shndërrimet, mënyrat, lëvizjen e trupave dhe forcën.**
- Në kolonën kompetencat shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca që mendohet se duhet të arrihen përmes temave për secilën fushë. Këto rezultate mund t'i gjeni te rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare. Për çështje praktike, në kolonën Rezultatet e kompetencave, rezultatet i shënoni me numra origjinale si janë në KB, por gjatë planifikimit duhet të kuptohet në esencë rezultati i kompetencës, në mënyrë që të mund të bëhet ndërlidhja me segmentet e tjera të planifikimit. Mësimdhënësi i përcakton se cilat kompetenca - rezultate të kompetencës, synon t'i arrijë përmes fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temave mësimore. Së bashku, të gjitha fushat kurrikulare për sa klasë që ka shkalla duhet synuar të arrijnë të gjitha rezultatet e kompetencave, d.m.th. nëse shkalla i ka tri klasë atëherë për dy vite shkollorë-mësimore një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar, duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën Bërthamë. Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e shkallës (kompetencës) do t'i synojë t'i arrijë p.sh. në klasën gjashtë e cilat në klasën e shtatë. Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetence mund të synohet të arrihet në dy klasa radhazi, kjo i mbetet mësimdhënësit të vendosë.
- **Kujdes! Rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës**

Të rikujtojmë procedurat e nevojshme për plotësim të tabelës

- Tabela punohet nga **aktivet profesionale** të shkollës.
- Për secilën fushë kurrikulare **punojnë bashkërisht mësuesit** e lëndëve që i takojnë fushës kurrikulare Shkencat e natyrës. Kjo vlen për shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë.
- Në shkollën e parë dhe të dytë (shkollë fillore) **punojnë të gjithë mësuesit** e paraleleve, sa ka klasa e caktuar, por në këtë grup duhet të kontribuojë një përfaqësues i secilës fushë kurrikulare të shkollës së mesme të ulët.
- Pasi që planifikimi vjetor punohet për fushën e caktuar për klasën e caktuar, atëherë **mbledhet Këshilli i klasës** së caktuar dhe bashkërisht bëjnë planifikimin e secilës fushë kurrikulare dhe e vendosin në formatin e tabelës.
- Gjatë vendosjes në këtë tabelë përfaqësuesit e fushave, të klasës së caktuar (në shkollën fillore mund të jetë mësues/se klase) diskutojnë për përmbajtjen dhe kompetencat që synon t'i arrijë secila fushë për klasën e caktuar, në mënyrë që ndërlidhja në mes fushave të jetë sa më e pranishme.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIFIKIMIN VJETOR, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatitni një plan vjetor për fushën e kurrikulës Shkencat e natyrës.

3.4. Plani dymujor

Plani dymujor përmban këto elemente: *Temat mësimore, RNSH (kompetenca), RNF, korrelacionin dhe çështjet ndërkurrikulare, lëndët mësimore, RNL, njësitë mësimore, kohën e nevojshme, metodologjitë e mësimit dhe vlerësimet, burimet.*

Plani dymujor është rrjedhojë e planit vjetor të procesit mësimor. Ky planifikim hartohet për dy muaj dhe në fund të muajit të dytë bëhet një analizë e realizimit të planit dymujor dhe vazhdohet me planifikimin për dy muajt tjerë të viti mësimor. Gjatë një viti shkollor (mësimor) bëhen pesë planifikime dymujore dhe si tërësi ato marrin **formatin e një programi mësimor**. Nëse në planifikim vjetor është paraparë që brenda dy muajsh të trajtohen dy tema mësimore, atëherë duhet bërë zberthimi veç e veç për secilën temë, për muajt e njëjtë. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular, tabelë.

Planifikimi dymujor ka për qëllim zbërthimin e temave mësimore në njësi mësimore, të cilat kanë për synim arritjen e rezultateve të identifikuar të të nxënit të shkallës kurrikulare (kompetencave) dhe të fushës kurrikulare, për temën mësimore të caktuar. Gjithashtu, ka për qëllim identifikimin e rrugëve (metodologjisë), mjeteve, materialeve dhe burimeve për arritjen dhe vlerësimin e nivelit të arritjes së këtyre rezultateve. Elementet e planifikimit dymujor shikoni në tabelën e emërtuar Planifikimi dymujor i procesit mësimor.

Tema mësimore e përzgjedhur mund të ketë lidhmëni edhe me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare. Këtë lidhmëni duhet shikuar në planifikimin e përbashkët vjetor me fushat e tjera kurrikulare, me qëllim që të bëhet pjesë e planifikimit dymujor dhe kështu të mundësohet mësimdhënia dhe të nxënit e integruar.

P.sh. tema mësimore Mjedisi (orientimi në hapësirë), e shkencave natyrore, mund të ndërlidhet me fushën e Matematikës, përkatësisht me temën mësimore *Kahet e lëvizjes* (që trajton elementet para, mbrapa, lart, poshtë, majtas, djathtas), me fushën e Shëndetit dhe mirëqenies me temën *Ecja në natyrë*, me fushën e kurrikulës Shoqëria dhe mjedisi me temën *Gjeosferat, resurset dhe bashkëveprimet njeri-natyrë* etj.

Pjesë e planifikimit mund dhe duhet të jenë çështjet ndërkurrikulare, si të drejtat e njeriut, çështjet gjinore etj., të cilat mund të korrespondojnë me temën e përzgjedhur. Shiko pjesën çështjet ndërkurrikulare në KB – të dhe përmbajtjen e secilës fushë kurrikulare.


P.sh. nëse për temë mësimore në klasën e 6-të, Mjedisi, hapësira dhe koha, në fushën kurrikulare *Shkencat e natyrës* trajtohet për dy muaj, atëherë ajo mund të ndërlidhet me edukimin mjedisor.

Planifikimi dymujor i temës mësimore iu mundëson lëndëve mësimore të një fushe kurrikulare (në rastin tonë fushës *Shkencat e natyrës*), përmes njësive mësimore, arritjen e përbashkët të rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare por secilës nga këndi i vet.

Zbërthimit të temës mësimore në njësi mësimore duhet t'i paraprijë zbërthimi i rezultateve të fushës kurrikulare *Shkencat e natyrës*, nga të cilat (së bashku me rezultatet e kompetencës/shkallëve) del tema mësimore, në rezultate për lëndë mësimore për klasën e caktuar, p.sh rezultatet e fushës, shkalla 3, klasa 6.

Mësimdhënësi/sja gjatë zbërthimit të rezultatit të fushës nga e cila ka dalë tema mësimore në rezultatet e të nxënit për lëndë - klasë nga të cilat dalin njësitë mësimore, mund të shfrytëzojë planet dhe programet ekzistuese apo rezultatet përfundimtare marrë nga tabela krahasuese e rezultateve të fushës kurrikulare të KB, për shkallën e caktuar me rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese, (shiko materialin me lartë, pjesën II.3.3 tabelën e krahasimit të rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës kurrikulare *Shkencat e natyrës*). Nga kjo tabelë mund të zgjedhën vetëm ato rezultate që janë në funksion të rezultatit të nxënit të fushës nga e cila është dalë tema mësimore. Në të kundërtën, mësimdhënësi/sja mund edhe t'i hartojë vetë.

Shiko skemën e zërthimit të rezultateve të fushës kurrikulare (RNF) në rezultatet e të nxënit për lëndë/klasë (RNL). (RNF) së bashku me rezultatet e kompetencës ndikojnë edhe në përcaktimin e temave mësimore (TM) dhe një mënyrë edhe të njësive mësimore (NJM). Njëkohësisht skema tregon edhe procesin e përcaktimit të njësive mësimore.



SHEMBULL: Procesi i përcaktimit të njësive mësimore që do të zhvillohen brenda një planifikimi dymujor

Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës	Kontributi në RNF (shkalla 3)	Tema mësimore	Lëndët mësimore	RNL	Njësia mësimore	Kontributi në RNSH (kompetenca) (shkalla 3)
SHKENCAT E NATYRËS	Proceset jetësore	Planifikon kërkim shkencor të thjeshtë, paraqet të dhënat në tabele dhe diagrame, interpreton me gojë ose me shkrim informatat e mbledhura nga burimet e ndryshme.	Qeniet e gjalla dhe marrëdhëni et reciproke mes tyre dhe mjedisit.	Biologji	1.Përshkruan piramidën ushqimore duke shkuar prej bazës nga maja. 2.Interpreton qarkullimin e energjisë të piramidat ekologjike.	Piramidat ekologjike.	I. Komunikues efektiv: I.2 II. Mendimtar kreativ II.6. III. Nxënës i suksesshëm: III.3.
				Fizikë			
				Kimi			

Kështu vazhdohet të plotësohet tabela e planifikimit dymujor për të gjitha temat e dymujorit. Përzgjedhja e njësive mësimore, sikurse dhe temat mësimore, duhet të jetë në përputhje me përvojat, mundësitë dhe interesat e nxënësve. Ato duhet të kenë ndërlidhje me jetën e përditshme dhe të jenë aktuale.

Pasi që janë përcaktuar rezultatet e të nxënësve të lëndës dhe njësitë mësimore që do të zhvillohen brenda planifikimit dymujor, vazhdohet me plotësimin e segmenteve që lidhen me kohën e nevojshme për të realizuar njësitet e planifikuara në planin dymujor, metodologjinë e mësimdhënies, metodologjinë e vlerësimit dhe burimet. Edhe në këtë fazë të planifikimit, duhet të jenë pikë referimi: (i) Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës, (ii) Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës, dhe (iii) Korrelacioni me fushat kurrikulare dhe çështjet ndërlëndore.

I gjithë procesi i planifikimit dymujor pasqyrohet në pjesën e dytë të formatit të dhënë në faqen në vijim.

Tabela e planit dymujor

Klasa: Gjashtë

Muajt: Shtator-tetor

Fusha apo lëndët mësimore	Rezultatet e të nxënësve të lëndës	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet	Korrelacioni me fushat kurrikulare dhe çështjet ndërlëndore
Biologji	Përshkruan piramidën ushqimore duke shkuar prej bazës nga maja. Interpreton qarkullimin e energjisë te piramidat ekologjike.	Piramidat ekologjike.	2 orë	Metoda dhe teknika të mësimdhënies interaktive: -individuale -çifte -Gupe <i>Diagrami i Venit.</i>	VpN Vlerësimi i bazuar në kriter. Detyrat e shtëpisë.	Libri biologjia 6, Vizatime të gatshme Interneti Sllajde për prezantim.	
Kimi							
Fizikë							

Këto dy kolona, e mësimdhënies dhe e vlerësimit, është mirë të shoqërohen me aktivitete praktike. Nëse nuk bëhet këtu, atëherë të planifikohet në planin e orës mësimore.

Udhëzime për plotësim të pjesës narrative dhe tabelës

Pjesa narrative

Planifikimi

Plani dymujor sipas këtij formulari bëhet për një temë mësimore. Nëse brenda dy muajsh në planifikim vjetor janë parapa dy apo më shumë tema, atëherë duhet për secilën temë të bëhet planifikimi. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular (tabelë).

Secila lëndë e fushës duhet të pasqyrohet në tabelën e përbashkët për temën e përbashkët.

Temat mësimore

Tema mësimore merret nga tabela e planifikimit vjetor të temave për fusha të kurrikulës sipas planifikimeve për dy muaj. Temat ndërlihen me konceptet kryesore të fushës së kurrikulës.

Rezultatet kompetencave

Nga kompetencat që janë paraparë të arrihen te planifikimi vjetor - marrë nga KB-të, barten vetëm ato rezultatet të të nxënit për kompetenca që synohen të arrihen përmes temës mësimore - përmes lëndës mësimore. Tani rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion si është në KB. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate.

Rezultatet e fushës

Shënohen vetëm ato rezultate të të nxënit të fushës kurrikulare Shkencat e natyrës, që synohen të arrihen përmes temës së caktuar mësimore nga lënda mësimore e caktuar. Rezultatet duhet të merren nga planifikimi vjetor që janë marrë nga KB-të - shkalla e caktuar kurrikulare. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate. Është mire që për çështje praktike edhe rezultateve të fushave kurrikulare t'u vendoset numri i njëjtë, ashtu siç u është vendosur në planifikimin vjetor ndoshta edhe me narracion.

Korrelacioni

Korrelacioni bëhet mbi bazën e planifikimit vjetor të fushave kurrikulare. Me pak fjalë, përshkruani korrelacionin e temës që planifikohet me temat e fushave të tjera. Duhet të bëhet ndërlidhja e temës mësimore me çështjet ndërlëndore, si: edukimi mjedisor, globalizmi... etj. Shih KB-të, çështjet ndërlëndore.

Plotësimi i tabelës

Lëndët mësimore

Shënohen lëndët mësimore që janë në kuadër të fushës kurrikulare (p.sh. Biologji, Kimi, Fizikë...) dhe që trajtojnë temën e përbashkët, por secila nga këndi i vet.

Rezultatet e lëndës

Mësimdhënësi/sja shkruan rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore nga të cilat dalin njësitet mësimore. Në këtë rast mund t'i konsultojë - marrë nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me ato në KB-të, që synon t'i arrijë përmes njësisë mësimore. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate. Por, edhe mund t'i hartojë vetë. Secilit rezultatet të lëndës duhet t'i vendoset një numër. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore, mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, i gjitha varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërës të rezultatit.

Njësitë mësimore

Njësitë mësimore shënohen për lëndë. Mësimdhënësi përcaktohet për ato njësi mësimore që dalin nga rezultatet të nxënit të lëndës për klasë dhe që janë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe kompetencave të caktuara për temën e përbashkët të fushës kurrikulare.

Koha e nevojshme

Mësimdhënësi duhet të konsultojë planin mësimor që e ka zbërthyer nga KB-të për klasë. Ai vendos sa kohë (orë mësimore) i nevojitet, përmes njësive mësimore, të arrihen rezultatet e të nxënimit të lëndës mësimore (zhvillimit të kompetencave të caktuara të nxënimit).

Metodologjia

Të shkruhet në formë të aktiviteteve, duke i përmendur metodat dhe teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënimit, jo shumë të detajuara, sepse kjo bëhet në planin e orës mësimore.

Vlerësimi

Vlerësimi të paraqitet në formë të aktiviteteve dhe me çfarë instrumentesh bëhen ato. P.sh. test, ese, listë kontrolli, pyetësor etj.

Burimet

Të shkruhen burimet që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të caktuara. Ato mund të jenë të ndryshme (burimet e shkruara, elektronike, njerëzore etj.);

Burimet e shkruara mund të jenë tekste mësimore, gazeta, revista dokumente dhe materiale të ndryshme;

Burimet elektronike interneti, ueb-faqja, TV-kanali-emisioni, radio.

Burimet njerëzore mund të jenë njerëzit që janë pjesë zhvillimit të laboratorëve të shkencave natyrore, ngjarje, pune, etj.

Udhëzime shtesë për arsimin profesional

Te shkollat profesionale në tabelë shënohet edhe profili i caktuar.

Sugjerim: *Një planifikim i mirë kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale!*

Aktivitet:

*Pasi që keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIN DYMUJOR, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe **përgatitni një plan dymujor** për fushën e kurrikulës **Shkencat e natyrës**.*

3.5 Plani javor

Meqenëse plani dymujor nuk është i ndarë në javë, plani javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore, të cilat do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare) në klasën e caktuar. Njësitë mësimore merren nga plani dymujor.

Plani javor ka për qëllim lidhshmërinë e njësive mësimore të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemeve, dukurive dhe ngjarjeve si çështje të ndërlidhura e jo të ndara.

Kjo do të thotë që të gjithë mësimdhënësit/set e një klase (p.sh. kl. 6), të të gjitha fushave kurrikulare, të të gjitha lëndëve, në një tabelë të përbashkët të vendosin njësitë

mësimore që i kanë planifikuar t'i realizojnë gjatë javës për një klasë (edhe pse ato mund të jenë të ndryshme nga arsimtarët e së njëjtës lëndë, por që japin mësim në paralele të tjera brenda klasës së njëjtë). Kjo qasjeje i obligon mësuesit që të takohen gjatë javës dhe që të bëhet lidhshmëria e njësive mësimore në mes lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të nxënit e nxënësve të jetë më i integruar. Nëse ky takim për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta nuk mund të jetë i realizuar në të gjitha shkollat, sepse “kolektivi i mësimdhënësve është shumë i madh”! Atëherë kryetari i këshillit të klasave përmes kryetareve të aktiveve profesionale mund të qarkojë fletën në të cilën mësimdhënësit shkruajnë njësitë mësimore që do t'i zhvillojnë javën që vjen, ose pedagogu i shkollë, në shkollat ku ka pedagog. Më pas kjo fletë e përfunduar shumëzohet ose shpërndahet në mënyrë elektronike të gjithë mësimdhënësit/set e klasës së njëjtë para javës që realizohen njësitë mësimore. Është e preferueshme që planifikimi javor të publikohet edhe në sallën e mësimdhënësve, në mënyrë që të gjithë mësimdhënësit të jenë në dijeni se cilat tema/njësi mësimore realizohen gjatë javës dhe të ndihmojnë integrimin përmbajtjesor të fushave dhe lëndëve të kurrikulës.

Qasja e prezantimit/publikimit të planit javor para të gjithë mësimdhënësve, është një qasje e re në traditën e planifikimit mësimor, jetësimi në praktikë i kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale, bashkëpunim në mesin e të gjithë mësimdhënësve. Vlerësohet se kjo qasje mund të ndikojë në lehtësimin e të nxënit të nxënësve, në zvogëlimin e ngarkesës së nxënësve në provime dhe teste, sidomos nëse bëhet kujdes që të vendosen tema/njësi mësimore ndihmohen reciprokisht në mes të fushave të kurrikulës dhe lëndëve mësimore dhe nëse bëhet një përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe aktiviteteve që do të zhvillohen brenda një klase të caktuar.

Plani javor në mes fushave - shembull i realizuar nga mësuesit klasorë të një shkolle pilot

Dita	Njësitë mësimore në javë				Përshkrim i shkurtër
E hënë	1. Gjuhë dhe komunikim	2. Gjuhë dhe komunikim	3. Matematikë	4. Artet, Ed. figurative	Gjatë kësaj jave do të diskutohet për udhëtimet dhe aventurat p.sh në fushën Shoqëria dhe mjedisi , e cila do të jetë pikë referimi i fushave të tjera kurrikulare, si: Matematikë - Gjatë punës me libër kemi ilustrime të trenit, zhytësit. Numërimi i vagonëve
	Lexim në abetare f. 45	Paraqitja e tingullit dhe shkronjës H,h. Grafiku I shtypit f. 46	Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9 F. pune f. 36	Vizatojmë:Trenin, topin,hënë	
E martë	1. Matematikë	2. Gjuhë dhe komunikim	3. Gjuhë dhe komunikim	4. Shoqëria dhe mjedisi	
	Zbatime të mbledhjes dhe zbritjes me problem f. 54	Shkronja e madhe dhe e vogël H,h (grafiku I dorës) f. 47	Anglisht	Mjetet e udhëtimit	

					të trenit... Gjuhë dhe komunikim - Zhvillimi i shkronjës dhe tingullit H dhe T (hëna, treni, helikopteri) Shkencat e natyrës - Gjatë orës mund të diskutojmë për mjetet e udhëtimit se kur lëvizin për sa mund të lëvizin prej një vendi në vendin tjetër etj Jeta dhe puna – Diskutojmë për rregullat në trafik të mjeteve të udhëtimit (rregulla të thjeshta) Shëndeti dhe mirëqenia - Luajmë lojën 'Treni', ku fëmijët imitojnë zhurmën e trenit dhe renditen si lokomotivat.
E mërkurë	1. Matematikë	2. Artet, Ed. muzikore	3. Gjuhë dhe komunikim	4. Zgjedhore-Lexim shkrimi	
	Numri 10 f. 57	Mësohet kënga Tapshin tapshin	Plotësim në Abetare pune f. 36	Diktim	
E enjte	1. Gjuhë dhe komunikim	2. Matematikë	3. Shkencat e natyrës	4. Shëndeti dhe mirëqenia	
	Lexim dhe plotësim në abetare f. 47	Numrat prej 1 – 10 f. 58	Matja e kohës: ora, dita, nata	Loja e trenit	
E premte	1. Gjuhë dhe komunikim	2. Matematikë	3. Jeta dhe puna	4. Shëndeti dhe mirëqenia	
	Paraqitja e tingullit dhe shkronjës T,t. Grafiku i shtypit f. 48	Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10	Trafiku f. 13 (punëdore)	Orientimi në natyrë	

Aktivitet:

Pasi që keni analizuar shembullin e dhënë për PLANIN JAVOR, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe **përgatitni një plan javor** për fushën e kurrikulës **Shkencat e natyrës**.

3.6. Plani i orës mësimore

Plan i orës mësimore shërben që të gjitha planifikimet e procesit mësimor të bëhen të zbatueshme në punën e drejtpërdrejtë me nxënës në klasë dhe jashtë saj, brenda një ore mësimore.

Në këtë planifikim mësimdhënësi-ja përcakton:

- Njësinë mësimore të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimin dymujor, përkatësisht planifikimin javor);
- Rezultatet e synuara të kompetencave (të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore);
- Rezultatet e synuara të fushës kurrikulare (mund të vendosen vetëm rezultatet e lëndës mësimore që korrespondojnë me rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare **Shkencat e natyrës** - edhe këto merren nga planifikimi dymujor);
- Kriteret e suksesit, të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Të gjitha rezultatet e kompetencave, të fushave kurrikulare dhe të lëndëve mësimore, duhet të shënohen me numra të njëjtë si janë në planifikimin vjetor, e më pas në planifikimin dymujor, në mënyrë që të ketë një pasqyrë të saktë të realizimit, përkatësisht arritshmërisë së tyre. Mbi bazën e rezultatet e kompetencave dhe të fushës kurrikulare mësimdhënësi e

zhvillon orën mësimore, duke përcaktuar edhe elemente të tjera, të cilat i sheh të nevojshme. Mënyra organizative e orës - metodologjia e mësimdhënies dhe e vlerësimit, metodat, teknikat, mjetet dhe burimet që shfrytëzohen për realizim të njësisë së orës mësimore duhet të jenë në funksion të rezultateve të të nxënit të planifikuara për arritje, nevojave, mundësive dhe stileve të të nxënit të nxënësve.

Mësimdhënësi/sja mund të përdorë formate të ndryshme të planifikimit të orës mësimore, por çdoherë duhet pasur parasysh rezultatet e të nxënit të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, si dhe rezultatet e përcaktuar për lëndë mësimore.


Më poshtë shikoni format të mundshme të planit mësimor.

Shembull: Plani i orës mësimore

ASPEKTETE E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla: 3	Klasa: VI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset jetësore			
Tema: QENIET E GJALLA DHE MARRËDHËNIET RECIPROKE MES TYRE DHE MJEDISIT			
Njësia mësimore: Piramidat ekologjike			
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën 3:			
<p>I. (Komunikues efektiv). 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.</p> <p>II. (Mendimtar kreativ).6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.</p> <p>III. (Nxënës i suksesshëm).3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p> <p>VI. (Qytetar i përgjegjshëm).6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që i ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.</p>			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën 3:			
<p>I.3. Përshkruan rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit;</p> <p>5.1. Planifikon kërkim shkencor të thjeshtë, paraqet të dhënat në tabelë dhe diagrame, interpreton me gojë ose me shkrim informatat e mbledhura nga burimet e ndryshme.</p>			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE			

Fjalët kyçe: trofik, biomasë, prodhues, konsumues, zërthyes.
Rezultatet e të nxënit: Përshkruan piramidën ushqimore duke shkruar prej bazës nga maja; Interpreton qarkullimin e energjisë te piramidat ekologjike.
Kriteret e suksesit: Ndërlidh prodhuesit e rendit të parë, me prodhuesit e dytë (sekondar); Përshkruan transferimin e energjisë në zinxhirin ushqimor; Tregon mënyrën e përgatitjes së një piramide ushqimore nga kartoni.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, lapsi, fletorja, shemb. piramida ushqimore, tabela.
Përdorimi i TIK-ut:
Çështjet e ndërlidhura: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIFIKUAR TË ORËS MËSIMORE
Pjesa hyrëse Nxënësit në mënyrë që të vënë në veprim kujtesën japin përgjigjen se çfarë përfaqësojnë në zinxhirin ushqimor të një pylli, gjarpri, krimbi, vjedulla, bakteret, kërpudhat, bretkosa, miu, bimët, zogjtë.
Pjesa kryesore Pasi që në fazën e parë të orës nxënësit kanë shpjeguar shembujt e caktuar (prodhues, konsumues dhe zërthyes), ata dallojnë se prodhues janë bimët, por shtrohet pyetja se a janë vetëm ato prodhues? Përgjigjen e mësojnë pasi që arsimtari sqaron lidhjet ushqimore dhe vlerat e biomasës për çdo nivel ushqimor (trofik) të zinxhirit ushqimor. Sqarohet gjithashtu dhe piramida e energjisë fig. 22, ku dhjetë për qind nga ushqimi sjell rritje (zhvillim). Arsimtari tregon për mënyrën e përgatitjes së një piramide ushqimore prej kartoni sipas figurës në f. 30.



Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit

Nxënësit në çift skicojnë piramidën ushqimore, për të cilën dhe sqarojnë më pas.

Detyrë shtëpie, të gjithë nxënësit të japin përgjigje me shkrim pyetjeve f. 29 dhe punojnë piramidën ushqimore, sipas udhëzimeve të dhëna në pjesën kryesore të orës.

Aktivitet:

*Pasi që keni analizuar shembullin e dhënë për PLANIN E ORËS MËSIMORE, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatitni një plan të orës mësimore për njërën nga lëndët e fushës së kurrikulës **Shkencat e natyrës**.*

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe Mjedisi** / Lënda: Shkalla e kurrikulës: / Klasa:

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:

Tema / njësia mësimore:

Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën ____:

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën ____:
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fjalët kyçe:
Rezultatet e të nxënit:
Kriteret e suksesit:
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Përdorimi i TIK-ut:
Çështjet e ndërlidhura:
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Pjesa hyrëse:
Pjesa kryesore:
Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit:

3.7. Çështjet ndërkurrikulare (çështjet ndërlëndore) dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lënde. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore) dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimi për ndërmarrësi, edukimi për media, edukimi shëndetësor dhe seksual, edukimi mjedisor, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, etj.

Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në Kurrikulën nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Kështu, me rastin e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore në fusha të caktuara kurrikulare këto çështje duhet të merren parasysh, shih *planin mësimor te pjesa e 4.1 Metodologjia e mësimdhënies kur flitet për bimët te fusha kurrikulare Shkencat e natyrës. Njësia mësimore e përzgjedhur për bimët mund të jetë edhe në funksion të ndërgjegjësimit për mjedisin duke kontribuar në ruajtjen dhe kultivimin e tyre. Në këtë rast ndihmojmë nxënësit*

në arritjen e kompetencës kontribuues produktiv, respektivisht të rezultatit IV.3 të shkallës së tretë kurrikulare.

Gjithashtu gjatë planifikimit preferohet që këtyre temave t'u jepet hapësirë e veçantë në data të caktuar, si p.sh. Ditës së tokës, Ditës së drejtave të fëmijëve etj.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të bëhet edhe përmes projekteve hulumtuese dhe projekteve të natyrave të ndryshme, p.sh. projekteve promovuese (të vlerave shoqërore, produkteve), projekteve parandaluese etj.

Si realizohet korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare?

Suksesi i gjithë zbatimit të KB-ve qëndron në trajtimin e integruar të temave mësimore nga kënde të ndryshme të fushave kurrikulare. Kjo u mundëson nxënësve të kuptojnë funksionimin e jetës gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

Se si bëhet ndërlidhja ndërmjet lëndëve të shkencave të natyrës me fushat e tjera, shih detajet e dhënë në KB për arsimin e mesëm të ulët, f. 57.

IV. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE DHE BASHKËPUNIMI I MËSIMDHËNËSVE

Ky kapitull përqendrohet në:

Metodologjinë e mësimdhënies;

Materialet mësimore;

Vlerësimin e arritjeve të nxënësve;

Bashkëpunimin e mësimdhënësve.

4.1 Metodologjia e mësimdhënies në funksion të KKK-së dhe KB-ve

Planifikimi me kohë dhe i detajuar, i bazuar në kërkesat e KKK-në dhe KB-të, është hap më rëndësi të veçantë, i cili pritet të zbatohet me anë të një metodologjie të mësimdhënies, e cila gjithashtu duhet të jetë në funksion të KKK-së dhe KB-së. Kjo do të thotë se nëse është bërë planifikimi për shkallë kurrikulare, planifikimi vjetor, dymujor, planifikimi javor dhe ai i orës mësimore, duke i ndërlidhur ato në mënyrë logjike, mësimdhënësi do ta ketë më të lehtë zbatimin në praktikë.

Për zbatim praktik të planifikimit mësimor, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj, si në realizimin e aktiviteteve brenda orës mësimore, në dhënien e detyrave të shtëpisë, në aktivitetet ekstrakurrikulare, po ashtu edhe në aktivitetet jashtëkurrikulare, nevojitet përdorimi adekuat i metodologjive të mësimdhënies.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencë) (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) përveç që janë pika referuese të përzgjedhjes së përmbajtjes mësimore, temave mësimore, respektivisht njësisive mësimore në planifikimet e procesit mësimor, ato ndihmojnë edhe në përzgjedhjen e metodologjisë së mësimdhënies dhe të të nxënit konform filozofisë dhe parimeve të KKK-së. (Shih më lart dokumentin në pjesën II.2 Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo arsimore dhe pjesën e planifikimit-modelet e planifikimeve mësimore).

Mësimdhënësi duhet të aplikojë metoda që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm me nxënësin në qendër, metodologji që janë në funksion të arritjes së qëllimeve dhe mundësojnë përmbushjen e parimeve të KKK-së. Po ashtu, mundësojnë zhvillimin e RNSH dhe RNF të KB-ve. Metodatat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Metodologjia mësimdhënies dhe nxënies është një rrugë, e cila përcakton se si do të mbajmë një orë mësimore, ajo bazohet në këta komponentë. Në Kurrikulën Bërthamë të çdo niveli është dhënë një kapitull i veçantë për metodologjinë e përgjithshme – udhëzime, gjithashtu edhe në kapitujt për fushat e kurrikulës janë dhënë udhëzime metodologjike për zbatimin e fushës së kurrikulës, pra edhe të fushës Shkencat e natyrës. Udhëzimet në KB për metodologjinë e mësimdhënies duhet analizuar dhe duhet shfrytëzuar për të përmirësuar praktikën në klasë.

Përzgjedhja e metodologjisë dhe qasja e punës në klasë bëhet në bazë të synimeve për të arritur rezultatet e kompetencave, rezultatet e fushës së kurrikulit (në rastin tonë Shkencat e natyrës) rezultatet e lëndës mësimore, stileve të të nxënimit të nxënësve etj.



Mësimdhënësi synon që me zbatimin e metodologjisë të motivojë nxënësit për punë të suksesshme, të nxitë kreativitetin për komunikim efektiv, të forcojë bashkëpunimin në mes të nxënësve dhe të ndihmojnë ata në hulumtimin e burimeve të ndryshme të informacionit. KKK e Kosovës ka ndryshuar qasjen e mësimdhënies nga ligjërimi në lehtësim, gjë kjo që ka sjell një sfidë të re për mësimdhënësit. Kjo ecje drejt lehtësimit të të nxënimit të nxënësve është e rëndësishme për zotërimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive të shekullit 21.

Teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies

Kur kemi të bëjmë me mësimdhënien me në qendër nxënësin, para se të zhvillojë një orë mësimdhënieje, duhet të ketë parasysh që të përgjigjet në pyetjet në vazhdim.

Cilat shkathtësi dua t'i zhvillojë te nxënësit e mi? Cilat njohuri dua që t'i përfitojnë nxënësit e mi? Çka dua që të ndjejnë nxënësit e mi për këtë mësim dhe për këtë fushë tematike? Cilat besoj se do të jenë rezultatet e të nxënimit? Cilat kompetenca do të vazhdojnë zhvillohen më tej?

Varësisht nga FK dhe situata mësimore, mësimdhënësi është i shtyrë të përzgjedhë forma pune, strategji dhe teknika të mësimdhënies dhe të nxënies. Është gabim të thuhet se kemi një mostër të teknikave dhe strategjive mësimore, të cilat do të vlenin për secilën orë mësimore, për secilën situatë mësimore dhe për secilën moshë të nxënësve. Sidomos kur kemi të bëjmë me të nxënimit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësit, mësuesi është (duhet të jetë) vetëm lehtësues (ndërmjetësues) në procesin e të nxënimit dhe të mësimdhënies. Nëse për shembull kemi detyra problemore, ose edhe zgjidhje logjike të një problemi, detyre, situatë etj. Nga nxënësit duhet të kërkojmë që vetë të gjejnë zgjidhjen, të provojnë teknika e strategji për zgjidhje, e jo t'ua japim ndonjë zgjidhje. Është e rëndësishme që për çdo zgjidhje që ofrojnë

nxënësit të kërkojnë arsytimin për zgjidhjen e dhënë. Me shumë rëndësi është që të nxisim nxënësit të demonstrojnë procedurën e zgjidhjes, mjetet e përdorura.

Nëse kemi parasysh pyetjet e dhëna në kuti, atëherë mësimit duhet t'ia përshtat teknikat dhe strategjitë mësimore: cilën shkathtësi? Cilat njohuri? Cilat qëndrime? Cilën/at kompetencë/a do të zhvillojë te nxënësit? Në detyrën, si shembull, atëherë si shkathtësi do të ishte: komunikimi, llogaritja, ndjenja e kënaqësisë për rezultatin dhe të menduarit kritik/kreativ. (mësimit tanë, në vitet e fundit kanë ndjekur trajnime me rëndësi, si: MNQ, MK, QFE etj.), kështu që ata mund të përzgjedhin teknika dhe strategji mësimore, varësisht nga pyetjet e shtruar më lart (pra çfarë synojmë të arrijmë me rezultatin e paraparë).

Teknika dhe veprime

Cilat aktivitete mësimore do t'i përfshij në realizimin e orës?

Përse kam zgjedhur këto aktivitete/strategji?

Si mund ta realizoj mësimin dhe t'i bëj aktivitetet interesante për nxënësit?

Në përgatitjen ditore (PD) mësimit saktësisht duhet të shënojë aktivitetet që mendon që t'i organizojë për ta arritur rezultatet e të nxënës dhe kompetencën/at që synon të zhvillojë. Aktivitetet mësimore ndërlidhen (kushtëzohen) nga Teknikat Mësimore (TM). P.sh., nëse për realizimin e një rezultati të të nxënës në FK mund ta përdor teknikën Xhik Sou, Tufë mendimesh, eksperimenti, projekti e të ngjashme, atëherë ai duhet të përcaktohet dhe të përzgjedhë edhe materialet didaktike të veçanta. Te FK Shkencat natyrore ka një spektër më të gjerë të mundësive për përdorim të materialeve dhe për përzgjedhje.

Mundësia e përbashkët për të gjitha FK është zbatimi i pedagogjisë efektive gjatë mësimit dhe të nxënës. Për të arritur suksesin e dëshiruar, pedagogji efektive, për t'u siguruar se nxënësit janë komod gjatë të nxënës, atëherë mësimit duhet që:

- Të krijojë mjedis mësimor mbështetës (me mjete adekuate, raporte pozitive etj.);
- Të inkurajojë të nxënës reflektues dhe veprues (nxënësi reflektues përvetëson njohuritë e reja duke i ndërlidhur ato me atë se çfarë ai di, i përshtat ato me synimet të cilat i kthen në veprime mësimore). Roli i mësuesit në këtë fazë nuk është që të japë këshilla apo zgjidhje për problemin mësimor, por të inkurajojë nxënësit për vlerësimin e përmbytjes së detyrës/kërkesës së dhënë, qoftë mësimore apo edhe veprim për zhvillimin e ndonjë shkathtësie, qëndrimi apo vlere shoqërore);
- Të shtojë lidhjen me të nxënës e ri (dijen, shkathtësinë e re), (është vërtetuar se nxënësit janë shumë më të suksesshëm kur janë mirë të njohur me: përmbytjen (çka) mësojnë, pse duhet ta mësojnë atë, por edhe si do të mund ta përdorin atë njohuri, shkathtësi në jetën e përditshme. Për këtë arsye, më shumë rëndësi ka që mësuesi të nxisë kureshtjen e nxënësve, të kërkojë nga ata që të hulumtojnë të dhëna që lidhen me dijen/njohurinë, shkathtësinë që zhvillohet te ta, por edhe duke i sfiduar ata që ato t'i përdorin në kontekst dhe në rrugë/mënyrë të re. Më shumë rëndësi: inkurajimi i nxënësve që të marrin vetë vendime për të nxënës e tyre (Çka? Si? dhe Pse?);

- *Të ndihmojë/lehtësojë pjesëmarrjen e nxënësve në mësim;*
- *Të vendosë ndërlidhjen midis përvojës me të nxënësit pararendës (mënyrë shumë e mirë dhe e pranueshme për të nxënësit të suksesshëm, nëse krijojmë mundësi nxënësit që t'i ndërlidhin njohjen e re me përvojën dhe dijet paraprake, të cilat veç i kanë. Mësuesi duhet të ndihmojë nxënësit që ta ndërlidhin të nxënësit e ri me të nxënësit përgjatë fushave mësimore, por edhe me të nxënësit në jetën e përditshme (në shtëpi dhe nga burimet e tjera të të nxënësit). Të nxënësit vertikal dhe horizontal (kurrikular) është vendimtar për zhvillimin e kompetencave të parapara;*
- *Të ofrojë mundësi të mjaftueshme për të nxënësit (secilit nxënësit). Është vërtetuar se nxënësit janë shumë më të suksesshëm në rast se përfshihen në procesin e nxënies, aktivitetet mësimore praktike, sidomos nëse atij i mundësohet bartja e të njëjtës informatë (dije) të tjerët. Organizimi i të nxënësit garues, me projekt, zgjidhje të problemeve, luajtje e rolit, debati mësimor, janë me shumë rëndësi për të nxënësit të suksesshëm dhe të qëndrueshëm, me këtë edhe zhvillim i kompetencave të caktuara. Roli lehtësues i mësimdhënësit këtu është i pazëvendësueshëm. Për ta realizuar këtë me sukses atij i duhet që të përgatisë edhe materiale për zbatimin e teknikave dhe strategjive mësimore.*

Aktivitet:

*Pasi që keni lexuar dhe analizuar pjesën për metodologjinë e mësimdhënies në funksion të KKK-së dhe KB-ve, reflektoni për përvojën e praktikave në klasë, për përvojën tuaj të fituar nga programet e trajnimit në metodologji të mësimdhënies dhe përgatitni/ zbërtheni qasjen metodologjike të mësimdhënies dhe nxënies për një orë mësimore, ku fokusi është metodologjia e mësimdhënies në funksion të arritjes së rezultateve të kompetencave dhe rezultateve të fushës së kurrikulës **Shkencat e natyrës**.*


4.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)

Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësimdhënësit të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mësimore.

Mësimdhënësi mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuar dhe parimeve të KKK-së. Përzgjedhja adekuate e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.

Sot, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për gjithë nxënësit/et të së njëjtës moshë sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se mësuesit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuara. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësuesit, por edhe nga vetë nxënësit. ***Kujto të nxënësit duke vepruar!*** Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale të thjeshta, si letra, p.sh. kur e shpjegojmë zbatimin në praktikë të metodës shkencore, së bashku me nxënës përgatisim skemën e procesit në një flipqar ose tabelë të veçantë dhe të njëjtën e shfrytëzojmë për disa orë mësimore, derisa e realizojmë ndonjë projekt hulumtues me nxënës dhe sigurohemi se nxënësit janë në gjendje të zbatojnë metodën shkencore në hulumtime të ndryshme në fushën Shkencat e natyrës.



Secili mësues, i cilësdo fushë të kurrikulës, mund të sigurojë diçka nga mjetet për konkretizim. Shkollat të cilat kanë hapësirë të mjaftueshme mund të krijojnë qendrën e burimeve në të cilat krijojnë dhe i ruajnë mjetet mësimore (Mediatekat). Një pjesë të madhe të mjeteve mund ta krijojnë, me shumë kënaqësi, edhe vetë nxënësit (nëse viziton shkolla të ndryshme mund shohësh punime shumë atraktive të nxënësve, të cilat ose deponohen ose rrinë ashtu të pashfrytëzuara në korridore ose në sallën e mësuesve. Po sa ilustrime të bukura ka nëpër shkolla, të cilat do mund të shfrytëzohen si mjete shumë efektive për konkretizimin e temave të veçanta mësimore, për të zhvilluar debate, ose veprime të tjera mësimore? Mjafton që një ilustrim i një nxënësi, krijim para sa vitesh, ta shfrytëzojmë si mjet për debat mësor ose për zhvillimin e kulturës gjuhësore: përshkrimi (ese) ose zberthimi i dukurisë natyrore (të menduarit krijues/kritik).

Në shkolla gjenden punime të nxënësve si: Herbariume, piramida ekologjike, modele organeve, fotografi te proceseve jetësore etj., të cilat janë mjete të pazëvendësueshme për konkretizimin e koncepteve shkencore. Mësuesi i Kimisë shpjegon llojet e tretësirave nga skema në libër. Po të marrim një shishe qelqi (më mirë po të kemi mundësi arkë nga qelqi), në të cilin vendosim tretësira të ndryshme.

Sot flitet me të madhe për mjedisin dhe shëndetin (ndikimi i gjendjes/cilësisë së mjedisit në shëndetin e njeriut). Kur përmenden mbeturinat, si një ndër ndotësit e mjedisit dhe të rrezikimit të shëndetit të njeriut përmendet edhe riciklimi i mbeturinave. Në shumë raste me të mendohet në grumbullimin, ripërdorimin, shtypjen e shisheve plastike, letrës etj. Me mjete shumë të thjeshta

mund ta demonstrojmë riciklimin e letrës (marrim një enë, mikser për vezë, letër gazete dhe ujë të ngrohtë. Copëzojmë letrën duke e zbutur në ujin e ngrohtë dhe pastaj e përziejmë me mikser. Pas një kohe do të fitojmë një qull të cilin e shtrijmë në një dërrasë mbi të cilën vendosim edhe një dërrasë tjetër. E vendosim pakëz pjerrët. Të nesërmen kemi fituar një letër të ricikluar të cilën mund ta përdorim për qëllime të ndryshme. Kështu mund të veprojmë edhe me mbeturinat e zbërthyeshme (organike) nga të cilat mund të përfitojmë pleh organik, i cili ka shumë përparësi ndaj atij kimik. Cilat FK mund t'i zhvillojmë vetëm me këto dy veprime mësimore praktike? Gati të gjitha! Gjuhë dhe komunikim-përshkrimi i procesit me të folur dhe me shkrim, pasurimi i fjalësit të nxënësve, matematikë, llogaritja e përbërjes, proporcionit etj., shkenca të natyrë: biologji, kimi, fizikë, mjedisi dhe shoqëria: mbrojtja e mjedisi, menaxhimi i mbeturinave, zhvillimi i qëndrueshëm, kultivimi i kulturës së punës (qytetar i përgjegjshëm dhe kontribuues produktiv, individ i shëndetshëm, mendimtar kritik/krijues). Me këtë kemi realizuar edhe parimin e mësimin të integruar dhe ndër lëndor. Këtu mund të përfshihen, kësi lloj temash edhe çështjet tjera ndërkurrikulare, siç janë: barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve/njeriut, mjedisi, shëndeti etj.

4.3. Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit të arritjeve të nxënësve

Pas përgatitjeve të nevojshme për një fillim të mbarë të procesit mësimor (kujto procesin e planifikimit mësimor, llojet e planeve dhe metodologjitë e mësimdhënies), interes i mësimdhënësit është përcjellja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i secilit nxënës në kontekstin e arritjes së rezultateve të planifikuara për periudha të caktuara kohore.

Vlerësimi është proces i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjyqimeve lidhur me arritshmërinë ose performancën e nxënësve. Shiko fjalorthin në KKK.

Pyetje për diskutim: Si veproni në praktikën tuaj të vlerësimit të arritjeve të nxënësve? Sa është vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave?

Sipas kornizës së re të kurrikulës, qëllimi i aktiviteteve dhe vlerësimeve në klasë është zhvillimi i kompetencave të nxënësve. Kurrikula e re synon të ndihmojë nxënësit të fitojnë njohuri faktike dhe procedurale, të fitojnë shkathtësi të larmishme, të cilat i përdorin në procesin e të nxënësit dhe në jetën e përditshme të angazhohen në të menduar kritik të nivelit të lartë dhe të përvetësojnë vlera e qëndrime pozitive, të cilat iu mundësojnë të kontribuojnë në mënyrë më efektive në shoqëri.

Për të arritur këto synime të kurrikulës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me kurrikulën e re, qëllimet dhe parimet themelore të vlerësimit, duhet njohur RNSH (kompetencë) dhe RNF të shkallës së caktuar kurrikulare, si dhe procesin e vlerësimit duhet mbështetur në udhëzimet e dhëna për vlerësimin e nxënësve në Kurrikulat Bërthamë.

Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënësit në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNSH-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto

planifikime duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB-të (Kapitulli VII). Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e **vlerësimit të vazhdueshëm**, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor, bëhet **vlerësimi përfundimtar** në nivel klase dhe për secilën fushë kurrikulare lëndë mësimore nxënësit i vendoset nota shkronjë/numër, siç është paraparë në KB. Me të njëjtën procedurë duhet vazhduar me vlerësimin edhe në klasat pasuese përbrenda shkallës së caktuar kurrikulare dhe kështu për të arritur te **vlerësimi përmbyllës** në nivel shkalle kurrikulare (lexo procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe përmbyllës në KB-të, kapitulli VII.)

Për të konstatuar nivelin e arritjes së rezultateve të planifikuara në planifikime duhet kërkuar çdoherë prova dhe dëshmi në performancën e secilit nxënës-e.

Vlerësimi - zbatimi në praktikë. Në praktikë, me vlerësim kuptojmë kur *diçka* vlerësohet nga *dikush* në *një mënyrë të caktuar* dhe sipas *kritereve të caktuara*. Duke u nisur nga të kuptuarit praktik të konceptit të vlerësimit, mësimdhënësi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve duhet një sistemin e vlerësimit, për të cilin i ofruam disa informata paraprakisht, pastaj duhet të njohë qëllimin dhe funksionet e vlerësimit, llojet e vlerësimit, metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve. Njohja gjithëpërfshirëse e këtyre aspekteve të vlerësimit dhe njohja e rezultateve të të nxënësve (kujto pjesën e udhëzuesit: *Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënësve për shkallë (Kompetencat) (RNSH) dhe rezultateve të të nxënësve për fushë kurrikulare (RNF)*) do t'i ndihmojë mësimdhënësit në ndërtimin e metodologjisë së vlerësimit të nxënësve duke u mbështetur në rezultatet e të nxënësve.

Planifikimi i detyrave të përshtatshme të vlerësimit është një parim i mësimdhënies së mirë (*Ramsden, 2003*). Kjo nënkupton se planifikimi i vlerësimit bazuar në rezultatet e të nxënësve është kusht të cilin mësimdhënësit duhet ta bëjnë pjesë praktike të punës së tyre. Planifikimi i vlerësimit të nxënësve duhet të zhvillohet sipas hapave në vijim:

HAPI 1. Mësimdhënësi përcakton qëllimin e vlerësimit, pse po dëshirojmë të vlerësojmë, p.sh. vlerësojmë për të planifikuar mësimdhënien, vlerësojmë nivelin e progresit të arritjeve të kompetencave, vlerësojmë njohuritë akademike të nxënësve, vlerësojmë për të përmirësuar mësimdhënien, vlerësojmë përvojat e nxënësve, mënyrën e të nxënësve (stile) etj.

HAPI 2. Mësimdhënësi përcakton se çka do të vlerësojë, p.sh. RNF të lidhura me konceptin Hulumtimi/kërkimi shkencor. Për të bërë këtë, mësimdhënësi bën një analizë të planifikimit mësimor për këtë koncept të fushës kurrikulare Shkencat natyrore dhe të realizimit të planifikimit deri në fazën kur do ta bëjë vlerësimin e arritjeve të nxënësve. D.m.th. në këtë fazë, përcaktohet se në cilin koncept të fushës së kurrikulës, të temës mësimore dhe njësive mësimore, do të bëhet vlerësimi i arritjeve të nxënësve, i cili do t'i përgjigjet qëllimit të vlerësimit të përcaktuar paraprakisht?

HAPI 3. Pasi që janë përcaktuar RNF të lidhura me konceptin e fushës së kurrikulës, ku do të fokusohet vlerësimi i arritjeve të nxënësve, mësimdhënësi bën një analizë të rezultateve

specifike të të nxënit që do të matet arritëshmëria e tyre në këtë vlerësim. P.sh. cilat janë rezultatet specifike nga tema Hulumtimi shkencor?

- demonstroi shkathhtësi dhe shprehi praktike për hulumtim shkencor;
- formulon pyetje për hulumtim;
- harton projektin e hulumtimit;
- kryen hulumtime dhe matje kabinetike dhe në natyrë;
- manifeston aftësi të përpunimit dhe prezantimit të rezultateve hulumtuese etj.

Rezultatet e të nxënit duhet të përfshijnë së paku një veprim (V) dhe një qëllim (Q) dhe zakonisht duhet të përmbajë një ose më shumë kushte (Ku) dhe Kërkesa (KE) (Richard Webber, 2010). Hartimi i rezultateve të qarta të të nxënit është një hap i parë i rëndësishëm në procesin e vlerësimit që ndihmon të vendosen qëllime të qarta si për mësimdhënësin dhe për nxënësin. Është detyrë e mësimdhënësit që në rezultatet e të nxënit që do t'i vlerësojë t'i përfshijë të gjitha kërkesat e rezultateve, në mënyrë që matja dhe vlerësimi i tyre të bëhet në përputhje me kriteret e vlerësimit.

P.sh. 1. Nxënësi llogarit (v) koston e hulumtimit shkencor (Q) me programin e kompjuterit Exel (Ku) në mënyrë të saktë (Ke) dhe 2. Nxënësi harton (V) një projekt të hulumtimit në natyrë (Q) duke u bazuar në modelin e dhënë (Ku?).

HAPI 4. Mësimdhënësi bën një analizë të përmbajtjes së paraparë me planifikimin mësimor të realizuar deri në kohën e planifikimit të vlerësimit P.sh. nëse iu referohemi planit dy mujor të realizuar dhe shohim se tema Hulumtim në klasë është trajtuar dhe mësimdhënësi e di se nxënësi duhet të përvetësojë përmbajtjen e koncepteve bazë të kësaj teme, si: njohja me mjetet laboratorike, natyrën e laboratorit, përdorimi i veglërisë laboratorike, masat mbrojtëse për veten e tij dhe të nxënësve tjerë, mbajtja e rendit shtëpiak brenda klasës ku punohet me hulumtim, bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në hulumtim, respektim i të drejtës së secilit si pjesëmarrës në hulumtim, kontribuues në përkujdesje ekonomike të shfrytëzimit të preparateve të ndryshme kimike. Atëherë kjo temë dhe aspektet e saj të zhvilluara në procesin mësimor bëhen pjesë e vlerësimit të nxënësve.

HAPI 5. Mësimdhënësi bën një analizë të udhëzimeve për vlerësim të pasqyruara në Kurrikulën Bërthamë, veçanërisht të udhëzimeve për shfrytëzimin e RNSH dhe RNF, si dhe udhëzimeve për vlerësim në fushën e kurrikulës: Shkencat natyrore. Kjo analizë do të ndihmojë mësimdhënësin që të ndërtojë disa parime, të cilave u përmbahet në hapat në vijim të procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe ta orientojë vlerësimin në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve.

HAPI 6. Mësimdhënësi ka arritur në fazën e përzgjedhjes së teknikës së vlerësimit dhe instrumentit të vlerësimit. Është me rëndësi që teknika dhe instrumenti i vlerësimit të jenë të përshtatshme për vlerësimin e rezultateve të të nxënit. Për përgatitjen e instrumentit matës të vlerësimit mësimdhënësi duhet të ketë në konsideratë:

- * RNSH, RNF dhe rezultatet specifike të lëndës mësimore;
- * Peshën e dhënë secilës përmbajtje;
- * Aktivitetet e zhvilluara me nxënës;

- * Peshën e dhënë secilit nivel të dijës;
- * Llojin e instrumentit matës – **p.sh. testi**;
- * Llojin e kërkesave/pyetjeve.

Kjo pasqyrohet përmes një shembulli në tabelën e specifikave:

Nr.	Konceptet / përmbajtjet	Njohje	Të kuptuar	Zbatim dhe mendim kritik	Gjith.
1	Njohja e veçorisë laboratorike	1	1		2
2	Përdorimi i veçorisë laboratorike	1		1	2
3	Mbajtja e rendit shtëpiak në laborator	1	1		2
4	Bashkëpunimi	1		1	2
5	Kujdesi ekonomik		1	1	2
6	Gjithsej	4 (40%)	3 (30%)	3 (30%)	10 (100%)

Tabela e specifikave shërben për të (i) orientuar konceptet / përmbajtjet se ku do të fokusohemi gjatë përgatitjes së instrumentit të testit, (ii) përcaktuar nivelin e vështirësive të cilave do t'i përmbahemi gjatë përgatitjes kërkesave/pyetjeve dhe (iii) përcaktuar numrin e kërkesave/pyetjeve. Kjo nënkupton se mësimdhënësi duhet t'i plotësojë këto kritere gjatë ndërtimit të testit. Çdo kërkesë/pyetje që përfshihet në testin e vlerësimit duhet të mbështet në rezultatet e të nxënësit.

HAPI 7. Bëhet përcaktimi i kritereve të suksesit. Me kritere të vlerësimit bëhet përshkrimi se çfarë pritet të bëjë nxënësi, në mënyrë që të demonstrojë se rezultatet e të nxënësit janë arritur. Kriteret e suksesit e përcaktojnë nivelin që duhet të arrijnë nxënësit për të qenë të suksesshëm në kryerjen e detyrës. Kriteret e suksesit duhet të jenë të qarta dhe të shkruara në një mënyrë që të jenë lehtë të kuptueshme nga të gjithë nxënësit dhe duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit.

Shembull

Rezultatet e të nxënësit	Teknika e Vlerësimit	Kriteret e suksesit (1-5)				
		Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Nxënësi është në gjendje të:	Nxënësi është në gjendje të:					
Mbledh (V) fakte nga burimet mjedisore (Q) për të analizuar argumentet për dhe kundër idesë se qytetarët e Prishtinës jetojnë në qytetin më të ndotur në Kosovë (R)	Ese e shkruar me përfundim të hapur	Përdorim i shkëlqyeshëm i burimeve për të prodhuar analiza të qarta	Përdorim i shkëlqyeshëm i burimeve me analizë adekuate	Përdorim adekuat i burimeve me analizë relativisht të qartë	Përdorim adekuat i burimeve me analizë të dobët	Përdorim i dobët i burimeve me analizë të dobët

Kriteret e suksesit duhet të zërthehen sipas vlerësimit 5-shkallësh. Zbërthimi i kritereve e lehtëson punën e mësimdhënësit për të vendosur notat sipas procedurave të vlerësimit.

Aktivitet:

*Pasi që keni lexuar dhe analizuar pjesën për vlerësimin – planifikimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në bazë të rezultateve mësimore, reflektoni për përvojën e vlerësimit në praktikën e klasës, për përvojën tuaj të fituar nga programet e trajnimit në metodologji të vlerësimit dhe **merrni së paku tre shembuj të rezultateve të kompetencave që janë të lidhura ngushtë me fushën Shkencat e natyrës ose tre shembuj nga rezultatet e fushës Shkencat e natyrës (shkalla 3), ose tre shembuj nga rezultatet e lëndës mësimore, për të cilat pastaj përcaktoni teknikat e vlerësimit dhe kriteret e suksesit.***

Nr.	Rezultatet e të nxënësve	Teknika e Vlerësimit	Kriteret e suksesit (1-5)				
	Nxënësi është në gjendje të:		Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
1							
2							
3							

Kriteret e zbërthyerë për njësi mësimore janë të pranueshme edhe nëse bëhen sipas tri niveleve të arritjes: **Nivel i ulët, nivel mesatar dhe nivel i lartë**. Kjo ndarje i mundëson mësimdhënësit t'i zbërthejë kriteret sipas segmenteve tematike të njësisë mësimore. Shiko shembullin në vijim.

Shembull i një plani të vlerësimit të rezultateve të të nxënësve për një njësi mësimore:

Fusha e kurrikulës /Lënda: Shkencat e natyrës/ Fizika.

Detyra kryesore me nxënës: Në grupe, kryhet eksperimenti për përfitimin e rrymës elektrike nga limoni.

Rezultatet e të nxënësve: Nxënësit janë në gjendje të:

- Shpjegojnë dhe demonstrojnë procedurën dhe fazat kryesore të eksperimentit;
- Identifikojnë dhe zgjidhin problemet në faza të ndryshme të eksperimentit;
- Punojnë në grupe dhe t'i ndajnë detyrat qartë dhe në frymë të punës ekipore.

Kriteret e suksesit:

- Secili grup dhe pjesëtarët e tij përfitojnë dritën elektrike në fund të eksperimentit;
- Nxënësi analizon se paku së paku dy mënyra alternative të zgjidhjes së problemit gjatë eksperimentimit.
- Secili nxënës mban së paku një element pune ose ndihmon kolegun, gjatë kryerjes së detyrës ekipore.

Tabela vlerësuese e mësimdhënësit

Kriteret e zbërthyerë	Nivel i ulët (ka nevojë për përmirësim)	Nivel mesatar (i realizuar)	Nivel i lartë
Përfitimi i rrymës elektrike	Grupi nuk mund të përfitojë rrymën elektrike.	Grupi përfiton rrymën por me vështirësi.	Tërë grupi përfiton rrymën dhe e përsërisin eksperimentin me sukses.
Zgjidhja e problemeve	Problemet vazhdojnë dhe ndikojnë në vetëbesimin e nxënësve.	Problemet zgjidhen pas disa orvatjeve.	Problemet zgjidhen shpejtë e në mënyrë efektive përmes bashkëpunimit.
Puna ekipore	Vetëm një ose dy nxënës kryejnë shumicën e punëve – të tjerët vëzhgojnë dhe nuk e kanë të qartë rolin e vet .	Ka orvatje të përbashkëta por rolet nuk janë gjithnjë të qarta.	Ka një ndarje të qartë të roleve dhe punë të strukturuar mirë drejt rezultateve të përbashkëta.
Të kuptuarit e procedurës	Vetëm dy-tre anëtarë të grupit i kuptojnë bazat e eksperimentit.	Shumica e nxënësve e kuptojnë dhe mund të analizojnë procedurën.	Të gjithë nxënësit mund të demonstrojnë tërë procedurën.

Aktivitet: Duke u bazuar në shembullin paraprak, përzgjidheni një mësim ose njësi që do të zhvilloni në ditët në vijim. Hartoni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënit, zgjidhni një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit.

Fusha e kurrikulës/Lënda: _____

Detyra kryesore për nxënës: _____

Rezultatet e të nxënit:

1. _____
2. _____
3. _____

Kriteret e suksesit:

1. _____
2. _____
3. _____

Tabela vlerësuese e mësimdhënësit

Kriteret e zbërthyer	Nivel i ulët (ka nevojë për përmirësim)	Nivel i mesëm (i realizuar)	Nivel i lartë

Dy shembujt në vijim e pasqyrojnë ndërlidhjen e rezultateve specifike të të nxënit me kërkesat/pyetjet që u shtrohen nxënësve:

Shembulli 1:

Rezultatet e pritshme. Nxënësi njihet veçlërinë laboratorike.

Kërkesa/pyetja: Emërto veglat në foto (për çdo emërtim të sakët nxënësi fiton 1 pikë).



Shembulli 2:

Rezultatet e të nxënit (specifike për lëndë). Nxënësi përdor instrumentet e zakonshme dhe mat temperaturën me termometër.

Kërkesa/pyetja: Nxënësve u jepen pajisjet, dhe u kërkohet ti montojnë veglerinë në përputhje me udhëzimet e dhëna (5 pikë). Pastaj ata nxehin pak ujë, duke matur temperaturën e tij çdo një minutë për dhjetë minuat me radhë (+ 3 pikë).



Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim të gjitha procedurat e përpunuara më lart, si dhe të kemi në kujdes edhe segmentet e veçanta, si:

- Së pari për fushën e caktuar kurrikulare përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Pastaj përcaktojmë nivelin e arritjes së kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës (Kujto zbërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë dhe shih pjesën e udhëzuesit për rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre);
- Më pas caktohet tema apo njësia mësimore përmes së cilës matim rezultatin e kompetencës;
- Dhe, në fund caktohen teknika dhe instrumenti adekuat përmes të cilave matet rezultati i kompetencës (RNSH). Kujto! Rezultatet e kompetencave nuk janë vetëm njohuri, por edhe shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina. Shih KB, fushat kurrikulare, pjesën e vlerësimit.



Disa udhëzime shtesë lidhur me këtë:

Marrim një rezultat të një kompetence dhe e ndërlidhim me vlerësimin e nxënësve në funksion të kompetencave.

Rezultati nr. 3, kompetenca e të nxënësve: Nxënës i suksesshëm, në shkallën 5 të kurrikulës ka këto kërkesa: *Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënësve të vet për temën ose problemin e caktuar.*

Për arritjen e këtij rezultati të kompetencës kontribuojnë të gjitha fushat e kurrikulës. Këtë e bën edhe fusha e kurrikulës Shkencat natyrore, p.sh. përmes rezultatit të fushës për shkallën 5 të kurrikulës: *Analiza dhe hulumton llojllojshmërinë e botës së gjallë si rezultat i evolucionit, rolin e ADN-së në trashëgimi dhe në procese....*

Koncepti për këtë rezultat të fushës së kurrikulës: Proceset jetësore.

Tema: Trashëgimia.

Rezultatet specifike të të nxënësve për temë dhe lëndë mësimore (biologji):

- vlerëson rëndësinë e zbulimit të strukturës së ADN-së;
- emërton katër bazat të ADN-së;
- krahason strukturën e përgjithshme të ADN-së dhe ARN-së;
- përshkruan procesin e replikimit të ADN-së;
- dallon vetitë trashëguese dhe jotrashëguese;
- identifikon sëmundjet trashëguese të njeriut;
- vlerëson rëndësinë e njohjes me kohë të sëmundjeve trashëguese të njeriut, etj.

Nga arritja e kësaj teme mësimore, përkatësisht nga arritja e rezultateve specifike të të nxënësve për këtë temë dhe lëndë mësimore, nxënësit zhvillojnë edhe kompetencën e të nxënësve të suksesshëm, përkatësisht arrijnë rezultatin 3 të kësaj kompetence, sepse ata zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, vlerat dhe besimet, duke realizuar diskutime në klasë, mbledhje të burimeve për temë dhe demonstrimin e veprimeve të caktuara për të përshkruar apo vlerësuar segmentet të caktuara nga kjo temë.

Në këtë situatë mësimdhënësi i vlerëson njohuritë faktike dhe procedurale, shkathtësitë, qëndrimet, vlerat dhe besimet.

Njohuritë: Shkëmben përvojat, identifikon, përshkruan, emërton etj.

Shkathtësitë: Diskuton në grup, pjesëmarrje aktive, zbaton parimet, shfaq kreativitet, shkathtësi të komunikimit, shtrimit të pyetjeve etj.

Qëndrimet, vlerat dhe besimet: I përgjegjshëm, bashkëpunues, respekton faktet, vlerësoni sigurt, kureshtar.

Vlerësimi i bazuar në kompetenca³. Mësimdhënësit mund të përdorin një spektër më të gjerë të instrumenteve për të vlerësuar *kompetencat e nxënësve* – shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre dhe jo vetëm dijen e njohuritë e tyre për faktet. Vlerësimi i bazuar në kompetenca është po ashtu edhe më gjithëpërfshirës dhe shkon përtej një procesi njëkahësh: mësimdhënësit ende i vlerësojnë nxënësit, por ata mundësojnë edhe vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë, duke i angazhuar nxënësit në procesin e nxënies e të vlerësimit të vetvetes. Në fund, vlerësimi i bazuar në kompetenca është më mirë i integruar në procesin e mësimdhënies e të nxënies dhe është në funksion të përmirësimit të praktikave të mësimdhënies. Përmes përdorimit të kësaj qasjeje mësimdhënësit në vazhdimësi e vlerësojnë shkallën dhe vlerën e të nxënies të demonstruar nga nxënësit dhe, në bazë të informacioneve të kësaj, mund të sjellin gjykime për gjërat që duhen bërë për të përmirësuar rezultatet mësimore të nxënësve.

Duke konsideruar vlerësimin, në shumicën e rasteve, duhet të bashkoni standardet e caktuara të kompetencave, në mënyrë që ato të mbulojnë të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë relevante të kërkuara për ofrimin e vlerësimit të besueshëm. Këto grupe të kompetencave pastaj shpesh mund të vlerësohen së bashku. Për të menaxhuar këtë ju duhet të mblidhni dëshmi, të cilat kur krahasohen me kriteret e performancës ofrojnë dëshmi të kompetencës. Dëshmia mund të jetë e ndryshme dhe mund të mblidhet nga një numër i burimeve. Shih figurën 1 më poshtë për një varg të teknikave për mblidhjen e të dhënave (dëshmimeve).

Llojet e të nxënies: Rezultatet e të nxënies	Çfarë kërkohet nga nxënësit?	Shembuj të vlerësimit
Mendimi në mënyrë kritike dhe gjykimet.	Zhvillimi i argumenteve , reflektimi, gjykimi dhe vlerësimi.	Ese Raport, Rishikimi i teksteve.
Zgjedhja e problemeve/Zhvillimi i planeve.	Identifikimi i problemeve, definimi i problemeve, analizimi i të dhënave, rishikimi, dizajnimi i eksperimenteve, planifikimi, aplikimi i informacioneve.	Skenari i problemeve Puna në grupe Problem i bazuar në punë Analizimi i një rasti.
Përfundimi i procedurave dhe demonstrimi i teknikave.	Leximi, përdorimi i pajisjeve, përcjellja e procedurave laboratorike, përcjellja e protokolleve, ndjekja e udhëzimeve.	Demonstrimi, luajtja e rolit Incizimi i një video (shkrimi i një skenari/ Prodhimi i një posteri Raporti nga laboratorit.
Demonstrimi i njohurive dhe kuptimi (Mund të vlerësohet në bashkëpunim me llojet e të nxënies të përmendura më lartë).	Të përshkruajë, të raportojë, të identifikojë, të rinumërojë, të ndërlikojë etj.	Test me shkrim, me gojë Ese Raportet Pyetje të shkurta me përgjigje Teste të vogla.

³ Kjo pjesë është adaptuar nga moduli 5 i përgatitur nga MASHT & GIZ IS për aftësimin e mësimdhënësve në shërbim: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve

Menaxhimi/zhvillimi i vetvetes.	Të kërkojë në bashkëpunim dhe në mënyrë të pavarur, të vetorientohet, të menaxhojë kohën, të menaxhojë detyrat.	Ditari i të nxënit, Portfolio Vetë – vlerësimi Projektet në grupe Vlerësimi në mes të kolegëve.
Dizajnimi, krijimi dhe përforcimi.	Dizajnimi, krijimi, përformimi, prodhimi, etj.	Dizajnimi i projektit Portfolio, Prezantimi Performanca.
Vlerësimi dhe menaxhimi i informatës.	Kërkimi dhe rifitimi i informacionit, hulumtimi, interpretimi dhe rishikimi i informatës.	Bibliografitë përshkuese Detyra e kërkimit në bibliotekë Projekte me bazë të të dhënave.
Komunikimi	Shkathtësitë e shkruara, orale, vizuale dhe teknikes.	Prezantimi i shkruar Prezantimi oral Diskutimet/Debatet/luajtja e roleve, Puna në grupe.

Adaptuar nga teknikat e ndryshme të mbledhjes së dëshmive (CBET për punësim, GIZ, prill 2013) & Nightingale et.al. 1996)

Dallimet në mes të vlerësimit të të nxënit të bazuar në kompetenca dhe atij të bazuar në përmbajtje – AKTIVITETE PËR PUNË PRAKTIKE

Detyra 1:

Rezultatet e të nxënit: nxënësit mësojnë dhe mbajnë mend të dhëna të reja për tema/objekte/çështje/ të ndryshme.

Detyra 1: Imagjinoni që keni kërkuar nga nxënësit të:

- Mësojnë fakte për ngarkesat elektrike dhe rrymat;
- Mësojnë fakte për tokën dhe gjithësinë;
- Mësojnë fakte për metabolizmin;
- Mësojnë për karakteristikat e sistemit periodik;
- Mësojnë fakte për jetën në Polin e Veriut;
- **Ose ndonjë temë tjetër.**

Si do të testoni njohuritë e nxënësve për këto? Zgjidheni njërën nga detyrat e lartpërmendura dhe përshkruani në dy-tri fjali si do të organizoni procesin e vlerësimit dhe cilat metoda të vlerësimit do të përdorni.


Detyra 2:

Rezultatet e të nxënit: Nxënësit mësojnë të identifikojnë, klasifikojnë dhe mbledhin informacione relevante për tema/çështje/ të ndryshme.

Detyra 2: Imagjinoni se keni kërkuar nga nxënësit VETË të mbledhin informacione për:

- *Ngarkesat elektrike dhe rrymat;*
- *Tokën dhe gjithësinë;*
- *Metabolizmin;*
- *Sistemit periodik;*
- *Jetën në Polin e Veriut;*
- ***Ose ndonjë temë tjetër.***

Si do të gjeni nëse nxënësit kanë mbledhur informacionin e duhur? Zgjidheni njërën nga detyrat më lartë dhe tregoni se si do të vlerësoni nëse nxënësit kanë kryer detyrën.



Detyra 3:

Rezultatet e të nxënësve: Nxënësit mësojnë të kërkojnë dhe zgjedhin informacione relevante dhe të prezantojnë rezultatet e njohurive të tyre para shokëve.

Detyra 3: Imagjinoni se keni kërkuar nga grupe të nxënësve të mbledhin dhe prezantojnë (në forma të ndryshme) para klasës informacione për:


- *Ngarkesat elektrike dhe rrymat;*
- *Tokën dhe gjithësinë;*
- *Metabolizmin;*
- *Sistemin periodik;*
- *Jetën në Polin e Veriut;*
- ***Ose ndonjë temë tjetër.***

Si do të organizoni procesin e vlerësimit për të kuptuar nëse nxënësit e kanë kryer këtë detyrë? Kë do ta angazhoni nëse keni nevojë për ndihmë rreth vlerësimit?

Cila duket më adekuate për këtë qëllim: një test me shkrim? Një test me gojë? Një diskutim në grup? Një prezantim me poster? Një prezantim multimedia? Një lojë rolesh? etj.

A do të organizoni prezantime? Për çfarë pajisje do të keni nevojë?

Çfarë materiale do të nevojiten? Çfarë shkathtësi duhet të kenë nxënësit për hulumtim/prezantim? Si do t'i notoni nxënësit: me numra, komente përshkruese, shpërblime simbolike?



Detyra 4:

Rezultatet e të nxënësve: Nxënësit ndërtojnë shkathtësi dhe qëndrime të punës ekipore dhe angazhohen në përpjekje ekipore për të arritur rezultate dhe qëllime të përbashkëta.

Detyra: Imagjinoni se keni kërkuar nga nxënësit të bëjnë një projekt për:

- *Instalimin e rrymës elektrike;*
- *Jetën në Polin e Veriut;*
- *Zhvillimin e kërpudhave në mjedisin ku ata jetojnë;*
- *Ndotjen e mjedisit;*
- ***Ose ndonjë temë tjetër.***

Çfarë do të vlerësoni? Si do të vlerësoni? Ku do të vlerësoni? Kush do të vlerësojë rezultatet? A do të jetë në formë të ekspozitës? Në klasë ose në korridorin e shkollës? Si do të vlerësoni punën ekipore, njohuritë e reja, shkathtësitë e reja?

Si do të vlerësoni qëndrimet? Çfarë mendoni për ndarjen e kontributit individual drejt qëllimeve të përbashkëta?

Vlerësimi i vlerave dhe i qëndrimeve⁴. Vlerësimi i fushës emocionale është i rëndësishëm. Ajo është shumëdimensionale dhe një nga dimensionet të cilat shtjellohen në këtë udhëzues janë qëndrimet. Vlerësimi i qëndrimit apo qëndrimeve paraqet një detyrë të vështirë, ngase qëndrimet burojnë nga bindjet dhe vlerat e nxënësve. Ekzistenca e një qëndrimi mund të konstatohet nga fjalët dhe sjelljet e nxënësit. Dy nga mjetet më të zakonshme për vlerësim në fushën afektive janë:

Listë kontrolli - paraqet instrumentin më të zakonshëm dhe ndoshta më të lehtë për vlerësim në fushën afektive. Ajo përmban disa karakteristika, të cilat nxënësi ose mësimitdhënësi i kategorizon si “e pranishme” ose “mungon”. Hapat e ndërtimit të një liste të tillë janë:

- Renditni të gjitha vetitë dhe karakteristikat të cilat dëshironi t’i vrojtoni.
- Radhitni këto veti në një “listë” të karakteristikave.
- Kërkoni nga nxënësit t’i shënojnë ato veti, të cilat janë të pranishme dhe të mos shënojnë asgjë pranë atyre që nuk janë të pranishme.

Vetëraportimi – individi duhet të shpjegojë qëndrimet ose ndjenjat e tij lidhur me një koncept ose ide, ose lidhur me njerëzit e tjerë. Ky raport ndryshe njihet edhe si “reflektim me shkrim”. Për shembull, kërkoni nga nxënësit t’ju tregojnë “Pse e pëlqejnë ose nuk e pëlqejnë një lëndë, aktivitet apo person”.

Shkalla e rangimit – paraqet një sërë kategorish të përgatitura për të nxjerrë informata mbi një veti kuantitative në shkencat sociale. Shembujt e zakonshëm janë Shkalla e Likertit me kategoritë Pajtohem plotësisht, Pajtohem, i/e Pavendosur, Nuk pajtohem, Nuk pajtohem aspak dhe shkalla e Rangimit 1-10, ku një person zgjedh numrin i cili e pasqyron më së miri perceptimin e tij. Karakteristika themelore e cilësdo shkallë rangimi është se ajo përbëhet nga një numër kategorish me shkallën e rangimit.

Tabela në vijim ofron shembuj se si mund të filloni të mendoni rreth vlerësimit të qëndrimeve të nxënësve ndaj të nxënësve. Përdorni këtë tabelë për t’u ndihmuar të diskutoni me nxënësit.

Qëndrimi ndaj të mësuarit në shkencat e natyrës	Kategoria e qëndrimit
Unë dua ta mësoj hulumtimin shkencor.	Negativ / Indiferent / Pozitiv
Unë dua të mësoj të bëj eksperimente në laborator.	Negativ / Indiferent / Pozitiv
Dua të studioj në universitet në shkencat natyrore.	Negativ / Indiferent / Pozitiv
Dua të jetoj në një vend ku studimi për shkencat natyrore është prioritet i shoqërisë.	Negativ / Indiferent / Pozitiv

⁴ Kjo pjesë i referohet udhëzuesit për mësimitdhënësit - për përmirësimin e praktikave në klasë.

Vlerësimi për të nxënë

Vlerësimi për të nxënë tashmë është pjesë e udhëzuesve për përmirësimin e praktikave në klasë, është pjesë e programeve për aftësimin e mësimitdhënësve në shërbim. Ne nuk do të ndalimi në aspektet teorike, por vetëm po sjellim disa thekse të vlerësimit për të nxënë, për të siguruar se vlerësimi për të nxënë është kuptuar në esencë dhe për të lehtësuar aktivitetet praktike me mësimitdhënës gjatë trajnimit ose zhvillimit profesional në këtë fushë.

Vlerësimi për të nxënë është instrumenti më i fuqishëm i vlerësimit, i cili gjeneron mësim. Ai *“...i jep mundësi nxënësit të bëhet nxënës pa frikën se do të dështojë. Krijohet një mjedis mësimor dhe ofrohen mundësi për nxënësit t’i praktikojnë shkathtësitë dhe të marrin komente specifike dhe përshkruese që u ndihmojnë ta përmirësojnë të mësuarit..”*⁵

Komentet kthyesë të mësimitdhënësit për nxënësin/it karshi të nxënit janë karakteristikë e veçantë e vlerësimit për të nxënë. *Hattie dhe Timperley e kanë propozuar një model të komenteve kthyesë që shkon në katër nivele: komente për detyrën (p.sh. komente kthyesë nëse përgjigjet ishin të sakta apo të gabuara, ose orientim për të marrë më shumë informacione), komente për procesin e detyrës (p.sh. komente kthyesë lidhur me strategjitë e përdorura apo për strategjitë që mund të përdoren), komente për vetërregullim (p.sh. komente lidhur me vetë-vlerësimin apo vetëbesimin e nxënësit) dhe komente për nxënësin si person (p.sh. deklarime se nxënësi është ‘i mirë’ ose ‘i mençur’). Analiza e tyre vë në pah se niveli në të cilin është përqendruar komenti kthyesë ndikon në efektivitetin e tij. Komentet kthyesë për cilësinë e detyrës dhe komentet për procesin ose strategjitë e përdorura për kryerjen e detyrës janë më të dobishmet. Komentet që e tërheqin vëmendjen e nxënësve për strategjitë vetërregulluese apo aftësitë e tyre si nxënës mund të jenë efektive nëse nxënësit e kuptojnë se do t’i rrisin rezultatet në qoftë se dëshirojnë t’i shtojnë përpjekjet dhe t’i kushtojnë më shumë vëmendje. Komentet personale (‘Vajzë e mirë!’) nuk e tërheqin vëmendjen e nxënësit për të nxënit e tyre.*⁶

Pra, ofrimi i komenteve kthyesë nuk ka të bëjë me dhënien e lëvdatave, por ka të bëjë me

Aktivitetet - hapat:

1. Lexoni në mënyrë individuale tregimin në vijim;
2. Diskutoni me kolegë mësimet e marra nga ky tregim;
3. Diskutoni me kolegë shembuj praktikë nga përvoja juaj me nxënës, të ngjashëm ose të përparë me tregimin;
4. Përzgjidhni një përvojë të diskutuar në detaje dhe përshkruani rastin/shembullin në formë të tregimit – në pika kyçe;
5. Prezantoni shembullin para kolegëve të tjerë.

⁵ Sherry Bennett and Dale Armstrong; *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13) f. 265

⁶ David Lynn, Osman Buleshkaj dhe Selim Mehmeti (2012): *Mësimitdhënia dhe të nxënit*. EU-GIZ, Prishtinë. Cituar sipas Susan M. Brookhart; *“Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment”* f. 232

Një tregim i vërtetë! Pas dymbëdhjetë vjet shkolle dhe gjashtë vjet në universitet, unë nuk mbaj mend ndonjë gjë që kam mësuar në lidhje me përgatitjet për provimin përfundimtar (vlerësimin përmbledhës). Por, e mbaj mend, sikur të ishte tani, përvojën time të parë me vlerësimin për të nxënë. Ma ofroi babai (i cili nuk ishte mësues).

Familja ime po përgatitej për pushimin e parë që e kishte bërë ndonjëherë larg shtëpisë. I kisha dhjetë (10) vjet. E kishim një automobil të vogël, i cili nuk i zinte të gjitha valixhet. Kështu që babai vendosi ta ndërtonim një arkë të hapur për valixhe dhe ta vendosnim në mbajtëset e sipërme të automobilit. Më pyeti nëse më pëlqente ta dizajnoja dhe mi dha specifikat:

- 1. I kishim dy dërrasa të cilat ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 30 centimetra të gjera. Këto dy dërrasa do të bëheshin pjesët anësore të arkës.*
- 2. Pjesa e poshtme e arkës duhej të ishte me dërrasa më të holla me hapësirë ndërmjet veti që do të mundësonin kullimin e shiut nga arka në kulmin e automobilit në rast se na zinte shiu rrugës.*
- 3. Dërrasat e holla do të formonin bazën e arkës, dhe se arka do të montohej me anë të lidhëseve dado. Duhej t'i bënim 8 dërrasa të shkurtra prej 3 copave të dërrasave që ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 10 centimetra të gjera.*

Kështu që i fillova t'i bëja llogaritjet dhe ta dizajnoja; “do të ishte një punë e lehtë, kështu mendoja”. Pasi ia fillova të punojë e pash se nevojitej më shumë sesa kisha menduar. Babai nuk më tha asnjëherë “Këtë e ke gabim”. Ai do të më parashtronte pyetje si, “nëse do ta bësh arkën kaq të gjerë a do të përshtatej me hapësirën e mbajtëseve? “Nëse do t'i bësh dërrasat më të holla aq të gjata, a do të na mjaftojnë dërrasat? A më bënte vazhdimisht pyetje të cilat më bënin të mendohem ‘brenda kontekstit’. Me fjalë të tjera, ai i referohej gjithnjë kriterëve që i kishim vendosur, si të ishin objektivat mësimore në një orë mësimi. Brenda një dite e kisha dizajnuar arkën. Dizajni funksionoi dhe e ndërtuam së bashku arkën. Isha shumë krenar dhe i gëzuar se “e kisha bërë atë”. Gjatë gjithë kohës po mësoja nën udhëzimet e babait.

Reflektim lidhur me tregimin

Ajo që kishte bërë prindi me fëmijën e vet ishte përdorimi klasik i vlerësimin për të nxënë, por është një shembull që mësimdhënësit mund ta marrin dhe ta përshtatin për nxënësit e tyre në situata të mësimin, kur synojnë të praktikojnë vlerësimin për të nxënë. Sepse:

- Prindi gjatë gjithë kohës e inkurajonte fëmijën dhe i ofronte komente dhe sugjerime, të cilat nuk gjykonin, kishin fokus të qartë dhe ishin përshkruese;
- E angazhoi në procesin e dizajnit;
- E ndihmoi t'i gjejë gabimet dhe kufizimet dhe sigurohej që fëmija e dinte se cili ishte hapi tjetër;
- Ndërsa, fëmija i merrte veprimet për t'i korrigjuar gabimet dhe e zotëronte procesin e vet të mësimin.

Inkurajohen mësuesit që të bëjnë të njëjtën gjë me nxënësit e tyre në detyra dhe aktivitete mësimore.

Dimensionet e performancës së nxënësve për raportim

Përshkrimi i niveleve të performancës është i dobishëm sepse ato përqendrohen në përshkrimin të asaj se si nxënësit i kanë arritur standardet sipas dimensioneve: komunikimit, zgjidhjes së problemeve, shfrytëzimit të TIK-ut (*shtrirja, shpeshësia, ndihma/fascilitimi, thellësia, kreativiteti dhe cilësia* e njohurive, aftësive dhe shkathtësive që ata i kanë fituar). Ky lloj formati ndihmon përcjelljen progresive të RNSH (kompetencave). Shih përmbajtjen e secilit dimension.

Komunikimi: I referohet komunikimit të dijes dhe aftësive të fituara brenda fushës së kurrikulës tek të tjerët, përfshirë këtu nxënësit dhe mësuesit.

Zgjidhja e problemeve: I referohet zgjidhjes së problemeve rutinore dhe të reja, të thjeshta dhe komplekse brenda fushës së kurrikulës.

Përdorimi i TIK-ut: I referohet përdorimit të kompjuterëve dhe teknologjisë tjetër informative brenda fushës së kurrikulës.

Shtrirja: I referohet shtrirjes së të kuptuarit të rezultateve të të nxënësve të kurrikulës që janë zotëruar, dhe cili është niveli i arritjes së rezultateve të të nxënësve për shkallë /fushë.

Shpeshësia: I referohet sa shpesh nxënësi demonstroi mjeshtëri gjatë procesit mësimor dhe sa shpesh nxënësi është në gjendje të demonstrojë zotërimin e një kompetence.

Ndihma/Fascilitimi: I referohet nivelit të njohurive, aftësi, shkathtësive dhe qëndrimeve apo dhuntive që posedon dhe tregon një nxënësi. Nxënësi është i qartë për atë që e thotë apo e demonstroi duke arsyetuar, andaj klasifikohet si një person që të tjerët mund të mësojnë nga ai apo ai u ndihmon të tjerëve.

Thellësia: I referohet thellësisë që nxënësi i ka përmbushur rezultatet e të nxënësve përmes niveleve të dijes.

Kreativiteti: I referohet aftësisë së nxënësve për të shkruar përtej asaj që është mësuar. Në termin “produkt” është aftësia për të krijuar diçka të re, përmes frymëzimit, imagjinatës, vizionit, inspirimit dhe zgjidhjes së problemit në situata të reja.

Cilësia: U referohet njohurive dhe aftësive për të parë të mësuarit e nxënësve dhe përfshin identifikimin dhe tiparet kryesore të të mësuarit të nxënësve dhe se mësimi klasifikohet sipas shkallëve të persosshmërisë dhe vlerave.

Tabela e mëposhtme tregon disa nga termat që mund të përdoren në një sistem të performancës në nivel të klasifikuar të mësuarit të nxënësve në përputhje me secilin nga dimensionet.

DIMENSIONI	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
Komunikimi	pasiv	me vështirësi	sipërfaqësisht	me lehtësi	rrjedhshëm
Zgjidhja e problemeve	asnjë element	të thjeshta	të zakonshme	mesatar	komplekse
Shfrytëzimi i TIK-ut	asnjë element	fillestar	i mirë	shumë mirë	i avancuar
Shtrirja	aspak	pak	pjesërisht	plotësisht	zgjeruar
Shpeshtësia	asnjëherë	rrallë	nganjëherë	zakonisht	përherë
Fasilitimi	asnjë element	ngadalë	në mëdyshje	shpejt	automatikisht
Thellësia	asnjë element	sipërfaqësisht	cekët	adekuate	thellësisht
Kreativiteti	pasiv	imitues	i zakonshëm	imagjinues	krijues
Cilësia	dobët	mjaftueshëm	mirë	sh. mirë	shkëlqyeshëm

Aspektet praktike të disa strategjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit

Me rastin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve mund të përdorim strategji, teknika dhe instrumente të ndryshme, varësisht se çfarë dëshirojmë të matim. Shih disa shembuj në vazhdim.

Për të vlerësuar bashkëpunimin dhe realizueshmërinë e kryerjes së detyrës, si dhe punën në grupe mund të përdorim **Buletini i pjesëmarrjes** si teknikë për vlerësim.



Për të vlerësuar nxënësin në formë të vazhdueshme, ku matim njohuritë, qëndrimet, vlerat..., mund të përdorim **Listën e kontrollit**, e cila shërben për të regjistruat përparimin e nxënësve në vazhdimësi.

Pastaj, angazhimi në krijimin e filmave, ku nxënësit shprehin talentin e tyre në shkrimin e skenarit, bashkimin e videove. Përmes këtij aktiviteti nxënësit zhvillojnë shkathtësi teknike dhe aftësi për planifikime të veprimeve praktike duke u bërë kontribuues dhe bashkëpunues për mjedisin. Atëherë ne i matim shkathtësitë në fjalë.

Broshura është një strategji, e cila ndihmon të matim rezultatet e të nxënësve. Gjatë krijimit të broshurës nxënësi fiton njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që ndihmojnë në përmbushjen e kompetencave, me çka mund të matet vlerësimi sasior dhe cilësor.



Njëra ndër strategjitë për vlerësim/ vetëvlerësim është edhe **Rubrika** e krijuar nga nxënësit që do të shërbejë për matjen e nivelit të njohurive të nxënësve. Kjo strategji e vlerësim bazohet kryesisht në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore (plani i orës mësimore). Aktivitetet duhet t'u përshtaten këtyre rezultateve.

Detyra	E gjelbër	E verdhë	E kuqe
Shkruani platformën e projektit hulumtues.	Kam shkruar gjithë platformën e projektit hulumtues.	Kam shkruar vetëm një pjesë të platformës së projektit hulumtues.	Kam shkruar shumë pak për platformën e projektit hulumtues.
Vizato një skemë për menaxhimin e projektit.	Kam vizatuar skemën që i përshtatet shumë të projektit.	Kam vizatuar një skemë që i përshtatet deri diku menaxhimin të projektit.	Kam paraqitur vetëm një skemë të thjeshtë.
Emërto fazat e zhvillimit të një hulumtimi në laborator.	I emërtova të gjitha fazat e zhvillimit të një hulumtimi në laborator.	I emërtova vetëm dy fazat e para të zhvillimit të një hulumtimi në laborator.	S'mund t'i emëroj fazat e zhvillimit të një hulumtimi në laborator.

Përcjellja e zhvillimit të kompetencave arrihet kur kemi më shumë të dhëna të akumuluar për të nxënësit e fëmijëve. Mjeti më i përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave për vlerësim është dosja.

Dosja (portfolio)

Është një koleksion i qëllimshëm i punimeve të nxënësve, që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në fushë mësimore të caktuar. Këtu përfshihet pjesëmarrja e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriteret e vlerësimit për të dëshmuar për meritat dhe dëshmitë e vetë-reflektimit të nxënësit'. (Arter&Spandel,1992) (32).



Ky lloj i vlerësimit është vlerësim për të nxënë (vetëvlerësim, informatë kthyesë, vlerësim i ndërsjellët), pasi që për një kohë të gjatë vazhdimisht mblidhen informata për zhvillimin e nxënësit.

Dosja mund të përdoret edhe për vlerësim përmbljedhës.

Është me rëndësi që të vendosni për qëllimet e dosjes, të caktoni rezultatet e pritura dhe si mund të shfrytëzohet dosja për t'i përmbushur ato rezultate.

Nota përfundimtare e vlerësimit të nxënësve duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e dhëna në KB për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, në përputhje me standardet e vlerësimit dhe kodin etik të vlerësimit.

Mënyra e vlerësimit për arritjet dhe suksesin e nxënësit

- Vlerësimi me test dhe me gojë -50% e notës përfundimtare (gjatë gjysëmvetorit të parë planifikohen dy teste, ndërsa në gjysëmvetorin e dytë tre teste. Vlerësimi me gojë do të jetë gjatë gjithë kohës ku do të përfshihet edhe angazhimi dhe pyetjet gjatë orës mësimore).
- Puna laboratorike- 15% e notës përfundimtare (këtu do të përfshihen puna gjatë eksperimenteve, përgatitja për orë laboratorike, si dhe respektimi i rregullave në laborator).
- Detyrat e shtëpisë- 15% e notës përfundimtare (detyrat do të jenë kryesisht nga fletorja e punës dhe nga yteach, por edhe ndonjë detyrë tjetër e cila do të jepet shtesë. Nëse nxënësi nuk kryen detyrat tre here gjatë një gjysëmvetori do të ndëshkohen me note të dobët në ditar).

Puna me projekte-20% e notës përfundimtare (projektet individuale do të vlerësohen varësisht nga materiali i projektit, mënyra e prezantimit dhe numri i projekteve gjatë gjysëmvetorit dhe kjo përqindje mund të shkojë deri në 20% e notës përfundimtare, e cila do të zbatohet nga vlerësimi me test dhe me gojë).

4.4 Bashkëpunimi i mësimeve si domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re

Çelësi i suksesit të nxënësve qëndron në bashkëpunimin kolegjial të mësimeve. Kjo do të thotë që në mes të mësimeve nuk duhet të ketë rivalitet negativ, sepse të gjithë synojnë zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve; nuk duhet të ketë hezitim ndaj njëri-tjetrit, sepse të gjithë janë përgatitur për përkrahje të nxënësve; nuk duhet të hezitohet të kërkohet ndihmë nga njëri-tjetri për të ngritur profesionalizmin dhe performancën, sepse kjo bëhet për të mirën e nxënësve. Mos harro! **Transparenca eliminon çdo vështirësi!**

Zbatimi i filozofisë së KKK-së domosdoshmërisht kërkon bashkëpunimin në mes të mësimeve. Bashkëpunim duhet të bëhet në nivel këshillit të klasës-klasave, por edhe të aktiveve profesionale.



Mësimeve të klasës së njëjtë, por të paralele të ndryshme, duhet bashkëpunojnë në mes vete, por edhe me mësimeve të niveleve të tjera dhe të fushave të ndryshme kurrikulare. Ky bashkëpunim duhet të reflektohet në planifikime mësimore, që do të thotë se mësimeve të klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet bashkërisht të hartojnë planifikimet për shkallë dhe planifikimet vjetore për të vazhduar më pas në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në hartimin e planifikimeve dymujore, të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga mësimeve të paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mësimeve të duhet të ndihmojnë njëri-a tjetrin-ën në edhe planifikimet javore edhe pse ata-ato janë përgjegjëse vetëm për një paralele.

Bashkëpunimi i mësimeve duhet të reflektohet edhe në shkëmbimin e përvojave të metodologjisë së mësimdhënies, të vlerësimit, në krijimin dhe shkëmbimin e materialeve mësimore.

Mësimeve mund të marrin iniciativa për ngritje profesionale brenda shkollës, duke mbajtur vetë punëtorë për çështje të ndryshme që janë në funksion të mësimdhënies.

Mësimdhënësit bashkërisht mund t'i përgatisin nxënësit edhe për gara të ndryshme, për kuize diturie, gara sportive, ekspozita dhe aktivitete të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe në arritjen e kompetencave të caktuar.

Gjithashtu, suksesin e zbatimit të KKK e forcon edhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e shkollave të tjera, duke shkëmbyer përvoja, literaturë, linçe interneti, informata e njohurive të marra nga trajnimet e ndryshme.

Zbatimi me sukses i filozofisë së KK të ri, i bazuar në kompetenca dhe në RNSH + RNF, është tejet i vështirë pa integrimin e dijeve, shkathtësive dhe mjeteve të përbashkëta ndër mësimdhënës në shkollë. Procesi i fotosintezës nuk do të kuptohet nga nxënësit nëse për të nuk bashkohen dijet nga biologjia, kimia, fizike, komunikimi matematikor nuk mund të zhvillohet/kultivohet pa njohur mirë shkrim-leximin dhe përdorimin e TI-së etj. Kjo shton domosdonë e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve të fushave të ndryshme brenda një shkolle.

Burimet dhe literatura

1. Gashi, Shqipe & Qarkaxhia, Diana, (2013): Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Programi parafillor dhe fillor), (në dorëshkrim), Prishtinë.
2. Gosling, D. & Moon, J. (2002) How to use Learning Outcomes 6 Assessment Criteria - Learning Development Unit, London Metropolitan University. UK.
3. Grup autoresh. (2013). Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 të Lëndës së Matematikës, Basic Education Program, Prishtinë.
4. Jim Brandon and M. Quarin-Wright; *Leading Student Assessment* (Chapter 4)
5. MASHT & Kultur kontakt Austria. (2011). Udhëzues për punimin e materialeve mësimore, Prishtinë.
6. MASHT & SWAP. (2012). Udhëzuesit për zbatim të KKK, Prishtinë.
7. MASHT. (2011). Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë.
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & GIZ IS (2012): Moduli 5 për Aftësimin e Mësimdhënësve në Shërbim: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, Prishtinë.
9. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë.
10. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & SËAP (2012): *Udhëzues për mësimdhënës për përmirësimin e praktikave në klasë, Prishtinë.*
11. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2012). Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, Prishtinë.
12. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2012). Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët, Prishtinë.
13. Salihu, Arbër & Gashi, Bislim, (2013): Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës – Shoqëria dhe Mjedis, (në dorëshkrim), Prishtinë.
14. Sherry Bennett and Dale Armstrong; Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices (Chapter 13).
15. St Josep Primary School, august, september 2013, Dalily Planner (Mrs Dastey), Glasgoë, Scotland.
16. Susan M. Brookhart; *“Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment”* (Chapt. 10)
17. Webber, Richard (2010): Kurrikulumit dhe vlerësimi i bazuar në Kompetenca, Prishtinë.
18. Zabeli, dr. Naser (2011). *Teoria e mësimit – ligjërata në dorëshkrim.*
19. Zeneli, Isuf (2003). *Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim,* Libri shkollor, Prishtinë.

SHTOJCA

Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kriterëve të vlerësimit

Gjetja e fjalëve të duhura për hartimin e rezultateve të të nxënit/kriterëve të vlerësimit mund të jetë e vështirë, veçanërisht kur fjalitë duhet të përputhen me nivelin e përgjithshëm të përshkrimit. Lista në vijim mund të përdoret për të ju ndihmuar në këtë proces. Fjalët janë të organizuara në nëntituj që korrespondojnë me astronominë e Bloom-it. Megjithatë, kjo renditje nuk paraqet kurrfarë hierarkie. Fjalët përbëjnë thjeshtë një listë të vokabularit të vjelur nga burime të ndryshme për të ju ndihmuar në hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kriterëve të vlerësimit.

Foljet që kërkojnë fakte për njohuritë: Defino, përshkruaj, identifikoj, emëro, listoj, riprodho, përsërit, përzgjedh, deklaro, prezanto, jini i vetëdijshëm, nxjerr, organizo, rinumëro, shkruaj, prano, mat, nënvizoj, ndërlidh, bashko.

Foljet që kërkojnë fakte për të kuptuarit: Interpretoj, përkthe, llogarit, arsyeto, shpreh, konvertoj, qartëso, mbro, dallo, shpjego, zgjero, gjeneralizoj, ilustruj, ofroj shembuj, parafrazoj, parashikoj, rishkruaj, përmbledh, diskuto, përformoj, raportoj, prezanto, identifikoj, tregoj, gjej, përzgjedh, kuptoj, përfaqëso, emëro, formulo, gjyko, krahasoj, klasifikoj, shpreh.

Foljet që kërkojnë fakte për të njohuri/kuptuarit: Apliko, zgjidh, ndërtoj, demonstroj, ndryshoj, llogarit, zbulo, manipuloj, modifikoj, operoj, parashikoj, përgatit, prodhoj, ndërlidh, tregoj, përdor, jep shembuj, hartoj, përzgjedh, shpjego, gjej, vlerëso, ushtrij, ilustruj, verifikoj.

Foljet që kërkojnë fakte për analizë: Prano, dallo, vlerëso, analizoj, zbërthe, diferencoj, identifikoj, ilustruj, përshkruaj, përmend, ndërlidh, përzgjedh, ndaj, nëndaj, krahasoj, justifikoj, zgjidh, egzaminoj, përmbledh, kritikoj, kontestoj, diagnostifikoj, identifikoj, kategorizoj, shpjego.

Foljet që kërkojnë fakte për sintezë: Propozoj, prezanto, ndërtoj, integroj, formulo, mëso, zhvilloj, kombinoj, kompozoj, krijoj, ndajë, dizajnoj, shpjego, gjeneroj, modifikoj, organizoj, planifikoj, riaranzhoj, rindertoj, ndërlidh, riorganizoj, rishikoj, shkruaj, përmbledh, tregoj, raportoj, ndryshoj, argumentoj, rendit, përzgjedh, menaxhoj, gjeneralizoj, nxjerr, përfundoj, shkaktoj, sintetizoj, sugjeroj, zgjeroj.

Foljet që kërkojnë evidencë për vlerësim: Gjyko, vlerëso, përmbledh, krahasoj, përshkruaj si, kritikoj, shpërndaj, arsyetoj, mbro, gradoj, përcaktoj, zgjedh, çmoj, kontestoj.

Gosling, D. & Moon, J. (2002) How to use Learning Outcomes 6 Assessment Criteria - Learning Development Unit, London Metropolitan University. UK.

Shtojca 2: Modele të planifikimeve të përgatitura nga mësuesit

Shembull i planifikimit dymujor

Tema mësimore: *Hulumtimi në shkencat natyrore*

Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:

I.- Komunikues efektiv

I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II- Mendimtar kreativ (kritik)

II. 4. Zgjidh një problem shkencor të dhënë në formë eksperimentale apo tekstuale numerike dhe e arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III – Nxënës i suksesshëm

III.7 Parashtron pyetje vetes(pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur.

IV – Kontribuues produktiv

IV. 4 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p. sh. Pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën, etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V – Individ i shëndoshë

V.7. Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.

VI – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë, etj. dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që t'i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:

-Planifikon dhe kryen hulumtime të thjeshta shkencore, individualisht ose në grup, brenda dhe jashtë klasës, duke mbledhur, duke analizuar dhe duke interpretuar të dhënat me qëllim të shpjegimit të proceseve dhe dukurive natyrore.

Korrelacioni me fushat kurrikulare dhe çështjet ndërlëndore:

- Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Gjuhë dhe komunikim, Shëndeti dhe mirëqenia
- TIK dhe mësimi elektronik , Ndërgjegjësimi për karrierën, Të drejtat e NJ/F.

Lëndët	Njësitë mësimore	Rezultatet e të nxënimit të lëndës	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
Biologji	<p>1. Metodologjitë hulumtuese (vrotim, matje, eksperiment)</p> <p>2. Veglëria hulumtuese dhe përdorimi i tyre. (veglëria laboratorike, e terrenit, etj)</p> <p>3. Hulumtim në veprim</p>	<p>Nxënësi/ja: - të sintetizojnë mendimin shkencor të ndikimit të natyrës në jetën e njeriut dhe roli i vetë njeriut</p> <p>-Fut në përdorim shumë procese mendore si vëzhgimin, kërkimin, përfytyrimin, komunikimin, etj.;</p> <p>Nxënësi/ja: -Njeh veglat, instrumentet laboratorike dhe praktikon eksperimente.</p>	8 orë	<p>Mësimdhënie e drejtpërdrejtë</p> <p>Mësimdhënie përmes pyetjeve</p> <p>Të mësuarit përmes projektit</p>	<p>Vlerësim për nxënie (VpN)</p> <p>Vlerësim diagnostikues</p>	<p>1. Biologjia 8- Libri shkollor Prishtinë , 2000, autor Dr. Fahri Zeqiri</p> <p>2. Biologjia kl.V, Libri shkollor 2004- Prishtinë, autor Dr.M.M urati dhe E.Saraçini</p>

Shembull i planifikimit të orës mësimore - korrelacion me planin dymujor

Përgatitje për orë mësimore

Fusha: Shkencat natyrore - Shkalla 3 kl - VI Datë _____

(zhvillim i mëtejshëm dhe orientim)

Tema: **Hulumtimi në shkencat natyrore**

Njësia mësimore: Vrojtimi si metodë hulumtuese në shkencat natyrore

Qëllimi i të nxënit:

Aftësimi i nxënësve për hulumtim shkencor përmes vrojtimit.

Konteksti:

Përmes punës me projekte, nxënësit të aftësohen për hulumtim shkencor me metodën e vrojtimit.

Rezultati i të nxënit:

Kryen hulumtime të thjeshta shkencore, në grup, jashtë klasës, duke mbledhur, duke analizuar dhe duke interpretuar të dhënat me qëllim të shpjegimit të përbërësve mjedisorë si dhe interaksionet.

Kriteret e të nxënit:

1. Identifikimi i së paku tre përbërësve të mjedisit vrojtues/hulumtues;
2. Identifikimi i ndikimit reciprok, së paku të dy përbërësve të mjedisit vrojtues;
3. Përpunim të së paku një rezultati hulumtues;
4. Interpretim të rezultatit/ve në mënyrë të përzgjedhur nga vetë nxënësi/it (raportim gojor, me shkrim, diagram, matematikor etj.).

Rezultatet e kompetencave:

I.6 ; II.4; III.7; IV.4; V.7; VI.

Materiali i punës:

Fletorja, lapsi, fotoaparati, metri, kalkulatori.

VpN	<u>Ecuria e punës:</u> Paraprakisht nxënësit kanë qene të informuar për projektin dhe nxënësit vijnë të përgatitur me materialin punues.	Komp. KKK
Strategjia e pyetjeve të hapura	<p style="text-align: center;">Evokim (10 min)</p> <p>Fillimisht informohen nxënësit për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësine mësimore - Qëllimin e të nxënësve - Kontekstin e punës <p>Për vlerësim të paranojohurve të nxënësve parashtroi pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ju sot do të bëni një hulumtim shkencor. Cilën metodë hulumtuese dëshironi ta përdorni? - Ku do të realizoni hulumtimin? - Në çfarë forme të punës do të punoni? (orientohen nx. për punë grupore)? - Kur do t'i prezantoni të gjeturat nga hulumtimi? <ul style="list-style-type: none"> • Pranojnë përgjigjet e nx. dhe shënon mësimdhënësi në fletoren e tij. • Nxjerrën kriteret e të nxënësve, së bashku me nxënësit dhe mbajnë në shënime edhe nxënësit edhe mësimdhënësit. • Lejon formimin e grupeve nga vetë nxënësit. • Verifikon grupet e nx. për materialin e nevojshëm për hulumtim. • Dhe tani janë nxënësit e gatshëm për hulumtim dhe mësimdhënësi i orienton në pikat/vendet hulumtuese (në oborrin e shkollës). <p>Shkathtësitë - Prezantimi, të nxënësve, planifikimi etj.</p>	<p>Komunikues efektiv</p> <p>Nxënës i suksesshëm</p> <p>Mendimtar kritik</p>
Strategjia e informative kthyes	<p style="text-align: center;">Realizim (35 minuta)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit janë në hulumtim/vrojtim, duke shënuar çdo element natyror që i rrethon në mjedisin hulumtues. • Nxënësit diskutojnë dhe shqyrtojnë faktet. • Nxënësit kohë pas kohe përkrahen nga mësimdhënësi, i cili është në vizitë alternative gjatë gjithë kohës. 	<p>Mendimtar kritik</p> <p>Nxënës i suksesshëm</p>
Strategjia e vlerësimit të ndërsjellët me teknikën "Kontrolli para fluturimit"	<ul style="list-style-type: none"> • Grupet e vogla të nxënësve shkëmbejnë punimet (fletoret) mes tyre , dhe komentojnë punën e njëri-tjetrit. 	<p>Individ produktiv</p>
Strategjia e vetëvlerësimit	<p>Nxënësit ndërpresin punën për të vazhduar me përpunim të rezultateve, si detyrë shtëpie</p> <p>Shkathtësitë – Emocionale, kreativitet</p>	<p>Individ produktiv</p>
Strategjia e informatave	<p style="text-align: center;">Reflektim (45 minuta)</p> <p>Ftohen nxënësit që të lexojnë punimet e tyre (disa) dhe të japin komentet vetëvlerësuese.</p> <p>Mësimdhënësi i fton nxënësit të kthehen në grup të madh (e gjithë klasa) ku bëjnë një reflektim të shkurtër mbi punën e tyre (udhëheqësi i grupit), duke u pajtuar për kohën e prezantimit të rezultateve të përpunuara (5minuta).</p>	<p>Komunikues efektiv</p> <p>Individ i shëndoshë</p>

kthyese		Qytetar i përgjegjshëm
	Shkathtësitë – prezantimi, të dëgjuarit aktiv, menaxhim i konfliktit, menaxhim i kohës.	
Dosja për VpN	Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që punimet t'i mbajnë në dosjet e tyre.	Nxënës i suksesshëm
	Shkathtësitë - marrja/gjetja/sigurimi i informacioneve	
<p>Mësimdhënësi jep të drejtën e parashtrimit të pyetjeve eventuale nga nxënësit; (Pyetjet që mbesin pa përgjigje hulumtohen në ardhshme); Mësimdhënësi falënderon nxënësit dhe përfundon orën mësimore (dy orë mësimore).</p>		

Përgatitje për orë mësimore

Fusha: Shkencat natyrore -

Shkalla 1 kl - I

Datë _____

Tema: **Hulumtimi në shkencat natyrore**

Njësia mësimore: Krahasimi i objekteve sipas madhësisë, formës dhe ngjyrës.

Qëllimi i të nxënit:

Aftësimi i nxënësve për hulumtim shkencor përmes krahasimit.

Konteksti:

Duke e shfrytëzuar klasën dhe ofrim të materialit konkret me objekte të ndryshme, nxënësit të aftësohen për hulumtim shkencor rreth krahasimit.

Rezultati i të nxënit:

-Planifikon dhe kryen hulumtime të thjeshta shkencore, individualisht, brenda dhe jashtë klasës, duke mbledhur, analizuar dhe interpretuar të dhënat me qëllim të shpjegimit të proceseve dhe dukurive natyrore.

Kriteret e të nxënit:

5. Identifikimi i së paku katër objekteve sipas madhësisë;
6. Gjetja e së paku pesë objekteve me ngjyrë të ndryshme;
7. Të krahasojnë së paku 5 objekte, sipas madhësisë, formës dhe ngjyrës;
8. Vizatim/modelim i së paku tri objekteve sipas madhësisë, ngjyrës apo formës;
9. Interpretim verbal të rezultateve të punuara (vizatim apo modelim).

Rezultatet e kompetencave:

I.7, II.1, II.4

Materiali i punës:

Fotografi të ofruara nga mësimdhënësi, fleta-A4, lapsi, goma, ngjyra, plastelina.

VpN	<u>Ecuria e punës:</u> Paraprakisht është përgatitur materiali, i cili u shpërndahet nxënësve nëpër faza të zhvillimit të orës mësimore.	Komp. KKK
Strategjia e pyetjeve të hapura	<p style="text-align: center;">Evokim (10 minuta)</p> <p>Për vlerësim të paranjohurve të nxënësve parashtroni pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kush po m’i tregon objektet që i kemi në klasë? - Çfarë objekte kemi jashtë klasës? - A mendoni se objektet që i shohim janë të njëjta? - A janë të gjitha objektet e me ngjyrë të njëjtë? <p>Pranohen përgjigjet e 4-5 së nxënësve, dhe njoftojmë nx. për njësinë e re mësimore; Shënohet qëllimi i të nxënit; Shënohet konteksti i të nxënit; Nxirren kriteret e të nxënit, pasi që mosha është shumë e vogël, pyesim nx. në formë loje, japin mendimet e tyre dhe hartohen kriteret.</p>	<p>Komunikues efektiv</p> <p>Nxënës i suksesshëm</p> <p>Mendimtar kritik</p>
Strategjia e informative kthjese	<p style="text-align: center;">Realizim (25 minuta)</p> <p>Ftohen nxënësit që në mënyrë individuale të analizojnë ato figura të ofruara nga mësimdhënësi, i ngjyrosin rrathët poshtë figurave, sipas kërkesave që janë të punuara me ngjyra, sipas madhësisë me një ngjyrë, sipas formës me një ngjyrë dhe sipas ngjyrave me një ngjyrë. Mësimdhënësi përcjellë, viziton nxënësit individualisht dhe u jep informata kthjese gojore, individualisht apo gjithë grupit (sipas nevojës).</p>	<p>Mendimtar kritik</p> <p>Nxënës i suksesshëm</p>
Strategjia e vlerësimit të ndërsjellët me teknikën “Kontrolli para fluturimit”	<p>Nxënësit shkëmbejnë punimet (fletat që kanë punuar) mes dysheve dhe komentojnë gojarisht punën e njëri-tjetrit.</p> <p style="text-align: center;">Shkathtësitë- ketonjigjive, analitike, gjurmim, sigurim informacioneve, kreativitet.</p>	<p>Individ produktiv</p> <p>Qytetar i përgjegjshëm</p>
Strategjia e vetëvlerësimit	<p>Nxënësve u ofrohet materiali i përgatitur nga mësimdhënësi, detyrë e nxënësve është që ta vlerësojnë veten duke i plotësuar “Rubrikat e vetëvlerësimit” (duke i ngjyrosur rubrikat).</p> <p style="text-align: center;">Shkathtësitë – emocionale, kreativitet</p>	<p>Individ i shëndoshë</p> <p>Individ produktiv</p>
Strategjia e informatave	Reflektim (10 minuta)	<p>Komunikues efektiv</p>




kthyesë	Ftohen nxënësit që të shpjegojnë gojarisht punimet e tyre (disa), dhe të japin komentet vetëvlerësuese. Mësimdhënësi kthen informacionin në mënyrë gojore apo edhe me ndonjë gjest, (5min).	Individ i shëndoshë
	Shkathtësitë – prezantimi, të dëgjuarit aktiv, menaxhim i konfliktit, menaxhim i kohës.	Qytetar i përgjegjshëm
Dosja për VpN	Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që punimet t'i mbajnë në dosjet e tyre.	Nxënës i suksesshëm
	Shkathtësitë- marrja/gjetja/sigurimi i informacioneve	
<p>Mësimdhënësi jep të drejtën e parashtrimit të pyetjeve eventuale nga nxënësit. (Pyetjet që mbesin pa përgjigje mund të merren orën e ardhshme). Detyrë shtëpie nuk ka. Mësimdhënësi falënderon nxënësit dhe përfundon orën mësimore.</p>		

Arsimtarja: N.Q - SHFMU „A. F,, - Prizren

Kriteret e të nxënit:

1. Identifikimi i së paku katër objekteve sipas madhësisë;
2. Gjetja e së paku pesë objekteve me ngjyrë të ndryshme;
3. Të krahasojnë së paku 5 objekte, sipas madhësisë, formës dhe ngjyrës;
4. Vizatim/modelim i së paku tri objekteve sipas madhësisë, ngjyrës apo formës;
5. Interpretim verbal të rezultateve të punuara(vizatim apo modelim).

Detyra 1. Vetëvlerësimi me rubrika

			
Identifikimi I së paku katër objekteve sipas madhësisë.	Kam identifikuar me shumë se katër objekte dhe kam tejkalluar kriterin.	I kam vizatuar vetëm 3 objekte, nuk e kam plotësuar suksesshëm kriterin.	E kam bërë vetëm një objekt.
Gjetja e së paku pesë objekteve me ngjyrë të ndryshme.	Plotësova kriterin duke gjetur të pesë objektet që dallohen sipas ngjyrës	Arrita t'i gjej vetëm tri objekte që dallohen sipas ngjyrës	Kam vështirësi në identifikimin e ngjyrave.
Të krahasojnë së paku 5 objekte ,sipas madhësisë,formës dhe ngjyrës.	Bëra krahasimin e të gjitha objekteve dy janë të mëdha dy të vogla njëra ishte e gjerë	Bëra krahasimin e vetëm 3 objekteve më mbetën edhe dy pa i krahasuar	Nuk arrita fare të bëjë krahasimin e objekteve.
Vizatim/modelim i së paku tri objekteve sipas madhësisë,ngjyrës apo formës.	Kam modeluar me plastelinë tri objekte	Jam përqendruar te zbukurimi dhe më mbetën pa i punuar të gjitha	Kisha vështirësi në zbutjen e plastelinës dhe nuk arrita ta punoj asnjë objekt.
Interpretim verbal të rezultateve të punuara (vizatim apo modelim).	Shumë lehtë interpretoj punën time.	Pjesërisht jam i kënaqur më interpretim, po i harroj disa gjëra.	Kam punuar, por nuk po mund të shprehem me fjalë.

Ngjyros me:

Të gjelbër


Të verdhë

Të kuqe

Emri dhe mbiemri i nx. _____

Projekti 6, Përdorimin i instrumenteve I

Niveli	I përshtatshëm për klasat 6-9
Plan-programi	Shkathtësitë kryesore
Qëndrimet/vlerat	Respektimi i rregullave të sigurisë dhe kujdesi gjatë zbatimit të tyre.
Shkathtësitë kyçe	Puna me instrumente, matjet.
Përshkrimi	Nxënësve do t'u kërkohet të montojnë instrumente të thjeshta për të ngrohur ujë. Pastaj ata do të matin temperaturën e ujit çdo minutë për dhjetë minuta me radhë.
Pajisjet	Trekëmbësh, rrjetë e hollë metalike, gotë laborator, bek Bunseni apo burim tjetër nxehtësie, termometër, syze mbrojtëse.
Materialet	Ujë
Koha	Një orë mësimore.
Organizimi	Grupe të vogla varësisht prej pajisjeve në dispozicion.
Procedura	Nxënësve u jepen pajisjet.



Nxënësit i montojnë instrumente në përputhje me udhëzimet e dhëna. Pastaj ata e nxehin ca ujë, duke matur temperaturën e tij çdo një minutë për dhjetë minuta me radhë.

Rezultati Nxënësit do të njihen me përdorimin e instrumenteve të zakonshme dhe do të matin temperaturën me termometër.

Ose në këtë mënyrë

Projekti 7, Përdorimi i instrumenteve II

Niveli	I përshtatshëm për klasat 6-9
Plan-programi	Ndryshimet kimike
Qëndrimet / vlerat	Respektimi i rregullave të sigurisë dhe kujdesi gjatë zbatimit të tyre
Shkathtësitë kyçe	Puna me instrumente, matjet
Përshkrimi	Nxënësit do të matin një masë të caktuar të një materiali të dhënë, do ta nxehin atë dhe pastaj do ta matin sërish pasi të ftohet.
Pajisjet	Trekëmbësh, rretë e hollë metalike, bek Bunseni, apo burim tjetër nxehtësie, peshore, pjatë porcelani, spatul, syze mbrojtëse.
Materialet	Rërë e thatë, karbonat bakri, apo sulfat bakri i kaltër, pluhur bakri.
Koha	Dy orë mësimore
Organizimi	Ndani klasën në tre grupe (secili prej grupeve do të punojë me një material të ndryshëm).
Procedura	Nxënësve u jepen pajisjet.



Nxënësit i montojnë instrumente në përputhje me udhëzimet e dhëna.

Nxënësit ndajnë një masë prej 2 – 3 g të materialit. Masa e saktë duhet të shënohet.

Nxënësit duhet të nxehin materialit dhe të vrojtojnë ndryshimet që ndodhin. Nxehja duhet të vazhdojë për disa minuta derisa nxënësit të jenë të sigurt se nuk do të ndodhin ndryshime të tjera.

Nxënësit duhet ta lënë materialin të ftohet, pastaj ta matin atë sërish. Masa duhet të shënohet prapë.

Nxënësit duhet të diskutojnë për ndryshimet e vërejtura gjatë nxehjes, si dhe në ndryshimet në masë që kanë shënuar.

Rezultatet

Nxënësit po mësojnë të përdorin instrumente të zakonshme.

Nxënësit bëjnë vrojtime dhe matin me peshore.

Nxënësit e kuptojnë që ndryshimet në pamje dhe humbja apo rritja e masës janë dëshmi të ndryshimeve kimike.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: **Shkencat natyrore** / Lënda: **Kimi** Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: VI

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Materia, vetitë dhe shndërrimet e saj

Tema / njësia mësimore: Gjendjet agregate të materies ose lëndës

Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën : II.4,II.5,II.6,III.1,III.2,IV.2,IV.4,V.8,VI.1,VI.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën :I.1,I.2,I.5,II,III.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: materia, lënda, akulli, termometër, epruvetë, acid nitrik, gjendje agregate, lëngët, gaztë, ngurtë

Rezultatet e të nxënit:

Në fund të orës nxënësi:

- Identifikon gjendjet agregate të lëndës.
- Përshkruan nga tri gjëra (sende) për tri format e lëndës.
- Tregon me shembuj kalimin e një formë të lëndës në tjetrën.
- Dallon vetitë fizike nga vetitë kimike të lëndës.

Kriteret e suksesit:

1. Demonstron me eksperiment vetitë e tri gjendjeve të lëndës.
2. Krahaso vetitë e trupave të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë
3. Ndrysho gjendjen agregate të një trupi.
4. Analizo ndryshimet kimike të lëndës.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore :

Kompjuteri, projektori, gota laboratorike, flakëdhënës ose reshë elektrik, shkumës ose marker, ujë, flakëdhënës, termometër, akull, epruvetë, acid nitrik, tel i bakrit.

Përdorimi i TIK: Prezantim i shkurtë në powerpoint.

Çështjet e ndërlidhura ndërkurrikulare: edukimi shëndetësor, mjedisi jetësor, edukimi për medie

PËRSHKRIMI METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse: Mësimdhënësi prezanton shkurtimisht gjendjet agregate të lëndës dhe ndryshimet e saj në powerpoint.



Pjesa kryesore:

Nxënësit në katër grupe të ndarë përmes eksperimenteve vërtetojnë vetitë dhe ndryshimet fizike dhe kimike të lëndës.

Grupi I

Pajisjet: 3 gota laboratorike, flakëdhënës ose resho elektrik

Lënda: Shkumës ose marker, ujë.

Ecuria e punës

Në gotën e parë vendoset një shkumës ose marker.

Gota e dytë mbushet me ujë rreth $\frac{1}{2}$ e saj.

Në gotën e tretë hedhim rreth 10 ml ujë dhe e vlojmë (pra avullohet uji).

Plotëso tabelën e mëposhtme:

Materiali	Shkumsi	Uji	Avulli
Gjendja agregate			
Fortësia gjatë kapjes (prekjes)			
Vëllimi (forma)			

Grupi II

Pajisjet: Flakëdhënës, gotë laboratorike, termometër

Lënda: Akulli

Ecuria e punës

Në gotë hedhim rreth 50g akull dhe masim temperaturën e saj. Pas matjes së temperaturës fillestare gotën e vendosim mbi flakëdhënës. Vëreni ndryshimin! Temperatura matet sërish në momentin e ndryshimit të gjendjes agregate. Gota nuk largohet nga flakëdhënësi deri në vlimin e ujit dhe matet temperatura sërish. Vëreni ndryshimet dhe diskutoni në grup pse ndodh ky fenomen? A kemi të bëjmë me ndryshim fizik apo kimik?

Grupi III

Pajisjet dhe lëndet: Fije shkrepëse, letër, pllakë qelqi ose porcelani

Ecuria e punës

Në enën prej qelqi vendoset fija e shkrepëses dhe një copë letër. Evidentohen vetitë e tyre në fletore. Fija e shkrepëses dhe letra ndahen në disa pjesë. Çfarë ndryshime kanë pësuar fija e shkrepëses dhe letra. Pastaj letrën dhe fijen e shkrepëses i djegim. Evidentoni produktet të cilat janë fituar dhe krahasoni vetitë e tyre me vetitë e evidentuara në fillim?

Grupi IV

Pajisjet: një epruvetë, flakëdhënës,

Lëndet: Acid nitrik, tel i bakrit

Ecuria e punës

(ky eksperiment kërkon ndihmën e mësuesit)

Me saktësi matet gjatësia e telit të bakrit dhe pastaj nxehet deri në skuqje dhe matet sërish gjatësia e tij. A ka pësuar ndryshime teli? Nëse po atëherë çfarë ndryshime janë ato?

Teli i njejtë vendoset në epruvetën e mbushur me acid nitrik 1ml. Çfarë ndryshime ka pësuar teli i bakrit? Shëno në fletore të gjitha ndryshimet që mund ti vëreni.

Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënësve:

Nxënësit raportojnë për vërtetimet eksperimentale në grupe para klasës.
(Vlerësim gjatë prezantimit të rezultateve dhe saktësisë së tyre).

Plani ditor i orës mësimore.

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore

Lënda: Kimi

Shkalla e kurrikulës: 5 **Klasa:** X

Koncepti bazë i fushës kurrikulare: Materia, vetitë dhe shndërrimet e saj

Tema: Shpejtësia e reaksioneve kimike

Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën:

I.7,I.8,II.1,,II,7,III.3,III.4,III.9,IV.4,VI.5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën :I.1,2.1,3.1,3.2,3.3,5,II,III

Metodat mësimore: Shpjegimi, biseda, eksperimentimi, vrojtimi, vërtetimi.

Qëllimi: T'i pajisë nxënësit me njohuri, shprehje, qëndrime dhe vlera për shpejtësinë e proceseve të cilat ndodhin në natyrë dhe në trupin tonë.

Rezultatet e të nxënësve: Në fund të orës nxënësi:

1. demonstroi ndikimin e temperaturës në reaksione kimike,
2. krahasoi proceset e ngadalshme nga ato të shpejta në natyrë,
3. vlerësoi rolin e katalizatorëve në organizëm.

Struktura e mësimimit

Evokim	Realizim kuptimi	Reflektim
5 min	30 min	10 min

Pjesa hyrëse:

Stuhi mendimesh (arsimtari parashtron pyetjet nxënësit përgjigjen).

Japin shembuj nga jeta rreth proceseve të ndryshme.

Kriteret e suksesit

5. Vërteto ndryshimin e shpejtësisë reaksioneve me ndryshim të temperatures.
6. Krahaso reaksionet e ngadalshme me ato të shpejta.
7. Vlerëso rolin e shpejtësisë së reaksioneve në jetë.

Pjesa kryesore: Nxënësit në katër grupe të ndarë përmes eksperimenteve vërtetojnë ndikimin e jashtëm në shpejtësi të reaksioneve kimike. Ata gjithashtu përgatisin raportet në flip chart nga eksperimentet e vërtetuara.

Grupi I

Pajisjet: 3 gota kimike

Substancat: H_2O_2 , H_2SO_4 , tretësirë $KMnO_4$

Ecuria e punës

Në tri gota kimike a, b, c hedhim tretësirë ujore 5% të acidit sulfurik, H_2SO_4 , ndërsa përqendrimit e tretësirës së permanganatit të kaliumit, $KMnO_4$ janë të ndryshme. Në gotën e parë hedhim 0,5 %, në të dytën 2 %, kurse në të tretën 10 % tretësirë permanganati të kaliumit. Pastaj në tri gotat hedhim peroksid të hidrogjenit 3% H_2O_2 .

Në cilën nga epruvetat zhvillohet reaksioni më shpejt para shtuarjes së H_2O_2 ? Çka vëreni pas shtimit të peroksidit të hidrogjenit në epruveta? Pse ndodh ky ndryshim?

Grupi II

Pajisjet: 2 gota kimike, flakëdhënësi

Substancat: sheqeri, uji

Ecuria e punës

Në të dyja gotat hedhet sasi e njëjtë e sheqerit dhe ujit. Njëra gotë vendoset mbi flakëdhënës. Në cilën gotë tretet më shpejt sheqeri? Pse sheqeri në njëërën gotë është tretur më shpejtë?

Grupi III

Pajisjet: 2 gota kimike

Substancat: uji, sheqeri, kripa e gjellës

Ecuria e punës

Në dy gota të mbushura me sasi të njëjtë të ujit hedhet sasi e barabart në një të gotë sheqeri, ndërsa në të dytën kripa, Cila nga substancat është tretur më shpejtë. Pse mendoni se është tretur më shpejtë, vërtetoni edhe me ndonjë eksperiment të zgjedhur nga ana juaj.

Grupi IV

Pajisjet: dy epruveta

Substancat: Acid sulfurik dhe dy gozhda hekuri

Ecuria e punës

Në një të epruvetë mbushet një e treta e acidit sulfurik 10% dhe vendoset gozhda, ndërsa në epruvetën e dytë mbushet një e treta e epruvetës me acid sulfurik 50% dhe vendoset gozhda. Pas dhjetë minutave gozhdat nxirren nga epruvetat dhe vërtetohet se cila nga gozhdat është ndryshkur. Pse njëra gozhdë është ndryshkur më shumë se sa tjetra?

(Vlerësim përmes punës praktike dhe vërtetimeve të tyre).

Reflektimi:

Nxënësit raportojnë për vërtetimet eksperimentale në grupe para klasës.

(Vlerësim gjatë prezantimit të rezultateve dhe saktësisë së tyre).

MODELI I PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE	
ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	/ Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës :5	/ klasa :X
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset jetësore	
Tema / njësia mësimore: Kërpudhat-Mycohyta	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën: 5, I 1,8,9-II,1,2,3- III6,7,8-IV2,4-V,9-VI,9.	
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën e 5: analizon dhe hulumton mbretërin e kërpudhave.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE	
Fjalët kyçe: Hife, Micel, Myku, Penicilium, tharmet.	
Rezultatet e të nxënësve: -Dallon kërpudhat nga bimët tjera -Shpjegon ndertimin e kërpudhave të llojeve të ndryshme -Vlerëson rolin e kërpudhave	
Kriteret e suksesit: -Në numrin 3 lloje parazite -Në numrin 5 lloje të dobishme për njeriun	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Një copë buke e lagur vendoset në një qese plastike, aty zhvillohet myku dhe vërtetohet nga nxënësit.	
Përdorimi i TIK: Nxënësit hulumtojnë për vlerat ushqyese të kërpudhave si dhe rolin e tyre në farmaci.	
Çështjet e ndërlidhura: Shoqëria dhe mjedisi, shëndeti dhe mirëqenia.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIFIKUAR TË ORËS MËSIMORE	
Pjesa hyrëse: Breinstorming-stuhi mendimesh	
Me një pyetje të hapur cka dini për kërpudhat nxënësit në fletoret e tyre shenojnë njohuritë paraprake si	

dhe vrojtojn mykun e kultivuar ne buke.

Pjesa kryesore: Teknika e pyetje:

1. Me cilat veqori kerpudhat dallohen nga bimet tjera?
2. Si ushqehen kerpudhat?
3. Cka quajm hife e qka micel?
4. Si shumohen kerpudhat?
5. Si klasifikohen?

Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxëniti: Bshkebisedim, pergjigje ne pytje te parashtruara.

Punë me projekte

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore
Fizikë

Lënda: Biologji, Kimi,

Shkalla e kurrikulës: 3

Tema: Uji

Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën
: I.8, II.2, II.4, II.5, II.6, III.1, III.6, IV.1, IV.2, IV.3, IV.4, IV.5, VI.1

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën ____ :

Metodat mësimore: Hulumtim, mësim i bazuar me projekte

Rezultatet e të nxëniti:

- Identifikon së paku tre funksione kyçe që ka uji në organizmat e gjalla.
- Llogaritë sasinë totale të ujit që konsumon gjatë ditës.
- Liston pesë pemë ose perime që kanë përmbajtje më të madhe të ujit.
- Përgatitë broshurë për kursimin e ujit.
- Krahason vetitë fizike të ujit me së paku tre lëngje tjera.
- Shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë.
- Analizon përbërjen e ujit të pijshëm dhe shënon rolin e secilës substance të tretur në ujë në funksion të jetës.

Për këtë punë nevojitet që nxënësit të punojnë në kabinetin e teknologjisë (informatikës), ku janë të nevojshëm së paku katër kompjuter të lidhur me internet. Gjithashtu një projektor pwr prezantim.

Aktivitetet e projektit

- Minileksion nga mësimdhënësi dhe fakte për ujin.
- Formimi i grupeve të nxënësve (jo më shumë se pesë nxënës në një grup).

- Zgjedhja e një kordinatori të grupit nga vetë nxënësit.
- Njohja e secilit grup me nëntemen që do të punojnë.

Grupi 1. Uji burim i jetës!

Grupi 2. Mungesa e ujit, çka mund të bëj unë?

Grupi 3. Lëngu i cili do ta “zëvendësonte” ujin!

Grupi 4. Industria pa ujë!

Varësisht nga numri i nxënësve në klasë grupet mund të punojnë temën e njejtë apo të shtohet ndonjë nëntemë tjetër.

Për orientim të nxënësve mësimdhënësi mund të përdorë pyetje të ndryshme si p.sh.:

1. Cilat janë funksionet kyçe të ujit në organizmat e gjalla?
2. Sa litra ujë konsumon dhe shpenzon mesatarisht një person në ditë?
3. Cilët organizma kanë përmbajtje më të madhe të ujit dhe sa përqind përmbanë njeriu?
4. Si do të mund të ndikoni tek të tjerët që ta kursejnë ujin?
5. Pse është i rëndësishëm kursimi i ujit?
6. Pse uji përdoret si mjet ftohës në industri por edhe në përgjithësi?
7. Pse disa insekte mund të ecin mbi ujë?
8. Pse lumenjtë nuk hargjohen ?
9. Pse uji i deteve dhe oqeanëve përmbanë shumë kripë?
10. Pse uji i distiluar nuk përdoret për pije?

Nxënësit fillojnë hulumtimin në internet, përkthimin dhe selektimin e informatave dhe fotografive.

Mësimdhënësi mund të ndihmojë në ndonjë paqartësi, ndërsa puna e nxënësve monitorohet vazhdimisht.

Pas mbledhjes së materialit nga ana e nxënësve dhe selektimi (përpunimi) i informatave, nxënësit përgatisin prezantime në powerpoint, hamera, ekspozitë apo edhe broshura të ndryshme, varësisht prej zgjedhjes nga ana e grupit.

Prezantimet bëhen nga secili grup me radhë, ku të përfshirë në prezantim duhet të jenë të gjithë anëtarët e grupit. Pas çdo prezantimi nga ana e grupeve, ata i përgjigjen pyetjeve të mësimdhënësit apo nxënësve tjerë për çdo paqartësi apo informatë shtesë rreth asaj teme.

Gjatë vlerësimit të punës së nxënësit duhet të merren parasysh:

- Shfrytëzimi efektiv i kohës.
- Bashkëpunimi me grupin.
- Prezantimi.
- Përvetësimi i njohurive.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare :Shkencat e natyrës Lënda:Fizikë Shkalla kurrikulës:5 Klasa:X
Koncepti bazë I fushës kurrikulare.Proceset fizike Tema/njesia mësimore :Shtypja hidrostatike
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën 5 II -7.Prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale të realizuar në laborator ose në punëtori të shkollës,jep argumente që lidhin rezultatet e punës me udhëzimet teorike.
Kontributi në rezultatet e fushës së kurikulës për shkallën-5 I-5 Në mënyrë analitike ,grafikedhe me numra paraqet rregullat e bashkëveprimeve themelore të natyrës
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE
Fjalët kyqe; hidrostatikë,shtypje,shtypje hidrostatik,paradoks hidrostatik Rezultatet e të nxënit; 1.Tregon si përkufizohet shtypja në përgjithësi dhe cilat janë njësitë matëse të saj 2.Shkruan lidhjen në mes njësisë bar dhe paskal dhe anasjelltas 3.Përkufizon shtypjen hidrostatike dhe e shpreh atë me formulë
Kriteret e suksesit:Paraqet me formulë shtypjen dhe shtypjen hidrostatike dhe zgjidh detyra numerike.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore; Tabela,shkumësi,libri Përdorimi I TIK;Paraqet me projektorë shembuj nga fizika virtuale
Cështjet e ndërlidhura; Matematikë, TIK,Kimi
PËRSHKRIMI METODOLOGJISË DHE RRJEDHES SË PLANIFIKUAR TË ORËS MËSIMORE
Pjesa hyrëse: Nxënësit informohen për njësinë e re mësimore,bëhen pyetje në lidhje me të dhe përgjigjet diskutohen
Pjesa kryesore:Shpjegohet nga ana e mësimdhënësit se cka duhet nxënë nga kjo njësi mësimore,mandej ajo ndahet në tri ndalesa.Nxënësit lexojnë mandej fillon komentimi I këtyre pjesëve duke bërë pyetje arsimtari dhe duke sqaruar .
Pjesa përfundimtare dhe vlersimi I të nxënit;Nxënësit reflektojnë duke u përgjigjur në pyetjet e arsimtarit.1 Si përkufizohet shtypja .2 Cka quajmë shtypje hidrostatike. 3 Diskutoni paradoksin hidrostatik .4 Zgjidhet ndonjë detyrë numerike. Udhëzohen për detyrat e shtëpisë.

Shtojca 3:

PAKOJA E INSTRUMENTEVE PËR PLANIFIKIMIN MËSIMOR

Informacione hyrëse

Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor sipas kërkesave të Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe Kurrikulës/ave Bërthamë, është produkt i punës së Departamentit për Kurrikula në MASHT, koordinatorëve të fushave kurrikulare, mësimdhënësve të dhjetë shkollave pilot (2013/2014) dhe Zyrës për planifikim mësimor në Institutin Pedagogjik të Kosovës, e zhvilluar gjatë hartimit të **udhëzuesve praktik për zbatimin e kurrikulës**.

Pakoja përfshin gjashtë instrumente për planifikimin mësimor:

1. Instrumentin për krahasimin e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës kurrikulare ;
2. Planin për shkallë kurrikulare;
3. Planin vjetor;
4. Planin dymujor;
5. Planin javor, dhe
6. Planin e orës mësimore

Instrumentet për planifikimin mësimor hartohen sipas kërkesave të Kurrikulës Bërthamë për nivelin përkatës të arsimit dhe sipas udhëzimeve të **udhëzuesve praktik për zbatimin e kurrikulës**.

Shkolla ka fleksibilitet në përdorimin e formatit të modeleve të planifikimit mësimor. E rëndësishme është që secili model/instrument i planifikimit mësimor i përgatitur në nivel shkolle të ketë elementet kryesore të planit që i dedikohet. Pra, aspekti teknik i organizimit dhe forma e vendosjes së tabeleave në instrumente të planifikimit është fleksibile, mund të bëhet në formen për të cilën shkolla/mësimdhënësit vlerësojnë se është me e lehtë dhe më praktike, por modelet e instrumenteve të planifikimit mësimor duhet të miratohen në nivel shkolle dhe duhet të përdoren nga të gjithë mësimdhënësit.

Shkolla mund të vendos edhe për shfrytëzimin e modeleve të instrumenteve të planifikimit mësimor të ofruara në këtë dokument.

Pakoja e instrumenteve për planifikim mësimor (*instrumentet 1- 5, duke përfshirë planifikimin dymujor për shtator-tetor*) duhet të hartohet dhe miratohet në nivel shkolle më se voni deri me 31 gusht të vitit shkollor për të cilin bëhet planifikimi mësimor. Pastaj, planet dymujore për muajt tjerë të vitit mësimor, hartohen në vijimësi të vitit mësimor dhe në bazë të planit vjetor. Kurse planet javore dhe planet e orëve mësimore, hartohen gjatë gjithë vitit mësimor.

Pakoja e instrumenteve për planifikim mësimor duhet të jetë në dispozicion të gjithë stafit mësimor në nivel shkolle dhe për të duhet të jenë të informuar nxënësit të cilëve u dedikohet, prindërve të tyre dhe institucioneve relevante që merren me monitorimin e zbatimit të kurrikulës dhe që ofrojnë mbështetje profesionale e teknike në zbatimin e kurrikulës së re.

Instrumenti 1: KRAHASIMI I REZULTATEVE TË PRITSHME TË PLANEVE DHE PROGRAMEVE EKZISTUESE ME REZULTATET E FUSHËS KURRIKULARE

p.sh. FUSHËS KURRIKULARE - SHKENCAT E NATYRËS /SHKALLA 3/									
Nr.	Rezultatet e të nxënimit të fushës Shkencat e natyrës (RNF) marrë nga KB-ja	Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB			Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore		Rezultatet përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)		
		Klasat			Klasat		Klasat		
	Lëndët mësimore	6	7	6	7	6	7		
1	Biologji								
	Fizikë								
	Kimi								
2	Biologji								
	Fizikë								
	Kimi								

Instrumenti 2: Plani për shkallë kurrikulare

FUSHAT KURRIKULARE	Konceptet themelore të fushës	Rezultatet	Klasa e gjashtë	Klasa e shtatë	Temat mësimore që do të zhvillohen në klasën e gjashtë (6)	Temat mësimore që do të zhvillohen në klasën e shtatë (7)
SHKENCAT E NATYRËS		Rezultatet e të nxënëit të shkallës/kompete ncave (RNSH) /Shkalla III /				
		Rezultatet e të nxënëit të fushës kurrikulare: Shkencat e natyrës (RNF) /Shkalla III /				

Instrumenti 3: Plani vjetor - p.sh. i fushës së kurrikulës: Shkencat e natyrës

Shkalla: _____ Klasa: _____

Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës kurrikulare (marrë nga KB)	Rezultatet e fushës së kurrikulës (RNF) (marrë nga KB)	Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve					Rezultatet e të nxëniet të shkallës/kompetencave (RNSH)
				Shtator-Tetor	Nëntor - Dhjetor	Janar-Shkurt	Mars-Prill	Maj - Qershor	
SHKENCAT E NATYRËS									

Instrumenti 4: Plani dymujor - p.sh. i fushës së kurrikulës: Shkencat e natyrës

Shkalla: _____ Klasa: _____

FUSHA: SHKENCAT E NATYRËS											
Konceptet e fushës kurrikular e (marrë nga KB)	Rezultatet e fushës së kurrikulës (RNF) (marrë nga KB)	Tema/t mësimore (marrë nga plani vjetor)	Lëndët mësimore	Rezultatet e të nxënëit për lëndë mësimore (RNL)	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet	Korrelacioni me fushat kurrikulare dhe çështjet ndërlëndore	Rezultatet e të nxënëit të shkallës/kompetenca ve (RNSH)
			Biologji								
			Fizikë								
			Kim								

Instrumenti 5: Plani javor - përfshin të gjitha fushat e kurrikulës

Shkalla: _____ Klasa: _____

Dita	Njësitë mësimore në javë						Përshkrim i shkurtër
E hënë	Fushat e kurrikulës – / lëndët mësimore /duke përfshirë edhe kurrikulën me zgjedhje						
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E martë	Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore						
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E mërkurë	Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore						
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E enjte	Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore						
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E premte	Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore						
	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	

Instrumenti 6: Plani i orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	/ Lënda: Shkalla e kurrikulës: / Klasa:
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:	
Tema / njësia mësimore:	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën ____:	
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën ____:	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fjalët kyçe:	
Rezultatet e të nxënit të lëndës:	
Kriteret e suksesit:	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:	
Përdorimi i TIK-ut:	
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):	
Çështjet ndërkurrikulare:	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Pjesa hyrëse:	
Pjesa kryesore:	
Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit të orës mësimore:	